UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Dhjetor 2019

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE

UBT po ndërton Qytetin Inovativ dhe të Mençur

Faqe 4

Mbi një mijë pjesëmarrës në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të UBT-së

Faqe 9

UBT, përfituese e projekteve milionëshe nga Komisioni Evropian

Faqe 13

Rrëfime suksesi

Faqe 16-25

UBT vlerësohet nga FIRST Global me medalje të artë për kontributin e dhënë për garën botërore të robotikës

Nga 193 shtete, UBT i pari Faqe 3

UBT dhe Universiteti i Kembrixhit për herë të parë ndihmojnë Kosovën në modelimin dhe zbatimin e politikave publike

Faqe 3

NËNTËMBËDHJETË

24938
studentë

1000
staf akademik
dhe administrativ

50
programe studimi
të akredituara
bachelor dhe master

450
partneritete
ndërkombëtare

100
laboratorë
të specializuar

250
mijë libra

90 për qind –
shkalla e të punësuarve
pas diplomimit

PROGRAMET
STUDIMET E PËRBASHKËTA:

Viena University of Technology, Austri;
University of Warsaw, Poloni;
City University London, Angli;
HIG Gjovik University, Norvegji;
CIFE – Centre International de Formation Europe, Francë;
Danube University Krems, Austri;
Watford Institute Technology, Irlandë;
University degli Studi di Napoli Federico II, Itali.

KAMPUSET DHE QENDRAT
E UBT-SË NË KOSOVË:

- Prishtinë;
- Lipjan;
- Prizren;
- Pejë;
- Ferizaj;
- Gjilan.

MOBILITETET/BURSAT
NDËRKOMBËTARE:

Erasmus+,
CEEPUS,
PoSIG, etj.



IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve
Botues: Edmond Hajrizi
Numrin e përgatitën: Jehona Kapllani, Anisa Rada, Florend Bajrami, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

UBT i sjell edhe një sukses Republikës së Kosovës

UBT vlerësohet nga FIRST Global me medalje të artë për kontributin e dhënë për garën botërore të robotikës

Ekipi përfaqësues i Kosovës disa muaj është përgatitur në laboratorët inovativë të mekatronikës në UBT, teksa punën e kanë zhvilluar nën mbikëqyrjen e stafit akademik të UBT-së. Bashkërisht, ata kanë ndërtuar robotin inovativ me të cilin ekipi garoi në FIRST Global Challenge 2019

Ekipi përfaqësues i Kosovës në garën ndërkombëtare të robotikës ka arritur të shënojë rezultate të mëdha në garën "First Global Challenge", organizuar në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Kosova fitoi raundet në përballje me shtete të fuqishme në fushën e robotikës, si Rusia, Franca, Gjermania, Sllovenia dhe vende tjera.

Në ceremoninë përmbyllëse të garës më të madhe të robotikës më botë, iu nda medalje institucionit i cili e ka zhvilluar dhe ndihmuar ekipin e Kosovës për të marrë pjesë në këtë garë. Kësisoj, kontributi i UBT-së për zhvillimit e shkencës dhe teknologjisë po njihet e vlerësohet ndërkombëtarisht nga organizata të ndryshme në mbarë botën.

Në garën e sivjetme të FIRST Global, UBT është vlerësuar nga organizatorët dhe ka marrë medalje të artë për kontributin dhe mbështetjen që po jep për FIRST Global dhe për zhvillimin e STEM në botë, duke e lartësuar kështu emrin e Kosovës si një shtet i vogël, por që po jep kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës në botë.

Vajzat që e kanë përfaqësuar Kosovën në garën më të madhe të robotikës, e kanë marrë vëmendjen e organizatorëve dhe moderatorëve të eventit, për rezultatet e tyre, duke u pyetur për veprimtarinë e tyre në vendlindje.

Përpos vlerësimit institucional, edhe mentori i ekipit të Kosovës, Erjon Ameti është zgjedhur një nga tutorët më të mirë të ekipeve këtë vit.

Në anën tjetër, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, u prit në takim edhe nga presidenti i garës, Dean Kammen, me të cilin bashkëbiseduan për garën, pjesëmarrjen e Kosovës dhe sfidat, si dhe për kontributin e vazhdueshëm që do ta japë UBT për këtë event.

Ekipi përfaqësues i Kosovës disa muaj është përgatitur në laboratorët inovativë të mekatronikës në UBT, teksa punën e kanë zhvilluar nën mbikëqyrjen e stafit akademik të UBT-së. Bashkërisht, ata kanë ndërtuar robotin inovativ me të cilin ekipi po garon në FIRST Global Challenge 2019.

Presidenti Thaçi takon ekipin që përfaqësoi Kosovën në garën botërore të robotikës

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim ekipin që do ta përfaqësojë vendin në garën ndërkombëtare të robotikës "First Global Challenge", ekip i cili është përgatitur dhe trajnuar në ambientet inovative të UBT-së.

Më këtë rast, presidenti Thaçi u ka dëshiruar sukses studentëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë garë në mesin e rreth 200 vendeve nga bota, e që sivjet mbahet në Dubai, më datë 24-27 tetor.

"Sot e takova grupin e studenteve inovatore që do ta përfaqësojnë Kosovën në Dubai në garën ndërkombëtare të robotikës në mesin e 170 shteteve. Kosova ka të rinj dhe të reja me talent në të gjitha fushat e shkencës, në sport dhe muzikë. Iu dëshiroj sukses Albanës, Eltës dhe Elitës", ka theksuar presidenti Thaçi.

Edhe një partner prestigjioz i shtohet UBT-së

UBT dhe Universiteti i Kembrixhit për herë të parë ndihmojnë Kosovën në modelimin dhe zbatimin e politikave publike

Projekti i përbashkët i UBT-së dhe Universitetit të Kembrixhit do të funksionojë në kuadër të një platforme të quajtur "Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Rezilenca në Kosovë", që paraqet edhe angazhimin dhe kontributin e parë të këtij universiteti në Kosovë

Vargut të partnerëve ndërkombëtarë të UBT-së i është shtuar edhe një ndër universitetet më të mira dhe më prestigjioze në botë, Universiteti i Kembrixhit, që përmes UBT-së, do të jetë mbështetje për shtetin e Kosovës, përmes projektit inovativ për politika publike, që pritet të dizajnohet dhe implementohet për herë të parë në vendin tonë.

Projekti i përbashkët i UBT-së dhe Universitetit të Kembrixhit do të funksionojë në kuadër të një platforme të quajtur "Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Rezilenca në Kosovë", që paraqet edhe angazhimin dhe kontributin e parë të këtij universiteti në Kosovë.

Ky projekt do të ketë në fokus dizajnimin dhe menaxhimin e politikave publike, në atë mënyrë që fillimisht të simulohen për të matur ndikimin që mund të kenë, e pastaj të implementohen në praktikë.

Një projekt i tillë do të jetë ndër më të rëndësishmit të realizuar ndonjëherë në Kosovë, pasi duke u bazuar në qasje sistemore, do të bëjë vlerësimin e një politike publike dhe ndikimin që e njëjta mund ta ketë në jetën e qytetarëve. Një qasje e tillë do të ndikojë në përzgjedhjen dhe implementimin e politikave më të mira publike, duke u bazuar në procesin e auditimit, pasi Kosovës deri sot i ka munguar një mekanizëm funksional që do të bënte matjen e ndikimit të investimit.

Ky nuk do të jetë projekti i vetëm i Universitetit të Kembrixhit dhe UBT-së në Kosovë, pasi pas fazës së parë të modelimit dhe implementimit të politikave të caktuara publike, në vitet e ardhshme do të punohet me Qeverinë e Kosovës në nivel sektorial dhe të përgjithshëm, për të cilën edhe përfaqësuesit institucional të vendit kanë shfaqur interesim të jashtëzakonshëm për bashkëpunim.

Rektori Hajrizi qëndroi për vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar për vizitë në Universitetin e Kembrixhit, ku bashkërisht me përfaqësuesit e këtij universiteti, prezantuan rezultatet e projektit të përbashkët njëvjeçar për dizajnimin e politikave publike në Kosovë. Megjithatë, bashkëpunimi ndërinstitucional mes UBT-së dhe Universitetit të Kembrixhit nuk mbaron vetëm me këtë projekt, pasi në këto takime është vendosur edhe për vazhdimin e një programi tjetër të përbashkët pesëvjeçar, i cili ka të ketë të bëjë me politikat për zhvillim të qëndrueshëm dhe për ngritjen e kapaciteteve në fushën e reziliencës së qeverisjes përmes simulimit të politikave publike dhe nismave të qëndrueshme. Bashkëpunimi mes UBT-së dhe Universitetit të Kembrixhit ka nisur para më shumë se një viti, me ç'rast deri më tash janë zhvilluar disa takime pune dhe punëtori, me qëllim të dizajnimit të politikave të duhura publike në Kosovë.

Fillon ndërtimi i objektit të katërt brenda Kampusit Inovativ të UBT-së

UBT po ndërton Qytetin Inovativ dhe të Mençur

Ky objekt do të jetë i katërti brenda Kampusit Inovativ të UBT-së, në Lipjan, kurse kjo e bën UBT-në institucionin e vetëm në Kosovë dhe rajon me Park Shkencor

Rreth 28 mijë metra katrorë do të jetë objekti më i ri universitar i UBT-së, që do të jetë unik dhe i pari i këtij lloji në Kosovë. Brenda këtij objekti do të krijohen salla ligjërimi e praktike, konvikti, laboratorë, biblioteka, kuzhina dhe të gjitha elementet tjera për të cilat kanë nevojë studentët.

Ky objekt vetëm se do e kompletojë dhe zbukurojë edhe më shumë kampusin universitar të UBT-së, i cili u ofron studentëve frymën e veçantë dhe të re të të studiuarit në një institucion ndërkombëtar. Ky objekt do të jetë i katërti brenda Kampusit Inovativ të UBT-së, në Lipjan, kurse kjo e bën UBT-në institucionin e vetëm në Kosovë dhe rajon me Park Shkencor, në të cilin zhvillohet shkenca, kryhen eksperimente, formohen produkte dhe marrin jetë projektet më inovative në vend.

Prandaj, me rritjen e numrit të studentëve, UBT ka shumëfishuar hapësirën në Kampusin Inovativ, ku gjenden objekte të mëdha e me shumë hapësira rekreative, laboratorë të sofistikuar, biblioteka me më shumë se 200 mijë tituj shkencorë, hapësira punuese e mësimi për studentë. Të gjitha këto tash e shumë vite janë në shërbim të studentëve të UBT-së, të cilët natyrshëm shndërrohen në ekspertë të të gjitha fushave të studimit, pasi që kanë mundësi e forma të panumërta për aftësim profesional dhe akademik përbrenda UBT-së. I tërë ky investim është bërë dhe po bëhet me qëllim të përgatitjes së studentëve për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës, ku studentët e UBT-së gjithmonë janë më të dalluarit dhe më të përgatiturit.

UBT priti me ceremoni madhështore studentët e rinj

Të rinjtë e buzëqeshur e me plot shpresë për të ardhmen premtuese që po i pret, e pasuruan çdo qosh e hapësirë të Kampusit Inovativ të UBT-së, ku u mbajt ceremonia madhështore e pritjes së studentëve të rinj.

Për t'i motivuar e për t'i njoftuar me të ardhmen që po i pret, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi doli para studentëve të rinj, për t'ju treguar që në UBT do ta kenë jo vetëm një vend studimi, por edhe familjen dhe shtëpinë e tyre të dytë.

"Faleminderit që keni dëshmuar besimin tuaj në institucionin tonë, sepse kjo do të thotë që ju jeni orientuar për vlera të mirëfillta akademike dhe të jetës. Ne tashmë jemi familje dhe do të

përkujdesemi për ngritjen tuaj profesionale, ashtu siç deri sot kanë bërë prindërit tuaj, prandaj edhe jemi të vendosur që bashkë të mos ndalemi derisa ju dhe familjet tuaja të binden për investimin që kanë bërë", tha Hajrizi.

Prof. dr. Jorida Xhafaj, dekane e Fakultetit Juridik, i përgëzoi studentët për pjekurinë që e kanë treguar në përzgjedhje të profesionit, teksa i siguroi studentët e rinj që do t'i kenë mësimdhënësit e tyre në çdo hap që do ta bëjnë.

"Ju tashmë jeni bërë pjesë e një emri të madh që nuk do t'ju zhvillojë vetëm gjatë viteve të studimit, por do t'ju shoqërojë gjatë gjithë karrierës suaj profesionale. Prandaj, çfarë kërkohet nga ju është që të qëndroni të guximshëm dhe gjithmonë me kureshtje për dijen", i këshilloi ajo studentët e rinj.

E për të ndarë përvojën e saj të studimit në UBT, studentja e nivelit master në UBT, Anesa Mustafa tha se është e lumtur që pesë vitet e ngritjes së saj akademike i ka kaluar në UBT, andaj edhe i siguroi studentët e rinj që kanë bërë zgjedhjen më të mirë të mundshme për të ardhmen e tyre "Nga dita e sotme, ju do të ofroheni çdoherë e më shumë me suksesin, e suksesi im më i madh gjatë këtyre viteve nuk është vetëm arritja në nivelin master, por edhe fakti që përmes UBT-së u bëra bursiste dhe e pata mundësinë që një semestër të studimeve të kaloja në universitetin më të njohur gjerman për arkitekturë, Anhalt University of Applied Sciences", tregoi ajo.

Me vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

UBT-së i akreditohen 12 programe të reja – Bëhet institucioni me më së shumti programe studimi të akredituara në Kosovë

Janë bërë 18 vite prej kur UBT ka nisur veprimtarinë në Kosovë, por sot institucioni ka bërë një kthesë në historinë e vet, por edhe në atë të arsimit privat në Kosovë, duke u bërë institucioni privat me më së shumti programe studimi dhe specializime të akredituara në vend.

Me vendimin e fundit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, UBT ka marrë akreditimin për 12 programe të reja studimi, në të cilat tashmë edhe zyrtarisht mund të aplikojnë të gjithë të interesuarit:

Dizajn i Integruar (Bachelor), në Prizren; Dizajn i Integruar (Bachelor), në Ferizaj; Agrikultura dhe Inxhinieria e Mjedisit; Shkencat dhe Teknologjia e Ushqimit (Master); Teknik i Anesteziologjisë; Teknik i Radiologjisë; Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi; Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (Bachelor), në Ferizaj; Arti dhe Mediat Digjitale; E Drejta Civile dhe Pronës (LLM);

Farmaci (MPh); Stomatologji (Dr.Dent); Laborant i Biokimisë Mjekësore (në pritje).

UBT në gati dy dekada ekzistencë ka diplomuar studentë në 15 programe të akredituara studimi të nivelit Bachelor dhe në 12 sosh të nivelit Master, por më e rëndësishmja është që diplomat e tyre janë njohur në cilindo vend të botës dhe u kanë hapur studentëve rrugë për zhvillim të mëtutjeshëm në karrierën profesionale dhe akademike.

Kjo është edhe arsyeja thelbësore e suksesit të studentëve aktualë dhe ish-studentëve të UBT-së në tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës.

I gjithë ky sukses është i lidhur pazgjidhshëm me faktin që në UBT janë të angazhuar si staf akademik e administrativ 1000 profesionistë të të gjitha fushave dhe 450 marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerë nga e mbarë bota.

Bashkë me UBT-në, për herë të parë në Kosovë kanë arritur praktikat më të mira të mësimit bashkëkohor, i cili është dëshmuar si i suksesshëm në universitetet më të mira botërore, përfshirë këtu sistemin elektronik për studentë, libraritë online, parku shkencor, inkubatorët virtualë, laboratorët më modernë dhe stafi ndërkombëtar, e më vonë edhe vendor.

Rritja e institucionit për nga numri i studentëve dhe zgjerimi nëpër qendra të ndryshme në qytetet më të mëdha të Kosovës, dëshmon që UBT, jo vetëm që është pionier i inovacioneve teknologjike, por vazhdon të mbetet institucioni më i përkushtuar dhe më serioz në vend në edukimin e gjeneratave të reja dhe për përgatitjen e tyre profesionale konform kërkesave aktuale të tregut të punës.

Ky sukses do të ndikojë më së shumti në të ardhmen e të rinjve kosovarë, prandaj një vendim i tillë është historik për UBT-në dhe Kosovën, sidomos në një kohë kur falë UBT-së, vendit tonë po i afrohen investitorë të huaj, të interesuar për studentët e përgatitur të Kosovës.

Organizuar nga "Quality Kosova", nën udhëheqjen e prof.dr. Edmond Hajrizi

Në Kosovë u mbajt mbledhja e Asamblesë të Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë

Për herë të parë në Kosovë u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë, ku nikoqir i saj është organizata "Quality Kosova", nën udhëheqjen e presidentit, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë mblodhi në Prishtinë përfaqësues nga të gjitha vendet e Evropës, të cilët përfaqësojnë organizatat e tyre nacionale për menaxhimin e cilësisë, standardeve dhe certifikimeve, profesionistë dhe ekspertë të dalluar nga industri të ndryshme me renome botërore.

Në takim, ndër tjerash, është diskutuar për mbështetjen dhe angazhimin shoqëror që duhet dhënë arsimit të lartë, njëherësh pjesëmarrësit kanë shkëmbyer përvojat e tyre për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, në takim u tha se duhet nxitur studentët dhe profesorët për të punuar në hulumtime shkencore, inovacion, si dhe u theksua se duhet të përgatiten gjeneratat për karrierë dhe të kenë rol aktiv në shoqëri.

Pas mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë, përfaqësuesit e vendeve evropiane kanë vizituar Kampusin Inovativ të UBT-së në Lipjan. Ata janë mahnitur me UBT-në me gamën e gjerë të programeve dhe infrastrukturën që ofron, teksa thanë se UBT ka arritje të jashtëzakonshme në arenën ndërkombëtare, arritje në hulumtime, inovacion dhe mësimdhënie.

Ata vlerësuan se UBT duhet të jetë model për gjitha institucionet arsimore në vend dhe Evropë, për qasjen akademike dhe mundësitë që u jep studentëve në veprimtarinë intelektuale. "Quality Kosova", u themelua në vitin 2006, me iniciativë të rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ku është anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi, dhe bashkërisht promovojnë standardet më të mira të cilësisë dhe aspekteve me rëndësi të jetës në Evropë dhe më gjerë.

UBT anëtare e Organizatës Evropiane të Shkencës dhe Teknologjisë, "COST Action"

UBT vendos Kosovën në rrjetin më të rëndësishëm të hulumtimit në Evropë, COST ACTION



Falë UBT-së, Kosova ka arritur edhe një sukses tjetër në arenën ndërkombëtare duke u bërë kështu anëtar i Organizatës Evropiane të Shkencës dhe Teknologjisë, "COST Action".

Konkretisht, me iniciativën dhe punën e prodekanit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, dr. Visar Krelani, si dhe mbështetjen e rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe dekanit të FNI-së, dr. Muhamet Ahmeti, tashmë emri i Kosovës renditet në listën e shteteve që do të ofrojë ndihmë në zhvillim të shkencës dhe teknologjisë.

UBT ka plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme dhe ka përmbushur kushtet që ta anëtarësojë edhe Kosovën si shtet në këtë rrjet, dhe në veçanti, në Aksionin CA 15205 – Self Healing as Preventive Repair of Concrete Structures, me rreth 30 vende anëtare, përfshirë edhe Kosovën si vend partner ndërkombëtar.

Ky projekt menaxhohet nga Cambridge University, së bashku me universitetet partnere, Politecnico di Milano, Ghent University, Delft University of Technology, etj. Falë këtij anëtarësimi, tanimë Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës hyn në rrjetin e fakulteteve evropiane dhe botërore, që do të mund të përfitojë dhe shpërndajë përvojat e veta dhe të përfaqësojë shtetin tonë në ambientet e vërteta shkencore.

Organizata Evropiane e Shkencës dhe Teknologjisë (COST) është një organizatë financiare për krijimin e rrjeteve hulumtuese, të quajtura COST Actions, duke lidhur ndërmjet vete të gjithë hulumtuesit shkencorë në Evropë dhe jashtë saj, si shtysë kryesore në avancimin e hulumtimit dhe inovacionit.

COST ACTION ekziston që nga viti 1971 dhe pranon fonde të Bashkimit Evropian nëpërmjet kornizave të ndryshme të hulumtimeve dhe inovacionit, siç është edhe Horizon 2020.

Për herë të parë, Kosova përfaqësohet në takimet e projektit "Mare Nostrum"

Në mesin e vendeve si Portugalia, Bosnje dhe Hercegovina, Armenia, Rusia, Serbia, Uzbekistani, Gjeorgia, Nepali, Maroku, Tunizia dhe Etiopia, për herë të parë edhe Kosova, falë UBT-së, po përfaqësohet në takimet e projektit të quajtur "Mare Nostrum" që zhvillohet në partneritet me Erasmus +.

Ky projekt fokusohet në fushën e mobilitetit të studentëve kosovarë dhe stafit akademik, ndërkohë përmes këtij projekti do të ndahen 100 bursa studimi.

Këto bursa përveç që ndihmojnë studentët në zhvillimin e tyre profesional, do të rrisin edhe kapacitetet dhe aftësitë e të rinjve në profesionet që ata zgjedhin.

Gjithashtu, projekti "Mare Nostrum" parasheh edhe mundësinë e bashkëpunimit të stafit akademik dhe administrativ me universitetet partnere nga shtetet e lartpërmendura.

Takimet për këtë projekt po mbahet në Portugali, ndërkaq ekipi që po përfaqëson Kosovën përbëhet nga drejtori për Çështje Akademike në UBT, Muhamet Ahmeti, si dhe ligjëruesit në UBT, Afërdita Statovci, Halil Bashota dhe Hasan Metin.

Partneriteti i UBT-së me institucione të shquara akademike botërore, mundësi për zhvillim akademik e profesional për studentët

UBT është institucioni që Kosovës i ka dhënë gjenerata të tëra të përgatitura përmes praktikave më të mira ndërkombëtare, por edhe ua ka ofruar studentëve mundësinë e vijimit të studimeve në dhjetëra universitete partnere.

I gjithë ky investim intelektual është bërë me qëllim që studentët të marrin të gjitha njohuritë e nevojshme, t'i përshtatin ato për nevojat e vendit tonë dhe të kthehen për të dhënë kontributin e tyre në Kosovë.

UBT ka bashkëpunim me 450 universitete prestigjioze nga e mbarë bota dhe bashkëpunimi është përqendruar në shkëmbimin e studentëve dhe stafit, për ofrim të kontributit në hulumtim, shkencë, inovacion, si dhe për krijim të programeve të përbashkëta.

Të gjitha këto mundësi i kanë shndërruar studentët tanë në liderë e inovatorë, që e kanë dhënë gjithë potencialin e tyre

për sjelljen e praktikave më të mira botërore në Kosovë.

Deri më sot, qindra studentë të UBT-së, të të gjitha fakulteteve, kanë përfituar mundësinë për të vazhduar studimet jashtë vendit, në shtete të ndryshme të botës, përfshirë vendet si SHBA, Anglia, Italia, Portugalia, Gjermania, Zvicra, Austria, Polonia, Kroacia, dhe shume shtete tjera.

Konferenca shkencore ndërkombëtare "30-vjetori i Rënies së Sistemit Komunist"

Me konferencë shkencore, UBT dhe Instituti Shkencor Suedez-Kosovar shënojnë rënien e Murit të Berlinit

Në kuadër të kësaj konference u prezantuar rreth 30 punime, teksa pjesë e saj ishin dhjetëra pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe studentë të shumtë të UBT-së

UBT, në bashkëpunim me Institutin Shkencor Suedez-Kosovar, kanë mbajtur konferencën shkencore ndërkombëtare "30-vjetori i Rënies së Sistemit Komunist", me ç'rast gjerësisht u diskutua për rënien e komunizmit dhe fillimin e demokracisë, konkretisht rënien e Murit të Berlinit. Konferencën njëditore e hapi rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili tha se rënia e Murit të Berlinit, 30 vjet më parë, eliminoi një padrejtësi të madhe.

Sipas tij, ky mur i dha fund ndarjes, teksa për botën, ky akt shënon rënien e Perdes së Hekurt dhe fundin e Luftës së Ftohtë.

"Një ëndërr për njerëzimin, për botën demokratike rënia e Murit të Berlinit dhe ribashkimi i Gjermanisë u bë realitet 30 vjet më parë. Ky mur, si simbol që kufizoi demokracinë e Perëndimit dhe diktaturën e Lindjes, la vragë të pashlyeshme në historinë e re të Evropës. Por, edhe më të mëdha ishin vragat e familjeve të ndara", theksoi rektori Hajrizi.

Tutje, rektori Hajrizi potencoi se për gjithë botën demokratike, edhe për shqiptarët, rënia e Murit të Berlinit është një ngjarje historike, që shënon fuqizimin e përpjekjeve të pandalshme për liri e shtet, që kulmuan 10 vjet më vonë.

"Falënderues për gjermanët që e rrënuan murin dhe ndryshuan rrjedhën e historisë së Evropës dhe të botës. Falënderues përjetë për ndihmën që i dhanë Kosovës dhe gjithë shteteve të vogla në botë, kudo ku ka nevojë. Na kujton të bëjmë gjithçka që mundemi për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë, dinjitetin njerëzor dhe shtetin ligjor", potencoi rektori Hajrizi.

Zëvendëskryeministri në detyrë, Enver Hoxhaj, tha se viti 1989 ka qenë fund i komunizmit dhe fillim i demokracisë. Me rënien e komunizmit, Hoxhaj tha se përfituese më e madhe është ShBA-ja.

"Viti 1989 ka qenë fundi komunizmit ka sjellë unifikimin e Bashkimit Evropian. Natyrisht kur japim vlerësime të tilla shtrohet pyetja kush përfitoi më shumë. Përfitues i kësaj rrjedhe është padyshim SHBA-ja", theksoi Hoxhaj.

Sipas zv.kryeministrit Hoxhaj, në 30 vitet e fundit përfitoi shumë edhe Ballkani, si dhe vetë shteti i Kosovës.

Drejtoresha e Institutit Shkencor Suedez-Kosovar, Salihe Salihu tha se organizimi i kësaj konference kishte për qëllim shënimin e ngjarjes së rëndësishme, ngjarje që ka prekur dhe pati ndikim në mbarë Evropën, përfshirë edhe Kosovën.

"Si institut shkencor, së bashku me UBT-në, kemi mundësuar të mbajmë në nivel nacional këtë konferencë. Kjo është ngjarje e rëndësishme sepse si e tillë ndryshoi edhe fatin e shtetit tonë. Kjo ngjarje padyshim mori rrugëtim dhe ishim të fundit si vend që rrumbullakuam demokratizimin. Me rënien e komunizmit, sistemi kosovar ka pasur efekt në çlirimin e Kosovës, andaj kjo është lidhja që na bashkoi kjo konferencë", tha ajo.

Ndërkaq, dekani i Fakultetit të Shkencave Politike në UBT, Arian Starova theksoi se 30 vitet e kaluara tregojnë qartë se popujt ishin të shtypur.

"Fryt i kësaj përpjekjeje disavjeçare është Kosova e pavarur dhe sovrane. Rrugëtimi vazhdon, ndërsa mirënjohja ndaj këtij aleati strategjik është tejet e madhe, sepse kur ka liri ka edhe mjete për të përballuar sfidat", tha dekani Starova.

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "30-vjetori i Rënies së Sistemit Komunist, vazhdoi prezantimin e punimeve dhe hulumtimeve të profesorëve dhe ekspertëve nga fusha e shkencave politike, dhe jo vetëm.

Në kuadër të kësaj konference u prezantuar rreth 30 punime, teksa pjesë e saj ishin dhjetëra pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe studentë të shumtë të UBT-së.

Rektori Hajrizi, pjesëmarrës në konferencën "Universities as Drivers of European Innovation Ecosystems"

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në konferencën "Universities as Drivers of European Innovation Ecosystems", që është mbajtur në Bruksel të Belgjikës.

Konferenca është organizuar nga European University Association dhe Komisioni Evropian, ku janë bërë bashkë udhëheqës institucionesh arsimore nga mbarë Evropa, për të diskutuar në lidhje me rolin e universiteteve dhe kontributin e dhënë për zhvillimin e ekosistemeve inovativ.

Ndër tjerash, rektori Hajrizi ka zhvilluar takime me presidentin e European University Association (EUA), Michael Murphy, me presidentin e European Quality Assurance Register for Higher Education (EQAR), Karl Dittrich, si dhe me shumë personalitete tjera, me të cilët kanë shkëmbyer praktika të mira dhe është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Gjatë takimeve është vlerësuar jashtëzakonisht shumë roli dhe ndikimi i UBT-së në ngritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë.

Në praninë e dhjetëra pjesëmarrësve, i zhvilloi punimet konferenca "Towards small – scale innovation ecosystem in Kosovo"

Ndryshimet në botë nuk mund të injorohen

Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall u shpreh se bota po ndryshon sa i përket ekosistemit, meqë sipas saj, për të ndërtuar një ekosistem inovativ, tani duhet përfshirje e të gjitha palëve të interesit, përfshirë qeverinë, akademinë, organizatat joqeveritare, bizneset dhe qytetarët

Në UBT i zhvilloi punimet konferenca njëditore "Towards small – scale innovation ecosystem in Kosovo", me ç'rast përgjatë gjithë ditës, folës të shumtë vendorë e ndërkombëtarë u fokusuan në trajtimin e faktorëve të ndryshëm, që ndikojnë në krijimin e ekosistemeve të vogla dhe efektive, që synojnë krijimin dhe shpërndarjen e vlerave, duke u fokusuar më së shumti në rolin e arsimit.

Në hapje të konferencës, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se Kosova ka shënuar progres dhe zhvillim të vogël, por që nuk është mjaftueshëm për të arritur deri tek zhvillimi i qëndrueshëm.

"Duhet bërë një hap i ri për të diskutuar në nivel botëror, duke i dhënë shtysë ndërtimit të një ekosistemi që bazohet në faktorë socio-ekonomikë, teknologjikë, të mjedisit dhe faktorët legalë, në mënyrë që të krijojmë hartën strategjike të krijimit të ekosistemeve inovative", theksoi Hajrizi.

Ambasadorja e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall u shpreh se bota po ndryshon sa i përket ekosistemit, meqë sipas saj, për të ndërtuar një ekosistem inovativ, tani duhet përfshirje e të gjitha palëve të interesit, përfshirë qeverinë, akademinë, organizatat joqeveritare, bizneset dhe qytetarët.

"Bota po ndryshon dhe ne nuk mund t'i injorojmë këto ndryshime, prandaj ekosistemet më të qëndrueshme nuk janë më vetëm ato inteligjente, por ato që arrijnë të përshtaten me ndryshimet", u shpreh ajo.

Kryeministri në shkuarje i Kosovës, Ramush Haradinaj potencoi se Kosova momentalisht gjendet para dy sfidave të mëdha, urgjenca e rritjes së zhvillimit ekonomik dhe kujdesi ndaj të gjitha vlerave e ambientit ku ndodhet kjo ekonomi.

"Kosova gjendet pranë një emergjence të zhvillimit ekonomik, e në këtë rrugëtim shpeshherë duhet të bëhen kompromise të dhimbshme, por në këtë rrugëtim Kosova nuk është vetëm, pasi partnerët si Ambasada e Finlandës po përkrahin ekosistemet inovative në zhvillim", tha Haradinaj.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti me qëllim të ndërtimit dhe zhvillimit të ekosistemeve inovative, fokusin e vendosi tek sistemi i edukimit, prandaj u shpreh se në sistemin arsimor të Kosovës nevojitet digjitalizim dhe revolucion i thellë në praktikat e të mësuarit.

"Kosova dhe sistemi ynë arsimor ka nevojë për zhvillim të shkathtësive të cilat nuk i posedojmë ende, prandaj duhet ndryshuar qasjen tonë rreth edukimit, e për këtë kemi nevojë për revolucion në sistemin arsimor, pasi tek të rinjtë gjendet talenti, dija, e ardhmja e vendeve të punës dhe e ardhmja jonë", konstatoi Kurti.

Konferenca i vijoi punimet në tri sesione të, ku në përbërje të secili panel ishin anëtarë të akademisë, të qeverisë, ekspertë ndërkombëtarë dhe pjesëtarë të OJQ-ve vendore.

Në sesionin e parë u trajtua tema "Kosovo as a small ecosystem and what does it mean?", ku u trajtuan tema si Edukimi dhe dizajnimi i ekosistemit, mjedisi ekonomik, kampuset si ekosisteme t ndërmarr9sisë, etj, në lidhje me të cilat, pikëpamjet e tyre i ndanë rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik në shkuarje, Valdrin Lluka, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ligjërresja në UBT, Merita Gjyshinca – Peja dhe ligjëruesi në UBT, Bejtush Ademi.

Sesioni i dytë mblodhi në panel palë të interesit, të cilët diskutuan rreth temës kyçe "Digitalization, Innovation and Education as driving forces for a small ecosystem", me ç'rast përvojat dhe praktikat e tyre i ndanë ambasadorja e Kosovës, Pia Stjernwall, politikani dhe aktivisti nga Finlanda, Ilkka Taipale, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, drejtoresha ekzekutive e STIKK, Vjollca Cavolli dhe ligjëruesi në UBT, Ermal Lubishtani.

Panelistët u fokusuan në trajtimin e temave të rëndësishme, si inovacioni dhe drejtësia sociale, edukimi dhe inovacioni, digjitalizimi dhe ekosistemet ndërmarrëse.

Paneli i fundit i kësaj konference mblodhi ekpsrtë vendorë e ndërkombëtarë, për të trajtuar temën "Fostering Innovation in achieving the SDGs – Circular Economy and beyond", ku u shtruan çështje si edukimi dhe inovacioni, inovacioni dhe financat alternative, KIVO dhe ekonomia qarkore, prodhimi qarkor dhe proceset e dizajnimit të qëndrueshëm, dhe mbështetja e nismave inovative.

Këto tematika u trajtuan nga përfaqësuesi i UNICEF-it, Murat Sahin, përfaqësuesi i UNDP-së, Robert Pasciko, përfaqësuesi i biznesit "KIVO", Visar Ramajli, përfaqësuesi i biznesit "DYVO" Nikki Murseli dhe përfaqësuesi i "EBRO", Neil Tailor.

Përgjatë gjithë paneleve, pjesëmarrësit e shfrytëzuan mundësinë për të bërë pyetje dhe për të marrë informacione mbi të gjitha tematikat për të cilat shfaqën interesim, të lidhura me tematikën e konferencës dhe me hapat që duhet bërë Kosova për t'u përshtatur me ndryshimet globale dhe për të ndërtuar ekosisteme funksionale dhe inovative.

Në UBT mbahet takimi i parë mes partnerëve për jetësimin e projektit "Zhvillimi dhe implementimi i programit të PhD-së në TIK për sistemin arsimor të Kosovës"

Kosova ka nevojë për shkollë të doktoratës në fushën e IT-së

"Në aspektin e shërbimeve, sektori i IT-së është i vetmi që ka më shumë eksport se import, prandaj duhet menduar se si ta mbështesim këtë rritje në një dimension tjetër. Na duhet një shkollë e doktoratës për t'i rritur këto kapacitete në Kosovë dhe jam i lumtur që i kemi të gjitha palët e interesit për ta realizuar një gjë të tillë", tha rektori Hajrizi

Në UBT është zhvilluar takimi i parë për jetësimin e projektit "Zhvillimi dhe implementimi i programit të PhD-së në TIK për sistemin arsimor të Kosovës", i financuar nga programi Eramus+.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i një shkolle të PhD-së në nivel nacional, përkatësisht zhvillimin e një edukimi të ciklit të tretë në fushën e IT-së, që do të kontribuojë në ndërtimin dhe përgatitjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se ky projekt është një mundësi jo vetëm për krijimin e kuadrove, por edhe për ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve me bazë inovacionin dhe kërkimin, e sipas tij, fusha e IT-së ka potencial kryesor për këtë rritje dhe avancim.

"Në aspektin e shërbimeve, sektori i IT-së është i vetmi që ka më shumë eksport se import, prandaj duhet menduar se si ta mbështesim këtë rritje në një dimension tjetër. Na duhet një shkollë e doktoratës për t'i rritur këto kapacitete në Kosovë dhe jam i lumtur që i kemi të gjitha palët e interesit për ta realizuar një gjë të tillë", tha Hajrizi.

Ai theksoi se përmes këtij forumi, dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, do të ketë hapësirë për të reflektuar dje për të gjeneruar ide të reja.

Rektori i Universitetit të Prishtinës, dr. Marian Dema u shpreh se ky projekt do të ndihmojë Kosovën dhe universitetet vendore që të krijojnë dhe përmirësojnë nivelin e studimeve të doktoratës.

"Ky projekt do të na ndihmojë që të krijojmë ura komunikimi dhe shoqëri, me qëllim që ta bëjmë këtë botë më të mirë për të gjithë. Të bëjmë ndryshime nuk është e lehtë, por njerëzit i bëjnë ato dhe nëse punojmë së bashku është më e lehtë që të arrihen", vlerësoi ai.

Profesoresha në Linnaeus University, njëherësh edhe koordinatore e këtij projekti, dr. Anita Mirijamdotter, duke folur rreth rëndësisë së këtij projekti për sistemin arsimor në Kosovë, potencoi se ky projekt nuk do të ketë të bëjë vetëm me ndërtim të kapaciteteve humane, por edhe të krijojë një shkollë doktorate të përbashkët në nivel nacional, që do ta ndryshojë dhe ndihmojë shoqërinë.

"Kjo shkollë nuk do të ketë të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve të ndërtimit, por duhet të japë rezultate në hulumtim të aplikuar, që korrespondojnë me nevojat e shoqërisë kosovare. Se ky projekt ka qenë i nevojshëm, e tregon edhe mbështetja e madhe që e kam marrë nga shqiptarë të shumtë, të cilët kanë shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar jetësimin e këtij projekti", tregoi Mirijamdotter.

Përfaqësuesja e Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, Jenny Stenberg Sorvlod tha se falë këtij projekti Kosova do të ketë një mundësi për avancim të studentëve dhe profesorëve, prandaj kam shumë e lumtur që në këtë aspekt po punohet bashkërisht.

"Arsimi, hulumtimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të duhura është bazë për sukses të sektorit të IT-së dhe për krijimin e një shoqërie të përparuar. Prandaj, arsimimi në IT është shumë i rëndësishëm këtu, meqë kjo fushë është nxitëse që studentët e Kosovës të qëndrojnë dhe të japin kontribut këtu", konstatoi ajo.

Zyrtari politik i Ambasadës së Suedisë në Kosovë, Olle Ingvarsson deklaroi se arsimimi është një e drejtë fundamentale njerëzore dhe bazë për demokraci.

"Prej kur kam ardhur në Kosovë e kam parë që të rinjtë janë në kërkim të arsimit cilësor, kështu që nevoja për reformim të arsimit është tejet e nevojshme. Ky projekt është bazë për fillim të këtyre reformave, pasi Kosova ka talent dhe potencial të madh në fushën e IT-së. Andaj, duke krijuar arsim cilësor, krijohet rrugë për zhvillim të qëndrushëm ekonomik dhe për ndërtimin e një shoqërie prosperuese", theksoi Ingvarsson.

Drejtori për bashkëpunim ndërkombëtar në MASHT, Burim Gashi potencoi se ky projekt do të jetë fitimprurës si për institucionet arsimore dhe studentë në Kosovë, ashtu edhe për MASHT-in.

"Jemi këtu për të shprehur gatishmërinë tonë që ta përkrahim këtë projekt për ndërtim të kapaciteteve. Jemi të interesuar që ky projekt të ketë qëndrueshmëri sa më të gjatë", tha Gashi.

Përfaqësuesja e programit Erasmus+ në Kosovë, Jehona Lushaku u shpreh optimiste për suksesin e këtij projekti, meqë, sipas saj, për jetësimin e tij janë bashkuar universitetet më prestigjioze nga vendet skandinave, dhe jo vetëm, si edhe institucione arsimore shumë të njohura nga Kosova.

"Mundësitë që ofrohen nga Erasmus+ janë të shumta, sidomos në aspektin e zgjerimit të bashkëpunimit dhe financimit, prandaj duhet të shfrytëzohen sa më shumë mundësitë që i ofron Erasmus+ për të realizuar projektet dhe idetë tuaja", përfundoi Lushaku.

Në pjesën e dytë të këtij takimi, të pranishmit mbajtën fjalime të shkurtra me natyrë prezantuese për institucionet partnere të këtij konsorciumi, për të vazhduar tutje me prezantimin e qëllimit, objektivave dhe pritjet nga projekti, aktivitetet që do të organizohen, punën që do të kryhet dhe rolin e secilit partner në këtë proces, etj.

Partnerë implemetues në këtë projekt janë: NTNU University – Norvegji, SEERC – Greqi, Linneaus University – Suedi, UBT – Kosovë, Universiteti i Prishtinës – Kosovë, Universiteti i Prizrenit – Kosovë, Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë. Po ashtu, si partnerë të asociuar do të jenë të përfshirë edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, Kosbit Industry dhe BPB Bank.

Edicioni i tetë i i Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion

Mbi një mijë pjesëmarrës në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të UBT-së

730 hulumtues shkencorë, më shumë se 1 mijë pjesëmarrës, afro 500 punime shkencore dhe 21 fusha të ndryshme të studimit shkencor, po e pasurojnë edicionin e tetë të kësaj konference

Për të tetin vit më radhë, edhe këtë vit, Konferenca Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion e UBT-së mblodhi në Kosovë qindra akademikë dhe studentë nga dhjetëra shtete të ndryshme të botës.

Konferenca po rritet në secilin vit, si për nga numri i pjesëmarrësve, ashtu edhe për nga abstraktet dhe punimet shkencore që do të prezantohen përgjatë dy ditëve të konferencës.

730 hulumtues shkencorë, më shumë se një mijë pjesëmarrës, afro 500 punime shkencore dhe 21 fusha të ndryshme të studimit shkencor, po e pasurojnë edicionin e tetë të kësaj konference.

Ndonëse nuk ishte i pranishëm për shkak të mentorimit të ekipit të Kosovës në garën FIRST Global që po zhvillohet në Dubai, megjithatë rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, përmes Skype, i falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe kontributin e dhënë për bërjen e kësaj konference më madhështore.

"Unë jam duke e mentoruar ekipin e vajzave të reja që po e përfaqësojnë Kosovën në garën e robotikës, "FIRST Global", megjithatë dua t'ju falënderoj të gjithëve për praninë tuaj, pasi kësisoj po e krijojmë forumin më të madh në Ballkan për nisjen e bashkëpunimeve të reja dhe për ta shndërruar këtë konferencë në një platformë për ndarjen e ideve të reja dhe përvojave me të tjerët", u shpreh Hajrizi.

Sikurse edhe në edicionet e kaluara, edicionin e sivjetmë e pasuroi prania e profesorit nga Universiteti i Vjenës, dr. Peter Kopaçek, i cili duke kujtuar fillimet e UBT-së, tha se tani institucioni është rritur dhe është shndërruar në një qendër të arsimit cilësor.

Profesoresha e Universitetit Teknik të Vjenës, njëherësh edhe presidente e ICOMOS Austria, Caroline Jeagerklein vlerësoi se platformat e tilla shkencore duhet shfrytëzuar për të promovuar gjërat që kanë vlerë për një vend, siç është trashëgimia kulturore dhe bashkëpunimet e institucioneve arsimore në këtë sferë.

Profesoresha në Universitetin e Tiranës, Kozeta Sevrani theksoi se ekzistojnë shumë gjëra pozitive që mund të shpërndahen dhe se konferenca e UBT-së është ngjarja e duhur për ta bërë një gjë të tillë, konkretisht për të shpërfaqur ide, mendime, praktika të mira dhe përvoja të ndryshme.

Profesori në Universitetin e Shkencave të Aplikuara dhe Arteve në Zvicrën Perëndimore, François Lefort, në fjalën hyrëse të tij falënderoi UBT-në për organizimin e një konference të tillë, që sipas tij, po ndihmon në rrjetëzimin e institucioneve nga shumë vende të botës.

Qëllimi kryesor i kësaj konference është që të bëjë të mundur shkëmbimin e njohurive dhe shkathtësive në mes hulumtuesve, profesorëve, studentëve të doktoraturës dhe ekspertëve të ndryshëm nga industria. Andaj, për këtë qëllim, konferenca shtriu aktivitetin e vet në 21 fusha të ndryshme, që u mbajtën njëkohësisht, përfshirë fushat: Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri e Komunikimit; Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi; Mekatronikë, Inxhinieri e Sistemeve dhe Robotikë; Inxhinieri e Energjisë Efiçiente; Sisteme të Informacionit dhe Siguri; Arkitekturë – Planifikim Hapësinor; Inxhinieri Ndërtimore, Infrastrukturë dhe Ambient; Juridik; Shkenca Politike; Gazetari, Media dhe Komunikim; Shkenca të Ushqimit dhe Teknologji; Shkenca farmaceutike dhe Natyrore; Dizajn; Psikologji; Edukim dhe Zhvillim; Modë; Muzikë; Art dhe Media Digjitale; Stomatologji, si dhe Mjekësi e Aplikuar.

Konferenca shkencore "Challenges in Cyberspace II"

Siguria kibernetike dhe privatësia mbeten sfidë për Kosovën

"Aspekti i sigurisë është një çështje që merr për analizë të gjitha rrugët e digjitalizimit. Siguria nuk është model i mbyllur që mund të garantohet, kjo mbetet sfida që duhet më shumë punë. Të definojmë si faktor të rëndësishëm. Studentët të familjarizohen me ambientet, njohurit që kur të dalim në tregun e punës të jenë sa më mirë dhe praktikë. Të krijojmë një platformë bashkërisht që Kosova të jetë sa më e sigurt", tha rektori prof.dr. Edmond Hajrizi

Nën organizimin e Cyber Security and Privacy dhe UBT, është mbajtur konferenca shkencore "Challenges in Cyberspace II", ku ekspertët kanë trajtuar çështje lidhur me kuptimin e hapësirës kibernetike, sfidat, si dhe për rreziqet që i kanosen Kosovës në hapësirën kibernetike.

Hapjen e konferencës e ka bërë rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Harjizi, i cili theksoi se institucioni që ai drejton vazhdon të mbetet model ne rajon për nga programet akademike që lidhen me këtë fushë. Sipas tij, UBT është edhe institucioni i vetëm arsimor që ka krijuar CERT-in e akredituar dhe anëtarësuar në organizata të mëdha botërore.

Tutje, rektori Hajrizi potencoi se UBT gjeneron dije dhe njohuri të reja të përdorimit dhe për digjitalizimin, ku po përgatit gjenerata profesionale në fushën e sigurisë. Njëherësh, ai tha se institucioni ka potencial dhe vazhdimisht organizon të tilla ngjarje që i kushtohen hapësirës kibernetike.

"E mbështesim dhe e përkrahim çdo iniciativë që ndërlidhet me sigurinë kibernetike. Të gjenerojmë dije të reja, të krijojmë njohuri të reja. Aspekti i sigurisë është një çështje që merr për

analizë të gjitha rrugët e digjitalizimit. Siguria nuk është model i mbyllur që mund të garantohet, kjo mbetet sfida që duhet më shumë punë. Të definojmë si faktor të rëndësishëm. Studentët të familjarizohen me ambientet, njohurit që kur të dalim në tregun e punës të jenë sa më mirë dhe praktikë. Të krijojmë një platformë bashkërisht që Kosova të jetë sa më e sigurt", ka thënë rektori Hajrizi.

Përfaqësuesi në OSBE, Giovanni Di Persio, tregoi se janë duke u përgatitur projekte për vitin 2020, që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe edukimin e institucioneve dhe të rinjtë.

"OSBE ka shumë interes për sigurinë kibernetike. Për vitin 2020 jemi duke përgatitur aktivitete me institucionet. Projektet janë referuar për institucionet dhe gjeneratën e re", tha ai.

Mentor Hoxhaj nga CSP, ka paraqitur sfidat me të cilat Kosova po përballet në lidhje me sigurinë kibernetike dhe privatësinë.

"Banorët e hapësirë kibernetike nuk janë të njohur si qytetarë të Kosovës është një sfidë e madhe. Duhet të lidhemi llogarinë më vendet tjera. Sfidë e veçantë paraqet mos njohja e shteteve për Kosovën në sigurinë kibernetike dhe privatësinë", tha Hoxhaj.

Drejtor i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kujtim Gashi, potencoi se vendi ynë duhet t'i shfrytëzojë kuadrot e reja e mos të lejojë të ikin në vendet evropiane.

Tutje, Gashi ka përmendur hapat konkret që janë ndërmarrë në lidhje me sigurinë kibernetike dhe privatësinë.

"Ne si institucione kemi nevojë të marrim kuadro të reja, ti shfrytëzojmë si resurse e jo këto kuadro të gjejnë vetën në tregun e jashtëm. Institucionet e Kosovës kanë një infrastrukturë të konsoliduar për rritjen e sigurisë kibernetike në institucione por sfidat janë evidente. Kemi marr hapa konkret siç është sistemi ligjor në lidhje me sigurinë kibernetike, disa mekanizma institucional, menaxhimi i aspekteve dhe infrastrukturës. Krijua këshilli kombëtar për siguri kibernetike, Struktura përkatëse në institucione të cilët janë përgjegjës për teknologji", tha ai.

Ai ka njoftuar se e arritur institucionale është ndërtimi i qendrës për ruajtjen e të dhënave e cila përmban 350 serverë fizikë dhe vizualë, duke shtuar se në vitin e ardhshëm do të ndërtohet dalje në internet e cili do të afektojë hapësirat në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore.

Në kolegjin UBT - Dukagjini u mbajt konferenca shkencore, "Arritjet, sfidat dhe perspektiva e shëndetësisë në Komunën e Pejës

Kolegji Dukagjini – UBT, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore "Peja", kanë mbajtur konferencën shkencore, "Arritjet, sfidat dhe perspektiva e shëndetësisë në Komunën e Pejës", me panelistët, Ramadan Daci, Skender Dreshaj, Xhevat Kurhasani, drejtori i Shëndetësisë në Pejë, Skender Petrit Loci, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Engelbert Zefaj, si dhe përfaqësues nga zyra e kryetarit të komunës.

Në këtë konferencë morën pjesë mjekë dhe infermierë të Pejës, studentë dhe stafi akademik i UBT-së dhe Kolegjit Dukagjini.

Në kuadër të konferencës u prezantuan punime të shumta shkencore me tema aktuale të shëndetësisë, ku autorët prezantuan të gjeturat dhe rezultat e kësaj fushe, të arriturat, sfidat, etj.

Gjithashtu, konferenca shërbeu edhe si mundësi që të pranishmit të diskutojnë dhe të trajtojnë çështje të ndryshme në shëndetësinë e komunës së Pejës, teksa thanë edhe konkluzione se si të ndryshohet gjendja aktuale e sektorit të shëndetësisë në këtë qytet.

Studentët e UBT-së hapën ekspozitë në manifestimin "Ditët e Diasporës" në Ferizaj

Në kuadër të aktiviteteve të manifestimit "Ditët e Diasporës", në bulevardin e qytetit të Ferizajt, Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, ka hapur ekspozitë me punimet e studentëve.

Në këtë ekspozitë janë prezantuar vepra të shumta arkitektonike të studentëve që i kanë realizuar në kuadër të detyrave semestrale, me ç'rast qytetarët patën rastin të shohin vepra të ndryshme të ekspozuara.

Ekspozita e studentëve të UBT-së, si dhe aktivitetet tjera janë organizuar nën patronazhin e kryetarit të Komunës së Ferizajt, me qëllim që pushimet e bashkatdhetarëve ne vendlindje të bëhen me të veçanta.

Në kuadër të projektit "Balkan Booster"

UBT dhe Deutsche Welle nxisin median kosovare t'i kushtojë vëmendje më të madhe mjedisit

Projekti mblodhi bashkë gazetarë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët gjatë këtij debati folën gjerësisht për raportimet e mediave për ndotjen e ajrit e ujit, riciklimin e mbeturinave, ndërtimin e hidrocentraleve, përdorimin e burimeve natyrore dhe çështje që kanë të bëjnë me mjedisin në vendet rajonale

Mbi 20 gazetarë nga Gjermania, Ballkani Perëndimor dhe vendet anëtare të BE-së, në kuadër të projektit "Balkan Booster", kanë marrë pjesë në debatin e organizuar nga Fakulteti i Medias dhe Komunikimit në UBT dhe Radio Deutsche Welle, me temë diskutimi: "Degradimi i mjedisit dhe qasja e medias ndaj mjedisit".

Projekti mblodhi bashkë gazetarë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët gjatë këtij debati folën gjerësisht për raportimet e mediave për ndotjen e ajrit e ujit, riciklimin e mbeturinave, ndërtimin e hidrocentraleve, përdorimin e burimeve natyrore dhe çështje që kanë të bëjnë me mjedisin në vendet rajonale.

Pjesë e këtij debati ishte edhe drejtoresha e Departamentit të Programeve për Evropë në Deutsche Welle, Adelheid Feilcke, e cila theksoi se gazetarët duhet të tërheqin vëmendje përmes raportimeve mediale, për problemet mjedisore, por edhe të tregojnë zgjidhje të mundshme.

Ajo falënderoi UBT-në që mundësoi dhe mbështeti organizimin e debatit, teksa shtoi se gjeneratat e ardhshme të gazetarëve duhet të motivohen për të raportuar për problemet mjedisore.

"Kemi bashkëpunim me UBT-në, dhe jemi mirënjohës që na mundësuan ardhjen në Kosovë. Këtu kemi kolegë nga Ballkani dhe shtete tjera, por e mira e këtij projekti është se gazetarët do të prezantojmë përvojat lidhur me raportimet për problemet mjedisore", tha ajo.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Ferid Selimi, theksoi se fakulteti që ai drejton, është një nga departamentet më të kompletuara për studim, ku u ofron gazetarëve të rinj njohuri dhe përgatitje profesionale për raportim edhe në fushën e mjedisit.

Dekani Selimi tha se Deutsche Welle është medium për t'u marrë shembull, pasi, siç tha ai, ishte dritare e informimit dhe raportimit për çështjet që ndodhnin në Kosovë.

"Deutsche Welle është mediumi më i respektuar në Kosovë, sepse ka dhënë provimin për raportim objektiv mbi ngjarjet që karakterizuan vendin dhe në përgjithësi shqiptarët. Besoj që edhe ky debat, do të kontribuojë pa dyshim në raportim të saktë edhe për çështjet mjedisore", vlerësoi Selimi.

Profesori në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, Safet Zejnullahu, tha se organizimi i debatit është frymëzues për gazetarët e rinj.

Profesori Zejnullahu theksoi se duhet sensibilizim për ndotjen dhe degradimin e mjedisit.

"Mjedisi nuk mbrohet vetëm me ligj dhe me aksione të ndryshme e vullnetare, por duhet të ketë edhe vetëdijesim të popullatës", tha ai.

Në kuadër të këtij debati u prezantuan rezultatet e nxjerra nga hulumtimi i profesorit në UBT, Dr.Afrim Syla, më temë: "Degradimi i Mjedisit në Kosovë", dhe nga hulumtimi i asistentëve, Ejup Gojnovci dhe Anisa Rada, më temë: "Trajtimi i mjedisit nga mediat në Kosovë".

Profesori Syla, përmes një hulumtimi shterues, paraqiti gjendjen e mjedisit në Kosovë, që është në nivelin për të cilin duhet të shqetësohen të gjithë, edhe institucionet edhe qytetarët.

Ai identifikoi të gjitha burimet kryesore të degradimit të mjedisit, në të gjitha rajonet e Kosovës, si dhe shpjegoi në terma profesionalë dëmet dhe rreziqet tepër të mëdha që paraqiten tash, por që do të jenë edhe më të mëdha, nëse degradimi i mjedisit vazhdon.

Ndërsa profesori Gojnovci, pas një analize shteruese bërë raportimit të medieve në Kosovë për çështje mjedisore, konstatoi se numri i artikujve që trajtojnë tema rreth degradimit të mjedisit, për fat të keq, është ende i vogël dhe jo në nivelin e duhur që kjo temë kërkon.

Pas debatit, drejtoresha e Departamentit të Programeve për Evropë në Deutsche Welle, Adelheid Feilcke, së bashku me gazetarët ndërkombëtarë, vizituan Kampusin Inovativ të UBT-së në Lipjan dhe laboratorët që institucioni i posedon për media të shkruara dhe audiovizuele. Ata panë nga afër edhe Bibliotekën e UBT-së, që është e pasuruar me 250 mijë libra dhe mbi 52 mijë tituj.

UBT mori pjesë në konferencën e Komitetit Nacional "CIGRE", nderohet me mirënjohje

Profesorët e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë në UBT, Nexhmi Krasniqi, Besa Veseli, Nafije Shabani dhe Ines Bula-Bunjaku, kanë përfaqësuar UBT-në në konferencën e parë të Komitetit Nacional "CIGRE", që po zhvillon punimet në Prishtinë.

Konferenca është përkrahur në çdo aspekt nga UBT, ku në emër të rektorit, prof.dr Edmond Hajrizi, ka folur profesoresha Ines Bula-Bunjaku, e cila ka prezantuar sukseset e institucionit ndër vite.

Tutje, ajo ka treguar për angazhimin dhe përkrahjen që UBT i jep sektorit të energjisë në vend dhe rajon.

Pjesë e kësaj konference ishin edhe studentet ambasadore të Fakultetit Inxhinieri e Energjisë në UBT, Djellza Prebeza dhe Fijona Kurshumliu.

Për përkrahjen e vazhdueshme dhënë sektorit të energjisë, si dhe mbështetjen e dhënë për hulumtime shkencore në këtë fushë, organizatorët e konferencës i kanë ndarë UBT-së mirënjohje, si sponsor i artë i konferencës, pranuar nga drejtori për Çështje Akademike, Muhamet Ahmeti.

CIGRE është Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike dhe njëra prej organizatave kryesore ndërkombëtare e cila merret me aspekte teknike, ekonomike, organizative dhe rregullatorëve të Sistemeve Elektroenergjetike (SEE).

Kjo organizatë është me seli kryesore në Paris, themeluar nga Mehmet Bula, dhe merret kryesisht me çështjet profesionale dhe shkencore si nga sfera vendore dhe ndërkombëtare, në lidhje me prodhimin, transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, prodhimin e pajisjeve elektrike, si dhe me çështjet e sistemit të energjisë elektrike.

Në UBT u mbajt konferenca “Udhëheqja dhe Menaxhimi në Kosovë – Edukimi, Biznesi dhe Teknologjia”

Përvoja sllovene, e rëndësishme për Kosovën

Ambasadori i Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncelj u shpreh i lumtur me atë që ka arritur Kosova përgjatë këtyre viteve, sidomos në fushën e edukimit, teksa tregoi që Sllovenia do të vazhdojë edhe më tej ta mbështesë Kosovën, veçanërisht përmes bashkëpunimit në kuadër të projekteve të përbashkëta

UBT ishte nikoqir i edicionit të katërt të konferencës ndërkombëtare, “Udhëheqja dhe Menaxhimi në Kosovë – Edukimi, Biznesi dhe Teknologjia”, që u organizua nga UBT, Shkolla Ndërkombëtare për Studime Sociale dhe të Biznesit, në Sllloveni, dhe Universiteti i Prishtinës.

Pesha e tematikës së kësaj konference mblodhi dhjetëra njerëz nga akademia, përfaqësues institucionesh dhe partnerë ndërkombëtarë, të cilët diskutuan mbi përshtatjen e shoqërisë me zhvillimet dhe ndikimin e teknologjisë dhe digjitalizimit në fushën e edukimit, si dhe përshtatjen e tyre me nevojat e shoqërisë moderne.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se një konferencë e tillë do të shërbejë si platformë e shkëmbimit të përvojave dhe e ndërlidhjes së teknologjisë dhe biznesit me fushën e edukimit.

“Ne duhet të mendojmë se si të orientojmë edukimin në një kohë kur digjitalizimi po përhapet masivisht edhe në Kosovë. Prandaj, është e rëndësishme që t’i kombinojmë dhe ndërlidhim këto fusha sepse momentalisht jemi duke jetuar në revolucionin e konvergjencës dhe njohurive digjitale”, tregoi Hajrizi.

Ambasadori i Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncelj u shpreh i lumtur me atë që ka arritur Kosova përgjatë këtyre viteve, sidomos në fushën e edukimit, teksa tregoi që Sllovenia do të vazhdojë edhe më tej ta mbështesë Kosovën, veçanërisht përmes bashkëpunimit në kuadër të projekteve të përbashkëta.

“Aktualisht në Sllloveni janë duke studiuar rreth 2000 studentë kosovarë. Megjithatë, po synojmë që bashkëpunimin tonë ta zgjerojmë në aspektin shkencor, sepse me eksperiencën tonë të përbashkët do të jemi në gjendje të japim zgjidhje mbi problemet që po i preokupojnë shoqëritë tona moderne”, potencoi ambasadori Bertoncelj.

Dekani i Fakultetit të Edukimit në UP, prof. dr. Ethem Çeku theksoi se kjo konferencë është formë e paraqitjes dhe shkëmbimit të mendimeve, por sidomos për gjetjen e formave që të kalohen sfidat me të cilat po përballet sistemi arsimor në Kosovë.

“Ne si fakultet kemi bërë ndryshime të shumta, në përpjekje që t’i përshtatemi nevojave të tregut kosovar të punës, por edhe kërkesave që ta përshtatim arsimin në Kosovë me atë që po zhvillohet në botë”, përfundoi ai.

Themeluesi i Shkollës Ndërkombëtare për Studime Sociale dhe të Biznesit, në Sllloveni, prof. dr. Dušan Lesjak tha se është i kënaqur me bashkëpunimin e ndërmjet tri institucioneve, duke u fokusuar gjithmonë në përmirësimin e nivelit të arsimit në Kosovë.

“Vetëm përmes krijimit të objektivave të përbashkëta mund të adresojmë sfidat e arsimit sot, por edhe mundësitë që lindim prej tij”, konstatoi Lesjak.

Sesioni i parë i kësaj konference u zhvillua me prezantimin e hulumtimeve dhe punimeve shkencore, nën temën: “Udhëheqja në edukim”, në të cilën prezantuan tematikat: “Cilësia në edukim për zhvillim të qëndrueshëm – Nevoja për edukim të ri”, nga prof. dr. Edmond Hajrizi dhe dr. Dugagjin Sokoli, “Edukimi për zhvillimin ekonomik në Kosovë”, nga prof. dr. Ethem Çeku dhe prof. dr. But Dedaj, “Udhëheqja për të mësuar dhe cilësia në mësimdhënie”, nga prof. dr. Nada Trunk Širca dhe Andrej Koren, nga Sllovenia.

Sesioni i dytë i konferencës përfshiu punimet “CAPSIM – Standardi i ri në të mësuarit e biznesit” nga Carlos Gutierrez, “Ndikimi i kapitalit institucional dhe njerëzor në performancën ekonomike: Prova nga Ballkani Perëndimor” nga Armend Muja dhe “Sfidat në vendet e punës në Evropë” nga prof. dr. Dušan Lesjak.

Në sesionin e fundit të konferencës u prezantuan tematikat “Zhvillimi i qëndrueshëm në Kosovë – Një cikël i normave, politikave dhe realitetit” nga Zeqir Veselaj, “Niveli i kuptimit dhe implementimi i standardeve të praktikave profesionale për udhëheqësit e shkollave në Kosovë: Studim në standardin “Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies” nga Fatjona Bislimi dhe Osman Buleshkaj, “Rishikimi dhe analizimi i librave shkollorë nga klasa e parë deri në të pestën, për të mbështetur zhvillimin e mendimit kritik tek nxënësit” nga Mensur Neziri, “Analizimi i faktorëve që e ndikojnë përzgjedhjen e fushës së studimit: Rasti i Fakultetit të Edikimit në UP” nga Anton Gojani dhe Hajrije Devetaku, si dhe “Ndikimi i ESP-së në studentët e nivelit master, pas përfshirjes në syllabusin e Fakultetit të Edukatës Fizike dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës” nga Osman Osmani.

Konferenca u përmbyll me diskutim, në të cilin i përfshinë të pranishmit, të cilët parashtruan pyetje të shumta lidhur me zhvillimin e sektorit të edukimit në Kosovë, teksa pjesëmarrësit u certifikuan për kontributin e dhënë dhe për pjesëmarrjen e suksesshme në konferencë.

SYRI

Programet zhvillimore Erasmus+ dhe Horizon Cosme

UBT, përfituese e projekteve milionëshe nga Komisioni Evropian

Projektet e përfituara janë: "Accelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies", "The development and implementation of PhD Curricula in ICT for Kosovo Education System","Quality development of international cooperation and project management" dhe "Enterprise platform for fostering, modernization and sustainable growth in natural stone industry in Western Balkans"

Komisioni Evropian përmes programeve zhvillimore si Erasmus+ dhe Horizon Cosme, po ndihmojnë vendet si Kosova për implementimin e praktikave më të mira në fushën e arsimit të lartë.

Duke qenë kështu, UBT ka arritur të përfitoj projekte të shumta përgjatë 18 viteve të ekzistimit, projekte që ndihmuan në zgjerimin e rrjetit të ndërkombëtarizimit të vendit, si dhe rritjen e numrit të bashkëpunimeve me universitetet botërore.

Së fundmi, pas shpalljeve të rezultateve të projekteve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë, UBT është përfituesi më i madh i projekteve për modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e arsimit, ku si institucion përfitoi pesë projekte me vlerë milionëshe, nga gjithsej 18 projekte sa janë financuar në Ballkanin Perëndimor.

Projektet e përfituara janë: "Accelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies", "The development and implementation of PhD Curricula in ICT for Kosovo Education System","Quality development of international cooperation and project management" dhe "Enterprise platform for fostering, modernization and sustainable growth in natural stone industry in Western Balkans".

Këto projekte do të jenë mundësi ideale për të ndërtuar ura të reja të bashkëpunimit, teksa këto projekte do të jetësohen në afat prej tri vitesh.

Si institucion i dëshmuar për cilësi dhe inovacion, për çka edhe u vlerësua e certifikua me çmimin e ekselencës me pesë yje nga EFQM, UBT është institucioni arsimor në Kosovë që ka fituar më së shumti projekte ndërkombëtare, që kanë ndikuar edhe në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit me 450 universitete dhe institucione tjera ndërkombëtare.

Në UBT dhe në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës

Projekti "diMTV" bashkon përsëri në Kosovë partnerët dhe implementuesit e këtij projekti

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, përfaqësuesja e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Albana Halili dhe përfaqësuesja e Universitetit të Prishtinës, Mimoza Ibrani, kanë shfaqur para pjesëmarrësve të arriturat institucionale dhe arritje e deritashme në kuadër të projektit "diMTV"

Në UBT po i zhvillon punimet punëtoria dyditore në kuadër të projektit të financuar nga Erasmusë, "diMTV", i cili ka bërë bashkë dhjetëra ekspertë nga universitetet partnere në kuadër të këtij projekti.

Ky takim është zhvilluar kësaj here në Kosovë, me ç'rast pjesëmarrësit, të ndarë në dy grupe punuese paralele, kanë mbajtur në UBT takimin koordinues për të bërë evaluimin e arritjeve të deritashme në kuadër të projektit dhe analizën e buxhetit.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, përfaqësuesja e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Albana Halili dhe përfaqësuesja e Universitetit të Prishtinës, Mimoza Ibrani, kanë shfaqur para pjesëmarrësve të arriturat institucionale dhe arritje e deritashme në kuadër të projektit "diMTV".

Në anën tjetër, pjesa e dytë e projektit u zhvillua në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, ku përfaqësuesit e UBT-së dhe të institucioneve tjera kontribuuese në këtë projekt, kanë marrë pjesë në një punëtori të përbashkët për animacion.

Dita u përmbyll me vizitën e realizuar në kampusin e UBT-së në Prishtinë dhe në Kampusin Inovativ në Lipjan, ku pjesëmarrësit panë të arriturat dhe investimet e UBT-së për zhvillim të laboratorëve, veçanërisht të atyre në fushën e multimedias, përfshirë këtu edhe laboratorin që u krijua përmes projektit "diMTV".

Minxhozi ndan mirënjohje për inxhinierët në UBT dhe MTI, për ndihmën e dhënë Shqipërisë

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka ndarë mirënjohje ekspertëve, njëherësh profesorëve në UBT, dhe inxhinierëve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit të Kosovës, për ndihmën profesionale dhënë Shqipërisë, në vlerësimin e objekteve dhe shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit, me magnitutë 6.4 shkallë rihter.

Me këtë rast, ambasadori Minxhozi tha se grupi i ekspertëve i përbërë nga profesorë të UBT-së dhe MTI-së, veproi më shpejt duke dhënë ekspertiza tejet profesionale.

"Kosova ishte e para me ushtri dhe qytetarë. Si dhe me inxhinierët për të cilët jemi krenar. Kjo që ndodhi ishte fatkeqësi, por do të zbutet me një pjesëmarrje të përbashkët. Është një mësim për studentët, politikanët, mos të bëjnë punën me vulë nga njerëzit, por me profesionalizëm", tha ambasadori Minxhozi.

Ndërkaq, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, tha se UBT gjithnjë do të jetë i gatshëm si institucion të mobilizojë grupe të inxhinierëve dhe tu dalë në ndihmë vendeve të prekura.

"Ne si institucion i arsimit të lartë do të vazhdojmë më tutje me raporte dhe vlerësime shtesë të ndihmojmë sado që kemi mundësi. Shpresoj që mos të kemi takime të tilla, por bashkëpunimi është shembull i mirë që mund të veprohet edhe në raste tjera", theksoi rektori Hajrizi.

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, falënderoi grupin punues që veproi në Shqipëri, teksa tha se institucioni që ai drejton do të jetë në gjendje gatishmërie.

"Që nga minuta e parë që kemi pasur informacione, Qeveria e Kosovës ka qenë në gjendje gatishmërie. Nuk kemi bërë asgjë më shumë as më pak se sa bën vëllai për vëllanë. Ne duhet të jemi bashkë, dhe sigurisht falënderoj profesionistët e MIT-it dhe UBT-së të cilët keni sakrifikuar të shkoni në zonat më të vështira për të vlerësuar ndërtesat", tha Lekaj.

Ekspertët dhe profesorët në UBT, vizituan zonat më të prekura nga tërmeti, ku qëndruan disa ditë në Shqipëri për të inspektuar dhe për të dhënë rekomandime profesionale lidhur me ndërtimet.

Dita Botërore e Mjedisit

Në Ditën Botërore të Mjedisit, UBT shndërron shishet e plastikës në vazo zbukuruese për lule

Stafi dhe studentët e UBT-së, në Ditën Botërore të Mjedisit, e kanë realizuar një aksion simbolik të grumbullimit të shisheve të plastikës dhe përdorimin e tyre si vazo zbukuruese për lule në rrethojat e Kampusit Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Ky aktivitet është bërë me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve për dëmin e përdorimit të shisheve të plastikës, dhe për më tepër, dëmtimin e tokës nga mbeturinat plastike, të cilave u duhen mijëra vite kohë për t'u dekompozuar.

Aktiviteti është realizuar nën organizimin e ligjëruesës në UBT, Afete Musliu, teksa morën pjesë edhe ligjëruesët, Emine Daci, Lorikë Salihu dhe Lumnije Ajdini.

Dita Ndërkombëtare e Mjedisit është caktuar 45 vjet më parë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me qëllim për të shtuar vetëdijen rreth çështjeve të mjedisit dhe për të tërhequr vëmendjen politike ndaj këtyre çështjeve, si dhe për të nxitur veprimin individual në këtë drejtim.

Programet zhvillimore Erasmus+ dhe Horizon Cosme

Rektori Hajrizi mori pjesë në konferencën shkencore, "Kosova 20 vjet liri dhe përpjekje"

Me ftesë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në konferencën shkencore, "Kosova 20 vjet liri dhe përpjekje", organizuar nga UP për nder të 20-vjetorit të çlirimit.

Në këtë konferencë njëditore, rektori Hajrizi ka prezantuar punimin e tij shkencor më temë: "Zhvillimi i arsimit të lartë në Kosovë, 20 vite pas – Sfidat".

Me këtë rast, ai ka thënë se arsimi është qelës i zhvillimit dhe investim për të ardhme më të mirë, andaj, sipas tij, duhet të investohet dhe të punohet në kurrikula dhe programe sa më cilësore.

Rektori Hajrizi theksoi se institucioni që ai drejton, UBT, qe gati 18 vjet ka krijuar një sistem arsimor cilësor dhe ka sjellë në vend praktikat më të mira të institucioneve arsimore me renome ndërkombëtare.

Tutje shtoi se UBT i ka dhënë vendit kuadro profesionale dhe si institucion e përfaqëson Kosovën në gara dhe ngjarje ndërkombëtare.

Në kuadër të konferencës janë prezantuar punime të shumta shkencore të studiuesve dhe profesorëve nga universiteti i New York-ut, Universiteti i Oksfordit, si dhe shumë universitete vendore, rajonale dhe evropiane.

Punimet që ata prezantuan për fokus kishin rrugëtimin e Kosovës deri tek liria, pavarësia e deri më sot.

Projektet inovative të UBT-së u prezantuan në DokuTech

Si institucion arsimor që i ka paraprirë ndryshimeve dhe inovacioneve teknologjike në Kosovë, me ftesë të organizatorëve, UBT ishte pjesë e organizimit "DokuTech", ku prezantuan disa projekte të studentëve të Mekatronikës në UBT.

Edicioni i 6-të i DokuTech shpalosi tema të ndryshme mbi digjitalizimin dhe mbi disa koncepte se çfarë pritet të ndodhë në të ardhmen.

Në kuadër të këtij eventi u mbajt edhe një punëtoria "Do It Yourself", ku UBT prezantoi projekte të ndryshme të studentëve nga Laboratori i Mekatronikës.

Studentet prezantuan projekte të punuara nga ta, si: Service Robot, Obstacle Robot, Autonom Cleaner Robot, Balance Robot, CNC Machine, Gesture Robot Control, etj. Po ashtu, u prezantua edhe programi i Mekatronikës dhe metodologjia e punës që orientohet në pjesën praktike, pra laboratorike.

Studentët dhe stafi i UBT-së në shërbim për komunitetin

Personat me nevoja të veçanta vizitojnë UBT-në

Nën shoqërimin e përfaqësuesve të organizatës "Handikos", personat me nevoja të veçanta kanë vizituar UBT-në, ku janë pritur nga studentët dhe stafi i Fakultetit të Stomatologjisë.

Fillimisht atyre u është bërë kontrolli i dhëmbëve, u janë ndarë dhurata për mbajtjen e higjienës orale, si dhe u këshilluan për të mos anashkaluar kontrollet tek dentisti.

Gjithashtu, fëmijët zhvilluan aktivitete të përbashkëta në ambientet rekreative të UBT-së, teksa të lumtur u shprehën se kanë kaluar një ditë të mrekullueshme.

Kryeshefi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës ligjëron për studentët e UBT-së për mineralet gjeologjike

Në vazhdën e ligjëratave tematike, kryeshefi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, Fidaim Sahiti ka mbajtur ligjëratë për studentët e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT.

Në kuadër të temës "Mineralet gjeologjike ndërtimore dhe dekorative", ai u shpjegoi studentëve mineralet që përdoren në fushën e ndërtimit, duke përmendur edhe rezervat dhe kapacitetet gjeologjike që ka Kosova.

Tutje, ai shprehu gatishmërinë të bashkëpunoj me studentët dhe stafin e UBT-së në zhvillim dhe avancim profesional në këtë fushë, teksa falënderoi institucionin për organizimin e kësaj ligjërate tematike.

Në kuadër të Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë ftohen të mbajë ligjërata tematike ekspertë të fushës së ndërtimtarisë, me qëllim për të ndarë përvojat e tyre profesionale me studentët.

Anëtarët e Down Syndrome Kosova vizitojnë UBT-në dhe marrin këshilla mbi shëndetin oral



Anëtarët e Down Syndrome Kosova kanë vizituar UBT-në, ku janë takuar me studentët dhe stafin e Fakultetit të Stomatologjisë, me të cilët kanë kaluar kohë të mrekullueshme dhe përplot me aktivitete.

Atyre u është bërë kontrolli i dhëmbëve dhe gojës, si dhe së bashku diskutuan për shëndetin oral, pastrimin e dhëmbëve, kontrollin tek dentisti, të ushqyerit shëndetshëm, si dhe shumë tema tjera informative dhe shumë interesante për ta.

Në fund, të gjithë anëtarët e Down Syndrome Kosova u shërbyen me pije dhe ëmbëlsira, teksa kaluan kohë edhe në hapësirat rekreative të UBT-së.

Ky takim u përmbyll në formën më të mirë të mundshme, me shpërndarjen e dhuratave për mbajtjen e higjienës orale, lapsa dhe gjësende tjera, të cilat mund t'i shfrytëzojnë në baza ditore.

Stafi dhe studentët e UBT-së i bashkohen aksionit për dhurim vullnetar të gjakut

Nën moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", një numër i madh i studentëve dhe stafit akademik e administrativ i janë bashkuar thirrjes për dhurim vullnetar të gjakut, aksion i cili është zhvilluar në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Aksioni humanitar është organizuar nga Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, ku UBT çdo vit e përkrah këtë fushatë për sensibilizimin e njerëzve për të shpëtuar jetë atyre që janë në nevojë, teksa dozat e mbledhura të gjakut do t'i shërbejnë QKUK-së në rastet emergjente.

Ky aktivitet tashmë është bërë tradicional në UBT, ku i përgjigjen pozitivisht qindar studentë dhe punëtorë.

Licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale

Qyteti inovativ i UBT-së tani edhe me barnatore farmaceutike

Klinikave, ambulancave shëndetësore dhe rreth 80 laboratorëve mjekësorë në Kampusin e UBT-së i shtohet edhe barnatorja farmaceutike, e licencuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Kjo barnatore, e para e këtij lloji që hapet nga një institucion i arsimit të lartë në Kosovë, do të jetë një ndihmesë e madhe për studentët e Farmacisë. Në të, ata do të kryejnë pjesën e punës praktike, për të arritur nivel sa më të lartë profesional, para se të dalin në tregun e punës. Kombinimi i mësimit teorik dhe praktik e bën UBT-në të dallohet dhe të jetë model për gjitha universitetet dhe kolegjet private në Kosovë, pasi ai u mundëson studentëve të përfitojnë aftësitë e nevojshme për të bërë punën në mënyrë efektive në profesionin që ata zgjedhin.

Studentët e Dizajnit të Integruar realizojnë ekspozitën "Sphalerite"

Studentët e Dizajnit të Integruar kanë shfrytëzuar hapësirën e bukur që Sahat-Kullës për të realizuar ekspozitën e titulluar "Sphalerite".

Vlerat kulturore të Sahat-Kullës janë ndërlidhur dhe me Trepçën dhe kështu filloi dhe nisja e konceptit. Gjatë procesit të hulumtimeve të realizuara në kuadër të lëndës "Menaxhim i Projekteve", pasuritë e Trepçës arritën të marrin formë në veshjet e dizajnerëve të modës, edhe me një instalacion të dizajnerëve të enterierit.

Këto janë edhe pikënisjet e para që studentët i kanë diskutuar gjatë semestrit me profesorët e tyre, mirëpo përfundimi ishte që, ekspozita nuk ka përgjigje, por ka diskutim, ku pyetja është përgjigje në vete.

Sphalerite është njëri nga mineralet e shumta që është përzgjedhur, ku nga ngjyra, forma dhe historia, u nisën hapat e frymëzimit për këtë ekspozitë. Vlerat e panumërta që ekzistojnë në Trepçë janë ato që rrisin kuriozitetin në çdo aspekt kulturor, po në këtë rast nga ana kreative.

Lidhshmëria nga hapësira ekspozuese (Muzeu), me dizajn mode dhe enterieri, thyen kufijtë e tabusë, që janë të theksuara me ideologjinë "Ekspozitë Arti".

Ekspozita në të njëjtën kohë përcolli edhe mesazh për pasuritë tona, dhe konfliktet që po ndodhin rreth saj, duke treguar se sa gjëra të vlefshme përmban vendi ynë.

UBT ka është licencuar nga ETS

UBT licencohet nga ETS si qendër testuese për ibt-TOEFL

Duke e ditur nevojën e madhe dhe rëndësinë që ka testi TOEFL për regjistrim të studimeve brenda dhe jashtë vendit, si dhe, duke e pasur parasysh që në ditët e sotme është tejet e nevojshme për punësim dëshmia e njohjes së gjuhës angleze, UBT ka aplikuar dhe ka përmbushur të gjitha kriteret profesionale, për çka edhe është licencuar nga ETS.

Prej tash, UBT është ndër qendrat shumë të pakta në Kosovë që është certifikuar nga ETS, si CTAS (Certified Test Administration Service), si qendër testuese për ibt-TOEFL. Më shumë se 10,000 universitete, kompani dhe organizata, e njohin rezultatin e testit TOEFL, madje, edhe e përdorin si referencë të gjuhës, që ju ndihmon për të marrë vendime të mëdha, si pranimi në punë apo nisja e vazhdimi i studimeve.

Në Kolegjin Arbëri – UBT u mbajt sesion informues për ndihmë juridike falas

Kolegji Arbëri – UBT, në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit, Odën e Avokatëve të Kosovës, organizatën CLARD, si dhe Njësia për ndihmë juridike falas, në kuadër të projektit "Ndihma Juridike", kanë mbajtur sesion informues për studentët e Juridikut, në Gjilan.

Ky projekt është përkrahur nga UNDP, teksa panelistë të këtij sesioni ishin zyrtarë të institucioneve përkatëse, të cilët i informuan studentët për kornizën ligjore të ndihmës juridike, rolin dhe punën e avokatëve në këtë drejtim.

Po ashtu, studentët u informuan lidhur me qasjen dhe shërbimet që ofrohen në zyrën rajonale për ndihmë juridike falas në Gjilan.

Pas diskutimit të panelistëve me studentët, ata ranë në përfundim se duhet promovim më i madh për ndihmën falas juridike në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga kjo mundësi.

UBT, institucioni që punëson më së shumti studentë

Procesi i sistemimit në tregun e punës është sfidë për studentët e kualifikuar në Kosovë, por këtë problem nuk e kanë studentët e UBT-së.

Institucioni ka zgjedhur të angazhojë dhe të punësojë studentët e vet, me të vetmin qëllim që ata të japin ekspertizat profesionale në departamentet përkatëse në UBT.

Studentët fillimisht vijojnë studimet në fakultetet unike të akredituara në UBT, trajnohen profesionalisht, ndjekin kurse dhe shkolla profesionale që ofrohen nga institucioni, zhvillojnë vizita studimore brenda dhe jashtë vendit, por sigurojnë edhe pozicione të punës përbrenda institucionit.

Ata kanë aftësi të larta shoqërore dhe analitike, janë produktivë dhe punojnë drejt qëllimit të përbashkët të UBT-së, për arsim profesional, inovacion, cilësi dhe për ta mbajtur UBT-në si destinacionin e parë të të rinjve që duan ta ndjekin rrugën akademike.

Trendi i punësimeve të studentëve të kualifikuar nëpër departamentet e UBT-së vazhdon të rritet ndër vite. Në vitin 2016, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, prej tyre 33 për qind ishin studentë e ish-studentë të UBT-së. Ndërkohë, kjo përqindje është rritur në vitin 2018, në 34 për qind.

Kësisoj, UBT përveç që përgatit gjeneratat e reja për të dhënë kontribut në të gjitha fushat jetësore, po ndikon pozitivisht edhe në uljen e papunësisë në mesin e të rinjve kosovarë.

Madje, sipas raportit të Agjencisë Statistikore të Kosovës, del që UBT është institucioni i parë i arsimit të lartë privat në vend edhe për nga numri i stafit akademik dhe administrativ.

Rrëfime suksesi

Studentja Erona Jakaj, arkitekte në zyrën projektuese "Smart Project"

Erona Jakaj është në mesin e qindra studentëve që është punësuar ende pa përfunduar studimet. Ajo aktualisht është duke vijuar studimet e nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT.

Si arkitekte, Erona është duke punuar në zyrën projektuese "Smart Project", në Prishtinë, ku në kuadër të kësaj kompanie zhvillon projekte të rëndësishme në Kosovë dhe jashtë vendit.



Ajo tha se UBT i ka ndihmuar dhe i ka ofruar njohuri për veprimtarinë e saj profesionale, ku tashmë menaxhon gjitha fazat e projekteve nga fillimi e deri në përfundim.

"UBT na ka ofruar shumë mundësi, si në aspektin teorik gjithashtu edhe në aspektin praktik. Njëherësh edhe kemi pasur bashkëpunim në formë të punëtorive të organizuara, si dhe internshipeve në kuadër të fakultetit. Në UBT mësimi zhvillohet me sistemeve inovative e moderne.", theksoi ajo.

Erona përfundoi edhe studimet e nivelit bachelor në UBT, për çka tha se ka qenë zgjedhja më e mirë që ka bërë në jetë.

Studentët e UBT-së, përfitues të bursave të programit Erasmus+

Qindra studentë të UBT-së i kanë përfunduar ose janë duke i vazhduar studimet nëpër universitete prestigjioze evropiane falë partneritetit dhe bursave të studimit.

Njëri nga partnerët më të ngushtë të UBT-së është programi Erasmus+, përmes të cilit, çdo vit dhjetëra studentë të UBT-së vazhdojnë studimet për ndonjë semestër ose edhe studimet e plota nëpër universitetet e ëndrrave të tyre.

Universiteti Nova de Lisboa nga Portugalia, Universiteti Politeknik i Milanos, Universiteti Teknik i Vjenës, Universiteti i Graz-it, Universiteti i Salsburgut, etj., janë vetëm disa nga universitetet më të mira evropiane, të cilat janë bërë vend studimi për studentët dhe ish-studentët e UBT-së.

Tash e 17 vite, UBT është bërë partner i ngushtë i më shumë se 300 organizatave, universiteteve, institucioneve dhe programeve vendore e ndërkombëtare, që në fokus kanë ngritjen akademike të studentëve. Një i tillë ka qenë për programin Erasmus+, i cili tek UBT ka parë tërë potencialin, ndikimin dhe idetë inovative që zhvillohen e marrin jetë brenda institucionit dhe që shndërrohen në projekte në shërbim të komunitetit dhe Kosovës.

Vetëm gjatë tri viteve të fundit, UBT ka përfituar disa projekte në fusha të ndryshme, përfshirë edhe në atë shkencave sociale.

Njëri ndër projektet që është

implementuar dhe që ka marrë vlerësim jashtëzakonisht pozitiv për kontributin e dhënë në zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta, është projekti i PoSIG, që u krijon mundësi studentëve që të kenë mobilitet nëpër vende të ndryshme të BE-së dhe përpos kësaj, edhe të fitojnë diplomë të dyfishtë të studimeve.

Përpos partneritetit me programin Erasmus+, UBT bashkëpunon edhe me 300 organizata, universitete, institucione dhe programe vendore e ndërkombëtare, që në fokus kanë ngritjen akademike të studentëve, përfshirë këtu edhe programe të tjera që ofrojnë mundësi për mobilitetin e studentëve.

Ish-studenti Gramos Kamberi do të studiojë në SHBA si bursist i programit "Fulbright"

Ish-studenti i UBT-së në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Gramos Kamberi, pas përfundimit të studimeve dhe punësimit, i vendosi vetes një qëllim edhe më të lartë. Ai aplikoi për të qenë një ndër fituesit potencialë të bursës "Fulbright", që financohet nga qeveria amerikane dhe institucionet arsimore atje.

Falë procesit të suksesshëm të aplikimit, Gramosi i kaloi me sukses të plotë të gjitha fazat e aplikimit, me çka automatikisht e ka fituar të drejtën që së shpejti t'i fillojë studimet e nivelit master në SHBA.

"Aplikimi online përfshinë esetë për deklarata personale dhe atë të objektivave të studimit në SHBA, letrat referuese, CV-në dhe detaje tjera të nevojshme. Pasi që kam përfunduar aplikimin, pas disa javësh kam pranuar ftesën për intervistë nga komisioni i posaçëm për Fulbright në Ambasadën Amerikane, ku pastaj kam pranuar lajmin se jam pranuar si bursist", tregoi ai.

Gramosi vlerësoi se tek UBT ka gjetur gjithmonë mbështetje për të arritur objektivat e tij, prandaj thotë se gjatë studimeve themelore ka krijuar një bazë të fortë akademike dhe profesionale.

"Kurrikula shumë e pasur e SHKI-së dhe gatishmëria për të ofruar ndihmë për secilin student nga profesorët dhe asistentët, padyshim qe kanë qenë dhe është shumë frytdhënëse edhe sot. Gjithashtu, shumë e rëndësishme për t'u cekur është edhe fleksibiliteti që UBT ofron për të gjithë ata që janë në marrëdhënie pune. Personalisht sa kam qenë duke ndjekur vitin e dytë, unë paralelisht kam qenë duke punuar dhe studiuar", potencoi ai.

Gramosi ka vendosur që nga mundësitë e shumta për vijim të studimeve në SHBA, ka zgjedhur Polytechnic Institute – WPI, me degën e studimit Teknologji Informative, pasi pret që në këtë degë t'i gjejë të integruara lëndët më bashkëkohore të teknologjisë informative dhe asaj biznesore.

Studenti Benart Shala po realizon ekspozitën "Mapping of the Obscurity"

Studenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Benart Shala, pas sukseseve të jashtëzakonshme në arenën vendore e ndërkombëtare me projektin e tij, "Arkitektura përmes efektit të fluturës", tash është duke hapur ekspozitën/instilacionin "Mapping of the Obscurity", që sintetizon formën e artit të animacionit me atë tradicional.

Mesazhi i kësaj ngjarjeje është të bëhet një eksperiment se si mund të përpiqemi të përcaktojmë hapësira të panjohura arkitekturore, me shtimin e qasjeve të ndryshme. Pra, konkretisht kërkohet të zhvillohet një instalacion që ne e udhëheqim dhe formojmë një dimension të ri të vizitorit për të kuptuar/parë.

Ekspozita niset nga forma tradicionale e artit të profesorit Ferid Morina, deri në atë abstrakte, duke përfshirë edhe kuptimin arkitekturor dhe shkallen e njeriut.

Ekspozita do të hapet me 24 qershor, në Muzeun Kombëtar të Kosovës.

Rrëfime suksesi

Ish-studentja e Shkencave Politike, Ardita Metolli, tani asistente universiteti në Austri

Ardita Metolli ka qenë studente e Fakultetit Shkenca Politike në UBT. Ajo fitoi bursë nga programi Erasmus+ për të përfunduar studimet themelore në Universitetin e Salzbugut në Austri, më pas në kuadër të programit PoSiG ajo po vijon nivelin master në universitetin Innsbruck.

Së fundmi, falë profesionalizmit dhe shkathtësive të treguara, ajo është angazhuar edhe si asistente në lëndën Politikat Evropiane, në universitetin ku aktualisht po përfundon studimet e nivelit master.

Ardita theksoi se UBT ishte çelësi i suksesit në karrierën e saj, pasi siç tha ajo, institucioni i dha mundësi të shumta për realizimin e ëndrrave të saj.

"Regjistrimi në Fakultetin e Shkencave Politike në UBT ishte vetë suksesi, pasi që më dha mundësi të marrë njohuritë e para, më pas fitova bursë për të vazhduar studimet jashtë Kosovës", tregoi ajo.

Gjithashtu, Ardita është së bashku me një profesor të universiteti Innsbruck, është duke punuar për botimin e librit shkencor më titull: "Bashkimi Evropian dhe banka afrikane për zhvillim në Marok". Ky libër pritet të botohet në fund të vitit, teksa edhe studentët e UBT-së dhe ata kosovarë do të ketë mundësinë ta lexojnë dhe ta përdorin për punimet e tyre studimore.

Përmes UBT-së, studentja Djellza Prebreza punësohet në kompaninë "Jaha Solar"

Bashkëpunimi i ngushtë i UBT-së me kompanitë dhe ndërmarrjet vendore, po krijon mundësi të shumta për punësim të të rinjve kosovarë, të cilët ngritjen e tyre profesionale ia kanë besuar UBT-së.

Djellza Prebreza është studente e vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë, por kjo nuk e ka penguar atë që tashmë t'i bashkohet kompanisë së mirënjohur për prodhim të paneleve solare, "Jaha Solar".

Ajo tregoi se ideja për të realizuar praktikë, që tash i siguroi edhe punësim, erdhi pas një vizite të realizuar në këtë kompani në kuadër të lëndës "Internship".

"Kompania e mirëpriti kërkesën time dhe me pranoi në praktikë. Kurse, pas disa ditësh në praktikë, erdhi deri tek propozimi që të qëndroja në punë në pjesën e rregullimit të dimensioneve të paneleve", tregoi Djellza.

Për të, kjo punë ka një rëndësi të madhe, pasi lidhet drejtpërdrejt me profesionin për të cilin edhe është duke studiuar.

"I jam falënderuese përzemërsisht UBT-së për mundësitë e shumta për të kryer praktikë dhe për t'u punësuar", shtoi Djellza.

Studentët e UBT-së janë të rinjtë kosovarë më të kërkuar në tregun e punës, dhe si rezultat, 98 nga 100 studentë të UBT-së gjejnë vende pune në profesionet e tyre qysh në vitin e parë pas diplomimit, ose edhe gjatë studimeve.

Ish-studenti Blendi Lleshi, përfitues i bursës "Stipendium Hungaricum"



Pak vite më parë ndoqi studimet themelore në UBT, ndërkaq tani, Blendi Lleshi është përfitues i bursës "Stipendium Hungaricum", falë të cilës do të ndjekë studimet në Szent István University, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë Ndërtimore.

Ai do të fillojë studimet e nivelit master atje që nga shtatori i këtij viti, teksa tregoi procedurat nëpër të cilat ka kaluar për të qenë përfitues i kësaj burse.

"Ambasada e Hungarisë në Kosovë ka hapur këtë konkurs gjatë muajit nëntor të vitit të kaluar, bursat kanë qenë për nivelin bachelor, master dhe PhD, për vitin akademik 2019-2020. Fitues potencialë të këtyre bursave kemi qenë 50 studentë, njëri ndër ta edhe unë. Kanë qenë procedura të njëpasnjëshme, si fillim aplikimi online, me pas nominimi nga shteti ynë Kosova, si dhe sistemi i intervistave dhe testimeve, të cilat i kam përfunduar me shumë sukses, për çka edhe tash jam bursist", tregoi Blendi.

Ai e çmon periudhën e kaluar si student në UBT dhe thotë se ajo kohë ishte më e bukura e jetës së tij.

"Niveli arsimor ka qenë në një nivel tjetër, stafi akademik ka qenë i përkushtuar tej mase ndaj neve, gjë që ka rezultuar vetëm sukses tek ne, aq sa edhe mundësia për t'u qasur në tregun ka qenë e lehtë për ne si fillestarë. Prandaj, unë ua rekomandoj të gjithëve UBT-në", vlerësoi Blendi.

Blendi Lleshi është vetëm një nga qindra studentë të UBT-së, të cilët gjatë dhe pas përfundimit të studimeve në UBT, janë bërë pjesë e universiteteve më prestigjioze evropiane, duke qenë plotësisht të përgatitur për të vijuar studimet atje, si rezultat i përgatitjes profesionale të lartë që e marrin në UBT.

Studentët e UBT-së, triumfues në konkursin arkitektonik ndërkombëtar, "Rwanda Chapel"



Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor është shkolla ku po përgatiten arkitektët më të përgatitur profesionalisht, gjë që vërtetohet duke marrë për bazë, jo vetëm shkallën e lartë të punësimit të studentëve e ish-studentëve, por edhe suksesin dhe vlerësimin ndërkombëtar të veprave të tyre arkitektonike.

Suksesi i fundit është ai në konkursin arkitektonik ndërkombëtar, "Rwanda Chapel", ku studentë dhe ish-studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, të udhëhequr nga stafi i këtij fakulteti, kanë arritur të shpërblehen dhe të dallohen në mesin e qindra propozimeve profesionale.

Të udhëhequr nga ligjëruesi Kujtim Elezi, studentët e UBT-së, Besim Krosa dhe Qëndrim Vogliqi janë shpërblyer me çmimin "Gold Mention", kurse nën udhëheqjen e ligjëruesit Arbër Sadiki, studentët, Leart Miftari, Adonis Rexhepi dhe Blerim Bajraliu, janë shpërblyer me çmimin "Honorable Mention".

Konkursi është organizuar nga platforma "Young Architects Competitions", kurse juria vlerësuese është udhëhequr nga dy emra gjigantë të arkitekturës bashkëkohore, Eduardo Souto de Moura dhe Peter Eiserman, të dy të vlerësuar vite më parë me "Prizker Prize for Architecture", i njohur ndryshe si "Çmimi Nobel" për arkitekturë.

Rrëfime suksesi

Ish-studenti Hadis Krasniqi po vijon studimet në Poloni e Holandë

Hadis Krasniqi është vetëm 21 vjeç, por një i ri me shumë ëndrra dhe ambicie për të pasur një karrierë të suksesshme. Ai vendosi të regjistrohej në nivelin bachelor në Fakultetin Shkenca Politike në UBT, ku përgjatë një viti ai përfitoi njohuritë bazike për të qenë një lider i suksesshëm në politikë apo diplomaci.

Përmes UBT-së, Hadisi fitoi bursë për vazhdim të vitit të dytë të studimeve themelore në Universitetin e Varshavës. Në këtë institucion ai pati rastin të jetë pjesë e ligjëratave nga ekspertë dhe akademikë evropian të kësaj fushe. Ndërkaq, për të vazhduar vitin e tretë të studimeve universitare, Hadisi fitoi bursë tjetër në Universitetin e Mastrihtit në Holandë.

Aktualisht është në përfundim të studimeve, teksa ëndrra e tij është që në të ardhmen të udhëheqë vendin dhe të ndihmojë vendlindjen në rrugën drejt Evropës.

"Hapi i parë që mora për të nisur karrierën në politikë ishte ndjekja e studimeve në UBT, në Prishtinë, njëri ndër institucionet më të mira arsimore në Kosovë. Ishin studimet në UBT ato që më mundësuan një bursë transferimi fillimisht në Universitetin e Varshavës, më pas edhe në universitetin holandez", tregoi ai.

Hadisi tha se ka marrë pjesë edhe në aktivitete jashtë studimeve, si pjesëmarrja në programin e NATO-s, që kishte të bënte me zgjidhjen e konflikteve dhe krizave. Falë performancës që tregoi në këtë ngjarje, Hadisit i është propozuar bursë nga Defence College Foundation, në Romë.



Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim punësohet në Ministrinë e Administratës Publike

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Flaka Jashari është punësuar në Ministrinë e Administratës Publike, në cilësinë e zyrtares tek Zyra për Komunikimin me Publikun.

Aktualisht, ajo bën monitorimin e portaleve dhe gazetave të shkruara, në lidhje më shkrimet të cilat publikohen rreth ministrisë.

Flaka theksoi se Fakulteti i Medias dhe i Komunikimit ka staf shumë profesional, pajisje dhe laboratorë, që u mundëson studentëve ta zbatojnë në praktikë teorinë e mësuar, si dhe të kenë qasje më të lehtë në tregun e punës.

"Gjatë studimeve më është dhënë mundësia që praktikën ta përfundojë në Radio Televizionin e Kosovës për një muaj, ku kam përvetësuar njohuri të shumta", theksoi ajo.

Tutje Flaka shtoi se UBT vazhdon të mbetet institucioni arsimor me vlerat më të larta në vendin tonë.

"Gjatë tri viteve gjersa isha pjesë e këtij institucioni, kam arritur të përfitoj bazën themelore për shkrimet gazetareske, si dhe teknikat e punës në përgjithësi, të cilat sot i ushtroj në profesionin tim", shtoi Flaka.

Sikurse studentët e programeve tjera të studimit, ashtu edhe të Fakultetin e Medias dhe Komunikimit, UBT vazhdon të sistemojë në treg profesionistë, që janë entuziastë dhe të suksesshëm për punën që e bëjnë.

Ish-studenti Gezim Xhabiri i punësuar në kompaninë "Exclusice Group"

Gëzim Xhabiri ka qenë student i UBT-së, i cili përfundoi studimet në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, konkretisht specializoi për Rrjeta dhe Telekomunikacion.

Ai është punësuar në kompaninë "Exclusice Group", një kompani që numëron mbi 600 punëtorë, ku mbanë pozitën system/network administraror.

Gezimi mbikëqyr dhe mirëmban sistemin e gjithë kompanisë, për çka tha se njohuritë teorike dhe praktike i ka marrë gjatë studimeve në UBT.

"UBT më ka ofruar mundësi të shumta, ndërkaq unë kam çmuar shumë këtë institucion ngaqë ka poseduar laboratorët me gjitha pajisjet përcjellëse dhe na ka ofruar gjithçka që më është dashur për profesionin që kam zgjedhur. Gjithashtu, institucioni më ka me ka ndihmuar të fitoj njohuri dhe përvojë për



të zgjidhur problemin dhe për të implementuar sistemin", tha ai.

UBT ka qendrën më të madhe të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Ballkanin Perëndimor. Krahas studimeve në këtë program, studentët do të certifikohen nga CISCO, Microsoft, CompTIA, ICDL, IPMA dhe Pearson VUE.

Ish-studentja Elira Pelaj po vazhdon studimet në Universitetin e Lihtenshtajnit

Elira Pelaj është një ndër shumë studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, që ka përfituar nga studimet në UBT. Pas studimeve të nivelit bachelor në UBT, ajo është pranuar për të vazhduar studimet e nivelit master në Universitetin e Lihtenshtajnit.

Elira ka treguar se ndjehet e privilegjuar që po i përmbushë objektivat akademike me vijimin e studimeve në këtë universitet, por që hapat e parë të formimit të saj prej arkitekteje i mori nga UBT.

"Jam e privilegjuar dhe dua të ju informoj që kisha fatin të marrë përgjigje pozitive për leje-qëndrim, e në të njëjtën kohë edhe jam pranuar në Universitetin e Lihtenshtajnit për vazhdimin e studimeve master në Arkitekturë", ka thënë ajo.

UBT është i vetmi institucion që ka partneritet me qindra universitete të njohura ndërkombëtarisht, mundësi të cilën po e shfrytëzojnë qindra të rinj kosovarë për të studiuar jashtë vendit.

Studenti Rijad Bivolaku, tash i punësuar në UBT

Studenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, Rijad Bivolaku është bërë pjesë e stafit të UBT-së, ku është angazhuar në cilësinë e Frontend Developer-it.

Ai thotë se është tejet i lumtur që ëndrra e tij e kamotshme që t'i bashkohet stafit të UBT-së është realizuar.

"Me punësimin tim në UBT jam duke e arritur fillimin, por edhe kulminacionin e rrugëtimit tim në shkenca kompjuterike, sepse përmes kësaj mundësie po thellohem edhe më shumë në dijen e shekullit XXI", vlerësoi Rijadi.

Sipas tij, përzgjedhja në mesin e qindra studentëve të tjerë nuk është e rastësishme, pasi ka punuar me veten tash e shumë vite.

"Është shumë për t'u lavdëruar fakti i dhënies së hapësirës ndaj rinisë në këtë institucion. Ata panë aftësinë dhe dëshirën time të madhe ndaj programimit dhe dizajnimit, prandaj edhe vendosën të ma besonin një përgjegjësi të tillë", shtoi Rijadi.

UBT ka shkollën më të madhe për shkenca kompjuterike në rajon, jo vetëm për nga numri i studentëve, por edhe për nga niveli i lartë i punësimit të tyre nëpër kompani të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Rrëfime suksesi

Punimi shkencor i profesorit Ridvan Peshkopia dhe studentëve të Shkencave Politike është publikuar në revistën shkencore, "European Societies"

Suksesi i studentëve të UBT-së nuk ka të ndalur, aq më tepër kur gjatë tërë procesit janë të mentoruar dhe zhvillojnë projekte bashkë me profesorët.

Një rast i tillë suksesi është ai i profesorit në Fakultetin Shkenca Politike, Ridvan Peshkopia, i cili bashkërisht me studentët e këtij fakulteti, ka arritur që punimin e tyre të përbashkët shkencor ta publikojnë në revistën shkencore të indeksuar, "The International Journal of Human Rights".

Ky rezultat i arritur është tregues më i qartë i mësimdhënies së orientuar nga kërkimi shkencor, që është parim bazë i studimit në UBT.

Publikimi shkencor titullohet: "An ally to the people: EU membership conditionality and Albanians' attitudes toward EU membership".

Këtë hulumtim mund ta lexoni duke klikuar këtu: https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/14616696.2019.1660393

Ish-studentja e UBT-së, Diellëza Xhokli punësohet në kompaninë "Beo Software"

Ish-studentja e Fakultetit Shkencat kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Diellëza Xhokli është punësuar kompaninë "Beo Software", me seli në Gjermani, si dhe mbanë pozitën Software Testing.

Diellëza tha se njohuritë e fituara përgjatë studimeve në UBT, i mundësuan asaj të jetë pjesë e kësaj kompanie prestigjioze.

"UBT ka qenë çelësi kryesor në ngritjen time profesionale, pasi që falë UBT-së kam pasur privilegjin që të punësohem në këtë kompani e cila ofron kushte serioze të punës. UBT njihet si një institucion i cili ofron mundësi të shumta për secilin student, marrë parasysh që pas studimeve studentët marrin njohuritë e duhura dhe kyçen lehtësisht në tregun e punës. Kjo e bën UBT-në shumë të veçantë prej institucioneve tjera arsimore", tha ajo.

Ajo tregoi vendosmërinë për të vazhduar studimet master në po të njëjtin drejtim në UBT, teksa rekomandoi gjithë të rinjve të vendit që studimet ti vazhdojnë në institucionin e mundësive, në UBT.

Studenti Edin Pula mori pjesë në simulimin e mbledhjes së Bashkimit Evropian



Në cilësinë e deputetit të Finlandës, studenti i Shkencave Politike, Edin Pula ka marrë pjesë në mbledhjen disaditore të simuluar të Parlamentit Evropian, që është organizuar nga shoqata "BetaPolska" me seli në Varshavë, organizatë e cila është partnere me shumë institucione të BE-së.

Studenti i UBT-së, së bashku me shumë entuziastë, studentë dhe profesionistë të rinj evropianë, patën rastin të njihen me procedurat e organizimit të mbledhjeve të BE-së, njëherësh ishin edhe pjesë e procesit vendimmarrës dhe legjislativ.

Edini është shprehur i kënaqur me pjesëmarrjen e tij në këtë ngjarje, ndërkaq theksoi se ishin ditë të paharrueshme, ku përvojat e marra do t'i shërbejnë në karrierën e tij profesionale.

Studentja Samire Curri, pjesë e Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit

Samire Curri është studente e UBT-së në Fakultetin e Infermierisë, por tashmë është asambliste në Kuvendin Komunal të Komunës së Hanit të Elezit, teksa njëkohësisht është edhe pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa në këtë qytet.

Përvojën e marrë nga fakulteti, ajo po e shfrytëzon për të adresuar çështje dhe probleme që kanë të bëjnë me shëndetësinë në komunën ku vepron. "Ndjehem e privilegjuar që jam pjesë e UBT-së sepse ka një staf akademik profesional, që vazhdimisht japin maksimumin e tyre në procesin akademik.

Studimet në UBT po më ndihmojnë në punën e përditshme dhe e vlerësoj shumë faktin që jam në mesin e një institucioni që

studentëve u krijon mundësi të shumta, përfshirë edhe vazhdimin e studimeve në universitete partnere në të gjithë botën", tha ajo.

Samirja tregoi që përmes UBT-së dëshiron t'i vazhdojë studimet master jashtë vendit në një nga universitetet me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, e më pas synon që të kthehet në vendlindje për t'i sjellë përvojat më të mira ndërkombëtare.

Studenti i Sistemeve të Informacionit, Blend Krasniqi krijon kompaninë "Core Tech"

Në cilësinë e deputetit të Finlandës, studenti i Shkencave Politike, Edin Pula ka marrë pjesë në mbledhjen disaditore të simuluar të Parlamentit Evropian, që është organizuar nga shoqata "BetaPolska" me seli në Varshavë, organizatë e cila është partnere me shumë institucione të BE-së.

Studenti i UBT-së, së bashku me shumë entuziastë, studentë dhe profesionistë të rinj evropianë, patën rastin të njihen me procedurat e organizimit të mbledhjeve të BE-së, njëherësh ishin edhe pjesë e procesit vendimmarrës dhe legjislativ.

Edini është shprehur i kënaqur me pjesëmarrjen e tij në këtë ngjarje, ndërkaq theksoi se ishin ditë të paharrueshme, ku përvojat e marra do t'i shërbejnë në karrierën e tij profesionale.

Ish-studenti Shpëtim Smolica, i punësuar në kompaninë Mayune

Ish-studenti i UBT-së, Shpëtim Smolica, ka përfunduar studimet e nivelit bachelor në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, dhe aktualisht është punësuar si Lead Website Developer në kompaninë Mayune.

Ai udhëheq ekipin që merret me ndërtimin e webfaqeve, të cilat zhvillohen me kode dhe përmes WordPress-it.

"UBT më ka hapur shumë dyer falë aftësive të fituara nga studimet në "botën reale". Studimet në UBT janë të veçanta për arsye se ka shumë mënyra për të ushtruar mësimet teorike që bëhen nëpër klasa, laboratorë, gjë që nuk e kanë institucionet e tjera", tha Smolica.

Ai tregoi se kompania në të cilin punon u ndihmon bizneseve në

përmirësimin e pozicionimit të tyre online, duke ju dhënë zgjidhje falë ekipit të specializuar në këtë drejtim.

FAKULTETI
SHKENCAT E USHQIMIT
Anil Krasniqi:
“E zgjodha UBT-në për shkak se është institucioni i vetëm në vend që ofron studime në fushën e nutricionit”.

FAKULTETI
MEDIA DHE KOMUNIKIM
Aurora Selimi:
“Brenda nesh kemi ëndërr, pasion, qellim për të arritur atë që duam ta interpretojmë në publik dhe un zgjodha UBT-në si institucionin më të mirë për rrugëtimin tim profesional”.

FAKULTETI I
SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
Erza Baftiu:
“Mos humbi kohë duke menduar për gabimet apo dështimet, UBT do t’ua ofrojë mundësinë që t’i rregulloni."

FAKULTETI
ARKITEKTURË DHE
PLANIFIKIM HAPËSINOR
Eli Selmani :
“UBT kërkon punë dhe studim të vazhdueshëm, i cili mund të jetë sfidues, motivues, por edhe i lodhshëm. Mirëpo, në fund ajo na sjell më afër botës reale, në të cilën më vonë do të punojmë dhe do t’i implementojmë planet tona me punën ekipore, bashkëpunimin dhe pasionin i cili do të mbetet i ngulitur në kujtimet e përditshme”.

FAKULTETI
ARKITEKTURË DHE
PLANIFIKIM HAPËSINOR
Tringa Bërbatovci:
“Architecture is the art we live in and the perfection of this art accessed at UBT.”

FAKULTETI I
SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
Learta Gjoni:
“Nuk ka rëndësi se çfarë po bëjnë të tjerët. E rëndësishme është se çfarë po bëni. Kjo është arsyeja pse zgjodha UBT”.

FAKULTETI
SHKENCA POLITIKE
Valentina Dushullovci:
“Dëshira për një politikë të modernuar evropiane më orientoi drejt UBT-së”.

FAKULTETI
INXHINIERI E ENERGJISË
Visar Bejta:
“UBT më dha mundësi të studioj në mënyrën

FAKULTETI
ARKITEKTURËS DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
Anita Ymeri:
“Arkitektura nuk bazohet në beton, çelik dhe elementet e tokës.
Është e bazuar në kërshëri”.

FAKULTETI
MEDIA DHE KOMUNIKIM
Marigona Xhakli:
“Nuk vjen këtu për të qenë mesatar, por për të qenë i shkëlqyeshëm”.

FAKULTETI
SHKENCAT E USHQIMIT
Blerton Martinaj:
“Unë zgjodha UBT-në për një të ardhme të ndritur”.

FAKULTETI I FARMACISE
Vlera Lipa:
“Një farmacist i jep jetë ilaçeve nëpërmjet njohurive dhe aftësive
të tij”.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
DHE INXHINIERI
Leonita Berkolli:
“Mënyra e vetme për të bërë gjëra të mrekullueshme është ta
doni atë që bëni”.

FAKULTETI
SHKENCAT E USHQIMIT
Shpat Ejupi:
“Nëse do ta ndryshosh vendin tënd, eja përgatitu në UBT”.

më profesionale”.

MENAXHMENT, BIZNES
DHE EKONOMI
Vlera Shabani:
“Profesorët e përgatitur dhe kujdesi ndaj studentëve në UBT, kanë ndikuar në zhvillimin tim
profesional përgjatë këtyre viteve”.

Rrëfime suksesi

Studenti Rilind Sadiku, me projekt për bibliotekën në Kodrën e Trimave

Studenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Rilind Sadiku, me kërkesë të Komunës së Prishtinës, ka zhvilluar një projekt të mrekullueshëm për bibliotekën e lagjes Kodrave e Trimave, e cila do të shërbente për nevojat e nxënësve të shkollës "Hilmi Rakovica", në Prishtinë, por dhe si qendër e mbledhjes dhe zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme sipas nevojës.

Për Ndërtimi.info, Rilindi tregoi se ky projekt lindi si rezultat i bashkëpunimit mes UBT-së dhe Komunës së Prishtinës.

"Komuna e Prishtinës dhe UBT kanë bashkëpunim për zhvillim të projekteve për zgjedhjen e problemeve të ndryshme nga studentët, të cilët janë duke ndjekur studio të ndryshme, që tani janë të specifikuara në bazë të kërkesave të komunës ndaj UBT-së, dhe respektivisht studentëve të cilët duan në baza vullnetare të kontribuojnë në zhvillimin e ideve dhe projekteve për zgjedhjen e këtyre problemeve. Fillimisht projekti prezantohet para profesorëve në UBT pastaj edhe para zyrtarëve të komunës, të cilët vlerësojnë mundësinë e realizimit të projektit ideor. Andaj, edhe ky projekt është në vazhdën e këtij bashkëpunimi", tregon ai.

Artikullin e zgjeruar mund ta lexoni në: https://ndertimi.info/rilind-sadiku-studenti-me-projektin-fantastik-per-biblioteken-ne-kodren-e-trimave/

Ish-studentja Kata Abazi punësohet në UBT

UBT është institucion që nxjerr kuadro profesionale dhe ekspertë të fushave të ndryshme, institucion nga i cili studentët përfitojnë mundësi të shumta e të pakrahasueshme.

Kata Abazi ka qenë studente e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, e cila tashmë është bërë pjesë e stafit në institucionin ku mori dije përgjatë disa viteve.

Ajo është angazhuar në cilësinë e koordinatores së Fakultetit Arti dhe Mediat Digjitale, për çka tha se ndjehet e lumtur që po jep kontributin e saj në UBT.

"UBT pa dyshim së më ka ofruar mundësi të shumta. Si institucion fillimisht më ka ofruar punë praktikë e më pas edhe punësim. Unë jam punësuar në kohën kur vendi aktualisht po përballet më papunësi të lartë të të rinjve, mirëpo me këtë problem nuk përballen shumica e studentëve që përfundojnë studimet në UBT", theksoi ajo.

Ish-studentja Abazi tha se UBT dallon nga universitetet tjera, për nga fakti se është institucion i vlerësuar me pesë yje të ekselencës, është lider për cilësi, mësimdhënie dhe në mësimnxënie.

I përfundoi studimet master në UBT, tash po kontribuon në përgatitjen e gjeneratave të reja

Ish-studentja e UBT-së, Nerxhivane Përvetica, i përfundoi studimet e nivelit master në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, ndërkaq aktualisht është duke punuar në SHME "Gjin Gazulli, në Prishtinë, si dhe si eksperte në projekte vendore dhe rajonale për arsim profesional.

Në veçanti, ajo e përmendi përvojën nga tema e diplomës, të cilën e përfundoi nën mentorimin e ligjëruesit në UBT, dr. Zhilbert Tafa.

"Ky punim është prezantuar në konferencën ndërkombëtare, "MECO 2015", në Mal të Zi, dhe pastaj është indeksuar në databazaën me prestigjioze nga fusha e shkencave kompjuterike, "IEEE dhe Scopus", tregoi Nerxhianja

Ajo tha se njohuritë që i ka marrë në UBT, sa i përket përgatitjeve dhe hulumtimeve, e kanë motivuar që të merret edhe më tej me punime shkencore.

Studentja Aurela Avdylaj punësohet si arkitekte në kompaninë "Fortesa Home"



Studentja e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në nivelin master, Aurela Avdylaj është punësuar në kompaninë "Fortesa Home".

Deri tek ky vend i punës ka ardhur falë Qendrës së Karrierës së UBT-së, me ç'rast, me marrjen e njoftimit prej kësaj qendre, kishte aplikuar dhe ishte përzgjedhur në mesin e më shumë se 80 arkitektëve që kishin aplikuar nga mbarë Kosova.

Ajo tregoi se të punonte në një kompani kaq prestigjioze dhe me përvojë 20-vjeçare, ishte ëndrra e saj e kamotshme.

"Ishte me të vërtetë kënaqësi, mirëpo nuk e kam besuar që është edhe më mirë se në shtëpi, ashtu siç edhe e ka emrin. Tani po vazhdoj punën me kontratë të përhershme, dhe jam shumë e kënaqur me gjithë procesin e punës", theksoi Aurela.

UBT ka shkallën më të lartë të punësimit të studentëve dhe të diplomuarve. Shkalla e punësimit të studentëve tanë pas diplomimit është 98 për qind, gjë që dëshmon për nivelin e lartë të përgatitjes dhe të kompetencave, të cilat i fitojnë studentët tanë gjatë viteve të studimit në UBT.

Studentët e UBT-së, pjesëmarrës në punëtorinë e arkitekturës në Turqi

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor kanë marrë pjesë në punëtorinë njëjavore në Fakultetin e Arkitekturës në Trakya University, në Edirne të Turqisë, ku pjesëmarrës ishin edhe dhjetëra studentë nga shtete të tjera.

Studentët e UBT-së që e përfaqësuan vendin tonë në këtë punëtori ishin: Art Luri, Ditnis Kollqaku, Blerina Muriqi, Sami Podvorica, Kushtrim Lushtaku, Drilona Berisha, Marigona Gashi, Valëza Tahiri dhe Dhurata Aziz.

Punëtoria vjetore mbi trashëgimin kulturore "Edirne outdoor amphitheatre educates the achitects of the future: cultural heritage workshop", synim kryesor e kishte hedhjen dritë dhe edukimin e arkitektëve ët rinj në lidhje me problemet ekzistuese që kanë të bëjnë me riinterpretimin e strukturave monumentale në lidhje me ambientin dhe lidhjen e tyre me qytetin.

Për këtë qëllim, si raste studimi u morën gjashtë lokacione në Turqi.

Punëtoria u mbyll me një ekspozitë dhe ceremoni pjesëmarrjeje, që u mbajt në Trakya University.

Rrëfime suksesi

Studentet e UBT-së marrin të gjitha çmimet në garën e Konventës së Veshmbathjeve

Edicioni i tretë i Konventës së Veshmbathjeve, që u organizua nga Kosovo Apparel Marketing Association (KAMA), bashkoi në një vend shumë figura dhe kompani eminente kosovare të modës dhe tekstilit, që paraqitën krijimtarinë e tyre para pjesëmarrësve.
E veçoria e këtij organizimi ishte Gara e Konventës së Veshmbathjeve, ku studentë nga institucione të ndryshme arsimore u paraqitën me krijimet e tyre, të cilët edhe u vlerësuan nga një juri profesionale për punën e bërë.
Nga të gjithë studentët pjesëmarrës, të tri vendet e para u fituan nga studentet e Dizajnit të Integruar, në UBT.

Vendin e parë e mori studentja e vitit të tretë, Rita Hasani, vendin i dytë i takoi studentes Diellza Bullaku dhe vendin e tretë e mori studentja Gresa Boshtraj, ndërkaq finalist i kësaj gare ishte edhe studenti Endrit Bllaca.
Konventa e Industrisë së Veshmbathjeve të Kosovës organizohet çdo vit për të mbështetur zhvillimin dhe rritjen e kësaj industrie në Kosovë.
Në kuadër të Konventës u mbajtën disa forume me prezantime dhe diskutime mbi temat kyçe në industrinë e veshmbathjeve, si edhe ekspozita me punimet e studentëve.

Ish-studenti Mahmut Ajvazi, pronar i ndërmarrjes projektuese dhe ndërtimore, "Kulina Ing"

Ish-studenti i UBT-së në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Mahmut Ajvazi, pati një rrugëtim tejet të suksesshëm profesional, të cilin e ka përmbushur edhe më tej së fundmi, me hapjen e ndërmarrjen projektuese dhe ndërtimore, "Kulina Ing", ku merret me projektim dhe menaxhim të projekteve gjatë realizimit.
Ai theksoi se pasioni për arkitekturë të shtynë gjithmonë drejt

rezultateve, por sipas tij, çdo gjë tjetër ka të bëjë me përpjekjen .
"Studimet në UBT të mundësojnë që të përfitosh shumë sepse vetë programet studimore, e posaçërisht profesorët, janë të përgatitur shumë për dhënien e dijes tek studentët.
Unë dua të ceki afërsinë e profesorëve me studentët, të cilët gjithmonë janë të gatshëm për konsulta edhe jashtë orareve, e unë personalisht kam përfituar shumë nga kjo", tha Mahmuti.
Nga vitet e studimit ai kujton prezantimin e projekteve individuale dhe grupore, si dhe temën e nivelit Bachelor, ku pas punës intensive me prof. dr. Binak Beqaj, kishte arritur që t'i përfundonte studimet i pari.
Mahmuti synon që shumë shpejt ta vijojë edhe ngritjen e mëtutjeshme akademike, përmes fillimit të studimeve të doktoraturës.

Ish-studenti i UBT-së, Flakron Jahaj, themelues dhe pronar i kompanisë "Pika Group"

Ish-studenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Flakron Jahaj, menjëherë pas studimeve ka krijuar kompaninë e tij "Pika Group", me ç'rast ka krijuar edhe dhjetëra vende të reja të punës.
Flakroni gjatë studimeve në UBT ishte edhe kryetar i Këshillit të Studentëve, teksa tashmë e udhëheqë kompaninë e tij me rreth 180 punëtorë.
Kompania e tij kryen shërbime të energjisë elektrike, ndërkaq veprimtarinë e ka zgjeruar me ofrimin e materialeve higjienike dhe shërbimeve higjienike me pajisje moderne.
"Gjatë studimeve në UBT, sigurisht kam marrë dije dhe jam bërë më profesional në programin që studiova, njëherësh si institucion, UBT më ka ofruar mundësi të mëdha në fillim të hapave të kompanisë time sepse ka staf profesional dhe të përkushtuar në punë", tha ai.

Ai tha se hapat e parë i mori në UBT dhe e ndërtoi karrierën e tij, ndërkaq theksoi se sugjeron që të rinjtë të bëjnë zgjedhjen e duhur për studime cilësore.
"UBT është një ndër institucionet më të mira të arsimit të lartë në Kosovë. Studimet në UBT janë shumë të avancuara dhe ju kisha sugjeruar gjithë të rinjve në Kosovë, pasi që ka shumë përparësi dhe perspektivë. Është institucion i akredituar dhe ofron programe me teknologjitë më të reja dhe të fundit. Këshilla e vetme të cilën ju kisha thënë studentëve të rinj do të ishte që të vrapojnë pas ëndrrave të tyre pa marrë parasysh se a është e realizueshme ajo apo jo, sepse kur e bëni një punë me vullnet dhe me dashuri rezultati do të jetë pozitiv gjithmonë", potencoi ai.
Flakroni tregoi se e realizoi ëndrrën e tij, pasi kompania "Pika Group" po funksionon mirë dhe ka shtirje në tërë Kosovën.

Ish-studentja Labërie Dakaj, inspektore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Labëri Dakaj i përfundoi studimet bachelor e master në UBT, ndërkaq sot ajo është e punësuar si inspektore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore.
Ajo tregoi që vitet e studimeve në UBT ishin plot dinamikë, që i mundësuan asaj qysh herët të përcaktohej për fushëveprimtarinë.
"Unë kam studiuar në nivelin bachelor dhe master në UBT dhe e vetmja arsye ishte cilësia e lartë e profesorëve. E mira tjetër ishin profesorët e jashtëm, të cilët kanë ligjëruar duke na ambientuar me trendët botërorë në arkitekturë. Duke studiuar në UBT t'i ndihesh student i lirë me të gjitha të drejtat që të takojnë, duke mos ndjerë presion dhe shkelje nga ana e profesorëve", u shpreh Labëria.
Ajo tregoi se gjërat e mësuara nga profesorët, e përcjellin edhe sot kur është bërë profesioniste.
"Duke u nisur nga studimet në UBT, konkretisht nga lënda e Trashëgimisë, të cilën na e kanë ligjëruar profesorë të jashtëm, kam kuptuar se çdo gjë e çmuar e vendit duhet të ruhet dhe të vlerësohet", konstatoi Labëria.
Ajo tha se jashtë vazhdimit të punës ku është aktualisht, shpreson që në të ardhmen t'i bashkohet përsëri UBT-së, por kësaj here si staf akademik.

Ish-studentja Poliksena Berisha, auditore e TI-së në Zyrën Kombëtare të Auditimit

Ish-studentja e UBT-së në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Poliksena Berisha, i ka përfunduar studimet bachelor e master në UBT, ndërkaq tani është e punësuar si auditore e TI-s në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.
Ajo tha që studimet në UBT e kanë përgatitur dhe ndihmuar që të jetë konkurrente e fuqishme në tregun e punës.
"UBT është institucioni më i mirë për shkenca kompjuterike, pasi që nuk është thjesht një diplomë, por është një përvojë, studim dhe përgatitje e lartë profesionale dhe shkencore", vlerësoi Poliksena.
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT është shkolla më e madhe për shkenca kompjuterike në Kosovë dhe rajon, jo vetëm për nga numri i studentëve të regjistruar e të diplomuar, por edhe për nga shkalla e lartë e punësimit të atyre që diplomohen.

Rrëfime suksesi

Ish-studentja Kaltrina Mehmeti: UBT ishte zgjedhja ime e parë për studime

Ish-studentja e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e cila të dy nivelet e studimit i përfundoi në UBT, Kaltrina Mehmeti, është modeli më i mirë i nivelit të lartë të përgatitjes dhe suksesit të studentëve të UBT-së.
Ajo tash e një kohë është punësuar në kompaninë "Inter Group sh.p.k", në cilësinë e menaxheres së shitjes, ku ka të gjitha përgjegjësitë sa i përket efikasitetit të tërë procesit të punës në fushën e programit të shitjes, menaxhon stafin dhe përcakton planin e shitjes.
Ajo tha se i gjithë suksesi ka ardhur si rezultat i mësimit të programuar çdo ditë dhe hulumtimit të literaturës universitare dhe jashtë saj.
"Periudha e studimeve ka qenë e mbushur me aktivitete, ku përveç programit të studimeve kam punuar edhe në projekte të ndryshme me ç'rast në disa prej tyre, së bashku me grupin punues kemi marrë edhe shpërblime, e njëri ndër ta është vendi i dytë për biznes-planin më të mirë, ku kemi prezantuar punimin "PRO-BIKE", i cili më pas është prezantuar edhe tek organet komunale që kanë marrë përsipër edhe realizimin e tij. Projekt tjetër i cili ka gjetur zbatim është 3edhe "Klasifikimi i mbeturinave në shkolla", pastaj ndërtimi i një qendre sporti, etj", tregoi Kaltrina.
Ajo tha se e kishte përzgjedhur UBT-në pa asnjë dyshim, pasi që prej fillimit i kishte bindjen që në UBT do të gjente programin e duhur të studimeve dhe vendin që do t'i vlerësonte aftësitë e saj.

Studentët e UBT-së Rigon Statovci dhe Çlirim Bajçinca, themelues të kompanisë kreative " Zebra Agency"

Studenti i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Rigon Statovci dhe studenti në Fakultetin e Dizajnit të Integruar, Çlirim Bajçinca, kanë themeluar agjencinë kreative "Zebra Agency".
Zebra Agency, kreativitetin e të cilës po e kërkojnë edhe jashtë kufijve, po shërben në fushën e dizajnit strategjik dhe në krijimin e identitetit të markave.
Zebra Agency merret me zhvillimin e uebsite-eve, video animacioneve 2D, 3D Motion Graphics, shërbimet e brendimit, për qëllim të avancimit të arritjeve në fushën e biznesit për klientë.
Rigoni dhe Çlirimi deri më tani kanë arritur të fitojnë shumë projekte, ku ata tani po i mbështesin edhe studentët tjerë të UBT-së, duke i bërë pjesë e

stafit.
"Duke ditur që UBT dallon nga institucionet tjera arsimore, gjithmonë kemi pasur përkrahje nga stafi akademik, të cilët na kanë përgatitur në mënyrën më profesionale si në fushën e IT-së, gjithashtu edhe në pjesën e biznesit", theksoi Rigoni.
Ai tha se UBT ka qenë gjithmonë në gatishmëri për të na ofruar mbështetjen profesionale dhe të na aftësojë në pjesët kyçe të karrierës.

Ish-studenti i UBT-së, i punësuar në kompaninë "Bottomline Technologies"

Ish-studentja e UBT-së në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Poliksena Berisha, i ka përfunduar studimet bachelor e master në UBT, ndërkaq tani është e punësuar si auditore e TI-s në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Ajo tha që studimet në UBT e kanë përgatitur dhe ndihmuar që të jetë konkurrente e fuqishme në tregun e punës.
"UBT është institucioni më i mirë për shkenca kompjuterike, pasi që nuk është thjesht një diplomë, por është një përvojë, studim dhe përgatitje e lartë profesionale dhe shkencore", vlerësoi Poliksena.
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT është shkolla më e madhe për shkenca kompjuterike në Kosovë dhe rajon, jo vetëm për nga numri i studentëve të regjistruar e të diplomuar, por edhe për nga shkalla e lartë e punësimit të atyre që diplomohen.

Studenti Art Loxha punësohet në portalin Telegrafi

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin Media dhe Komunikim, Art Loxha, ka nisur punën në cilësinë e koordinatorit të mediave sociale në portalin Telegrafi.
Duke folur për përvojën rreth studimeve, Arti theksoi se me të hyrë në Fakultetin Media dhe Komunikim, e ka gjetur veten në këtë lëmi, falë stafit dhe profesorëve të UBT-së, të cilët i kanë dhënë informata të frytshme, mundësi të shumta praktike, si dhe motiv për të ardhmen.
"Pa njohuritë akademike dhe profesionale që i kam fituar gjatë studimeve në UBT, do të ishte shumë vështirë zhvillimi im në tregun e punës", tha ai.
Tutje, Arti u propozoi të rinjve që synojnë një të ardhme të suksesshme të zgjedhin UBT-në.
"Përgatitja profesionale e stafit të UBT-së të ofron mundësi të shumta drejt tregut të punës ende pa i përfunduar studimet", shtoi ai.
Qëllimi i programit Media dhe Komunikim është që t'u ofrojë studentëve dije teorike dhe praktike, në mënyrë që kuadrot e dala nga ky institucion të kryejnë me sukses punët në organizatat ku do të punojnë, kështu duke performuar suksesshëm në të gjitha fushat e komunikimit.

Studenti i UBT-së, Blin Zeka përfitues i bursës semestrale në Universitetin Teknik, në Bullgari

Blin Zeka është student në Fakultetin e Mekatronikës në UBT, i cili ka fituar bursë semestrale në Universitetin Teknik, me seli në Sofia të Bullgarisë.
Ai është përzgjedhur përfitues i bursës në bazë të notës mesatare dhe njohurive të treguara, ndërkaq në këtë universitet do të qëndrojë gjashtë muaj, ndërkaq do të niset në muajin shkurt të vitit 2020.
"Rezultatet e deritanishme i kam arritur falë përkushtimit të profesorëve, angazhimit tim maksimal gjatë studimeve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm që e kam pasur me kolegët tjerë ndër vite. Përmes UBT-së, kam fituar edhe bursë semestrale në Universitetin Teknik me seli në Sofia, përkatësisht në shtetin e Bullgarisë", tha ai.
Blini tha se UBT i mundësoi të jetësonte ëndrrat e tij, si në aspektin akademik edhe në atë profesional.
"Niveli arsimor është tejet cilësor, ka staf të shkëlqyeshëm, na ofron mundësi të shumta në treg të punës, ofron eksperienca superiore andaj unë ua rekomandoj të gjithë studentëve tjerë nëse veç kanë vizion që të rezultojnë me suksese të shumta", theksoi Blini.
Blin Zeka është një nga 12 studentë të cilët këtë muaj përfituan bursë semestrale në universitete të ndryshme të Evropës.

Studentja Laureta Zejnullahu, arkitekte enterieri në kompaninë "Palma"

Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, Laureta Zejnullahu është punësuar ende pa i përfunduar studimet themelore, dhe atë si arkitekte enterieri në kompaninë e njohur vendore, "Palma".
Megjithatë, ky nuk është suksesi i vetëm i Lauretës, pasi këtë vit, ajo është shpallur njëra nga fitueset në Garën e Përpunimit të Drurit.
Ajo tha se arritja e suksesit në profesionin e saj nuk ka qenë aspak i vështirë, duke ju falënderuar përkushtimit dhe punës së saj gjatë studimeve, si edhe përkrahjes nga profesorët e saj.
"Nuk ka qenë mision i pamundur të arrihet sukses i lartë gjate studimeve në UBT, për faktin që sistemi është korrekt dhe njohuritë arrijnë të transmetohen falë



profesorëve dhe bashkëpunimit të tyre me studentë", theksoi Laureta.
Ajo shtoi se UBT ka qenë opsioni më i mirë për të nisur ngritjen akademike, pasi, sipas saj, është institucion lider në këtë fushë.
"UBT-në e kam zgjedhur si opsionin më të mirë për vazhdimin e studimeve në degën e Arkitekturës, pasi është institucion lider në këtë departament, ka profesorë të shkëlqyer dhe mundësi perfekte për përfitimin e njohurive në fushat përkatëse, të cilat neve si studentë na e mundësojnë të krahasohemi me studentë të nivelit botëror", potencoi studentja në fjalë.
E për të provuar ndjenjën e të studiuarit jashtë vendit, Laureta synon që studimet e nivelit master t'i fillojë shumë shpejt në një nga universitetet evropiane.

Rrëfime suksesi

Studenti Pëllumb Halili, inxhinier në Kazakistan



Studentët e UBT-së po e prekin botën me profesionalizmin e tyre, e një ndër ta është studenti i nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, Pëllumb Halili, i cili është punësuar si inxhinier i ndërtimit në kompaninë "Mabetex Group", me seli në Astana të Kazakistanit.

Në këtë kompani, Pëllumbi po i shfrytëzon njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT, në punën e tij të përditshme prej inxhinieri.

Ai tha se paraprakisht është aftësuar dhe ka përfituar përvoja profesionale në aspektin praktik përmes mbajtjes së punës praktike në kompaninë Bechtel Enka, si dhe në kompani të tjera.

"Puna e vazhdueshme, përkushtimi dhe vendosmëria për t'i arritur qëllimet e mia, janë parametrat bazë për arritjen e suksesit, e kur kësaj i shtohet ndihma e profesorëve dhe e stafit të UBT-së, sigurisht që qëllimet arrihen me lehtësi", theksoi ai.

Pëllumbi tha se Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë është një program që krahasohet me universitetet tjera në Evropë, për nga cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

"UBT si institucion arsimor krahasohet me universitetet tjera evropiane, duke u bazuar kryesisht në përvojat e kolegëve dhe studentëve të tjerë që vijnë nga universitete të njohura. Mendoj se jemi në nivel thuajse të njëjtë dhe kjo gjë e bënë më të lehtë bashkëpunimin, studimin, apo punën në vendet e ndryshme të botes", shtoi ai.

Studentët e UBT-së nga të gjitha programet e studimit janë duke u sistemuar në tregun ndërkombëtar të punës, dhe për më tepër, kanë shkallë të njëjtë të kompetencave me kolegët e tyre që janë shkolluar nëpër universitete më të mira në botë.

Studenti Egzon Hasi përfitues i bursës në Universitetin "Nova de Lisboa", në Portugali

Ai tha se UBT ishte zgjedhje ideale për vazhdim të studimeve, pasi siç tha ai, është qendër rajonale për Shkenca Kompjuterike.

"Përkushtimi dhe pjesëmarrja e vazhdueshme në projektet e ndryshme që na janë ofruar gjatë studimeve më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shume për arritjen e këtyre rezultateve. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe bashkëpunimi dhe ndihma e vazhdueshme nga ana e profesorëve të cilët gjithmonë na kanë frymëzuar dhe motivuar", tha ai.

Egzoni tha se UBT shquhet për shkencë dhe inovacion, dhe institucioni i vetëm arsimor që ndihmon studentët e vet në ngritje akademike dhe profesionale.

Studenti i UBT-së, Getuart Dragobuzhda themelon byronë projektuese "Section Architecture

Getuart Dragobuzhda është student i nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, i cili ka hapur byronë projektuese "Section Architecture", me seli në Ferizaj.

Ai ka marrë një nismë të tillë për të sjellë frymë të re, gjithnjë në përshtatje me trendët e fundit arkitekturore.

Sipas tij, UBT e mbështeti rrugëtimin e tij dhe përgatitjen profesionale, teksa falënderoi institucionin dhe profesorët e arkitekturës.

"Programet e studimit në UBT sjellin përfitime të mëdha, sepse ato janë aq mirë të ndërlidhura mes vete, saqë puna teorike pasohet menjëherë me punën praktike brenda fakultetit dhe vizitat studimore jashtë UBT-së. Programi arkitekturës harmonizohet me universitetet jashtë vendit si "Politecnico di Milano", në Itali, e shumë universitete në botë", tha ai.

Getuari tha se byroja projektuese që ai drejton, bën projektimin e objekteve individuale, kolektive dhe objekteve kulturore, njëherësh bën vizuelizimin dhe animin e objekteve arkitektonike.

Ai bëri të ditur se së fundmi, byroja projektuese "Section Architecture" ka marrë edhe përfaqësinë e programit për vizuelizim "Lumion" në Kosovë dhe Shqipëri, për shitjen dhe trajnim për këtë program.

Studenti Behar Haxhismajli përfitues i bursës semestrale në Portugali

Behar Haxhismajli, student i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, është njëri nga studentët përfitues të bursës semestrale për Universitetin "Nova de Lisboa", në Portugali.

Behari është përzgjedhur si fitues i kësaj burse falë notës së lartë mesatare që ka arritur gjatë studimeve në UBT, ndërkaq studimet në Portugali do t'i fillojë në fillim të muajit shkurt të vitit 2020.

Ai ka thënë se ka qenë zgjidhje ideale që studimet themelore t'i fillojë në institucionin që njihet në fushën e Shkencave Kompjuterike.

"Përvojat e mija universitare deri më tani kanë qenë të mahnitshme. Kam mësuar dhe përjetuar kaq shumë gjëra të reja në një periudhë 2 vjeçare dhe ka kaluar kaq shpejtë. Unë ende po zbuloj të gjitha mundësitë që universiteti më ofron. Kështu, ka qenë vendimi më i mirë në jetën time që kam zgjedhur ti vazhdoj studimet në UBT" theksoi ai.

Që nga themelimi, studentët e UBT-së kanë pasur mundësinë t'i vazhdojnë studimet jashtë vendit, për një semestër ose vit akademik në pothuajse të thitha shtetet apo universitetet më të njohura në botë.

Studenti i Mekatronikës, Edonis Hebibi përfiton bursë studimi në Bullgari

Përpjekja për të përfituar bursë studimi, qoftë për një semestër apo bursë të plotë, nuk është e paarritshme nga studentët e UBT-së, kjo si rezultat i marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që institucioni ka të nënshkruar me mbi 450 universitete botërore.

UBT u bë qendër e karrierës për qindra studentë, të cilët u mbështetën nga institucioni në jetësimin e ëndrrës së tyre, për vazhdim të studimeve në universitetet më të mira dhe të njohura në botë.

Nga mundësitë unike që i ofron UBT, ka përfituar edhe studenti i Fakultetit të Mekatronikës, Edonis Hebibi.

Ai ka fituar bursë semestrale për vazhdim të studimeve në Universitetin "Technical", në Sofje të Bullgarisë.

"Suksesi i deritanishëm ka ardhur si rezultat i punës së vazhdueshme, orët e gjata të studimit e sidomos përkushtimit dhe vendosmërisë që vazhdimisht kisha. Gjithashtu, bashkëpunimet e mira në mes të profesorëve dhe kolegëve kanë qenë disa nga faktorët kryesor për arritjen e rezultateve pozitive në studimet themelore", tha ai.

Edonisi theksoi se gjatë studimeve në UBT, ai dhe kolegët e tij, janë bindur që institucioni ka staf akademik tejet të përgatitur profesionalisht, gjë që ka ndikuar në arritjen e rezultateve të mira nga studentët.

Studenti Ilir Asllani përfitues i bursës së studimeve në Suedi

Studenti i nivelit bachelor në Fakultetin Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Ilir Asllani, ka përfituar bursë studimi në Universitetin "Linnaeus", në Suedi. Iliri do të vijoj semestrin e gjashtë të studimeve themelore në këtë universitet, ndërkaq tha se është i lumtur që do t'i vazhdon studimet jashtë vendit.

"UBT është një institucion që përgatit studentët të integrohen shpejt në industri, sepse në institucion zhvillohet mësim interaktiv gjë që lehtëson arritjen e objektivave akademike dhe profesionale. UBT më ofroi mundësinë dhe falënderoj institucionin për këtë mundësi dhe aftësimin tim akademik përgjatë rrugëtimit tim si student", tha ai. Shumë studentë të UBT-së, vetëm gjatë këtij muaji përfituan bursa studimi në shtete të ndryshme evropiane, përfshirë shtetet si: Gjermani, Suedia, Portugali, Bullgari, Kroaci, etj.

Ish-studenti Rilind Sadiku, përmes UBT-së, përfitoi bursë studimi në Gjermani

UBT është model i institucionit që mundëson jetësimin dhe realizimin e ëndrrave të studentëve kosovarë, për vazhdimin e studimeve në vendet dhe universitetet prestigjioze dhe të njohura në botë.

Falë partneritetit që institucioni ka me mbi 450 universitete ndërkombëtare, ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Rilind Sadiku, përfitoi bursë për të vazhduar studimet në nivelin master në "Anhalt University of Applied Sciences", në Gjermani.

"Me mbështetjen e UBT-së, në kuadër të projektit Eramus+, jam duke studiuar master në Gjermani. Përgjatë një semestri, sa edhe do të qëndroj, kam mundësinë për tu njohur me kultura të ndryshme, pasi që programi është internacional dhe studentët vijnë nga vende të ndryshme dhe kultura të ndryshme, eksperiencë nga e cila do të përfitoj bashkëpunim dhe njohje të reja", tha ai.

Rilindi tha se gjatë studimeve në UBT, ai pati mundësinë të jetë pjesë e projekteve të rëndësishme, siç ishin projektet për Komunën e Prishtinës, të Kamenicës, etj.

Ai falënderoi institucioni, familjen dhe shoqërinë për mbështetjen e dhënë gjatë rrugëtimit të tij akademik.

Kompanitë gjermane të interesuara për të punësuar studentët e Infermierisë

UBT është qendër e inovacionit për mjekësi në Kosovë dhe rajon, e pajisur me laboratorë e pajisje të sofistikuar, ku çdo vit nxjerr kuadro të përgatitura profesionalisht në fushën e shëndetësisë.
Studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT, tashmë janë dëshmuar edhe në tregun e punës, si rezultat shumë kompani gjermane po shprehin interesim për t'i punësuar ata në spitale të shtetit gjerman.
Madje, kompania "TG Personalconsulting" mbajti sesion informues me këta studentë, për t'i informuar gjerësisht rreth mundësisë së vazhdimit të studimeve dhe punësimin e tyre.
Gjatë sesionit informues, përfaqësuesi i kësaj kompanie, Thomas Graf, është shprehur i mahnitur me njohuritë dhe shkathtësitë e studentëve.
Ai u tha studentëve që kjo kompani bashkëpunon me institucione të shumta partnere, ku u mundësojnë studentëve kontrata të vlefshme juridikisht, për studime dhe punësim në fushën e infermierisë në Gjermani.
Graf theksoi se studentët e interesuar për të aplikuar për vazhdim të studimeve dhe punësim në klinika dhe spitale gjermane duhet të lajmërohen në Fakultetin e Infermierisë në UBT, ose të shkruaj në email: inf@ubt-uni.net.

Studentët e UBT-së hapën ekspozitë në Galerinë e Arteve në Pejë

Dhjetëra punime të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, janë prezantuar në hapjen e ekspozitës në Galerinë e Arteve në qytetin e Pejës.
Punimet i dedikohen qytetit të Pejës, ku në mënyrë artistike është paraqitur urbanizimi i komunës, me ç'rast në hapjen e ekspozitës mori pjesë edhe kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri, njëherësh edhe drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Engelbert Zefaj.
Kryetari Haziri dhe drejtori Zefaj vlerësuan lartë studentët e UBT-së, të cilët thanë se janë të kënaqur me punën e tyre, sepse sipas tyre, studentët kanë ideuar punime kreative që mund të gjejnë zbatim në praktikë.
Ata theksuan se UBT ka studentë dhe staf mjaft të përgatitur saqë bashkërisht ideojnë punime kualitative urbane-arkitektonike, që mund të implementohen edhe në praktike.
Ekspozitën patën mundësi ta shohin të gjithë të interesuar, ku edhe janë informuar rreth relizimit të punimeve.

Ligjëruesja Fitore Isufi dhe studentët e UBT-së realizuan një vepër unike artistike

Ligjëruesja Fitore Isufi, në bashkëpunim me studentët e Arkitekturës dhe ata të Dizajnit të Integruar, Sami Podvorica, Kushtrim Lushtaku dhe Djellza Bullaku, si pjesë e ekipit punues, kanë realizuar intervenimi artistik, të titulluar "Flirting with leftovers", në ish-restorant Marsi, ku ky intervenim shpalosi më shumë për historinë e këtij objekti, por edhe provokoi ndjesinë e përjetimit të vetë prezencës së objektit si eksperiencë.
Ish-restorant Marsi, ende i pa studiuar për vlerat arkitektonike, historike, kulturore dhe sociale, ka ngelur si udhëkryq edhe për vetë përcaktuesit e fatit të tij. Prandaj, përpos hulumtimit dhe mbledhjes së memories kolektive, studentët e Arkitekturës dhe ata të Dizajnit, e kanë shpalosur vizionin e tyre mbi këtë objekt, duke ofruar zgjidhje përmes alternativave të ndryshme të rifunksionalizimit të këtij objekti.
Ish-restorant Marsi, është objekt i braktisur, që i takon periudhës së ndërtesave modeniste, i cili gjendet tek lagjja Kodra e Trimave, në Prishtinë. Është ndërtuar në fund të viteve 70 –ta, si vetëshërbim i NSHT 'Voçari'. Në vitin 1995 nga vetëshërbimi është shndërruar në restorant. Pas luftës së fundit, ky vend ka qenë klub nate, ndërsa prej vitit 2003 ka mbetur i braktisur.
Në bashkëbisedim me përfaqësues të institucioneve publike, NGO-ve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, kuptohet që është bërë shumë pak në revitalizimin apo rifunksionalizimin e këtyre objekteve.

Profesoresha e UBT-së, Nexhmije Ajeti prezanton punimin e saj shkencor në Kongresin Ndërkombëtar të Endodentëve



Ligjëruesja në UBT, Nexhmije Ajeti ka marrë pjesë në Kongresin Ndërkombëtar të Endodentëve (ESE Biennial Kongress of Endodontology), i cili këtë vit është mbajtur në Vjenë të Austrisë.
Në këtë kongres ajo e përfaqësoi UBT-në dhe prezantoi punimin shkencor të titulluar "Effect of Chloroform and Eucaliptus oil on Mineral Content of Human Root Dentin".
Qëllimi i Kongresit Ndërkombëtar të Endodentëve ishte njohja me të arriturat më të reja në fushën e endodontologjisë, teknikat e reja te instrumentimit dhe irrigimit të kanalit të rrënjës së dhëmbit, etj.
Shkencëtarët e UBT-së dhe kontributi i tyre përmes hulumtimeve shkencore po bën që Kosova të futet në hartën e shteteve që po japin kontribut për zhvillimin e shkencës kudo.

Profesorët në UBT, pjesë e delegacionit kosovar në Kongresin e blerësve evropianë, në Berlin

Një delegacion i UBT-së i përbërë nga profesorët Besnik Qehaja dhe Hasan Metin, janë duke marrë pjesë në Kongresin më të madh të blerësve në Evropë.
Kosova është duke u përfaqësuar në këtë kongres që po mbahet në Berlin, falë bashkëpunimit strategjik të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), me Asociacionin për Menaxhimt të Zinxhirit të Furnizimit, Prokurimit dhe Logjistikës (BME).
Delegacioni kosovar, në mesin e të cilit janë edhe profesorët të UBT-së, përbëhet edhe nga anëtarë të tjerë të firmave anëtare të OEGJK-së. Ata do të kenë mundësinë e diskutimit me ekspertë nga vende të ndryshme, teksa do të kenë takime me B2B.
Gjithashtu, ky kongres u mundëson delegacionit kosovar krijimin kontakteve me kompanitë më prestigjioze gjermane.
Shtandi i OEGJK-së në Simpoziumin e BME-së u sponsorizua nga UBT dhe Devolli Corporation, M-Technologie.

UBT me aksionin humanitar "Studentët për Shqipërinë"

UBT, në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me moton "Studentët për Shqipërinë", kanë nisur aksion për grumbullimin e të gjitha mjeteve për të cilat kanë nevojë bashkëkombësit tanë.
Deri tani aksionit i janë bashkuar dhjetëra studentë të UBT-së, por edhe të institucioneve tjera, teksa studentët kanë lëshuar shtëpitë e tyre dhe hotelet për të gjithë të prekurit dhe ata në nevojë.
Organizatorët njoftojnë që grumbullimi po bëhet në kampuset dhe qendrat e UBT-së, në Prishtinë, Lipjan, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj, teksa po mblidhen të holla, veshmbathje, gjëra ushqimore, etj.
Përderisa tërmetet e njëpasnjëshme lanë të vdekur e qindra të plagosur, janë edhe qindra familje të tjera që ju duhen para, veshmbathje, ushqim e batanije, pasi momentalisht kanë mbetur pa kulm mbi kokë, madje kanë frikë edhe të kthehen në shtëpitë e tyre.
"Ne jemi një, e tërmeti që goditi Shqipërinë e goditi gjithë kombin shqiptar. Ngushëllime për të vdekurit, bashkëndjejmë me të gjithë të prekurit. Humaniteti është gjithçka që na duhet këto ditë, andaj tregoni shpirtin tuaj solidar", thuhet në njoftimin e lëshuar nga organizatorët.
Grumbullimi i mjeteve ka filluar, teksa kushdo dhe sido që ka mundësi, mund të kontribuojë.

UBT anëtare e Organizatës Evropiane të Shkencës dhe Teknologjisë

UBT përfaqëson Kosovën në takimin e menaxhmentit të organizatës "COST Action"

Kosova renditet në listën e shteteve që do të ofrojë ndihmë në zhvillim të shkencës dhe teknologjisë, ku si anëtare e Organizatës Evropiane të Shkencës dhe Teknologjisë, "COST Action", për herë të parë po merr pjesë edhe në takimin e menaxhmentit të kësaj organizate.

Takimi po zhvillon punimet në Riga të Letonisë, teksa vendi është duke u përfaqësuar nga profesorët në UBT, dr.Muhamet Ahmeti dhe dr. Visar Krelani.

Gjatë këtij takimi u theksua se UBT dhe shteti i Kosovës, do të përkrahet profesionalisht në zhvillimin profesional të stafit, si dhe do të përkrah institucion në projekte hulumtuese nga organizata "COST Action", që udhëheq projektin e financuar nga Bashkimi Evropian "SARCOS", projekt që menaxhohet nga Spanja.

Projektet që në të ardhmen do të përkrahen, janë kryesisht të fushës së inxhinierisë së ndërtimit dhe infrastrukturës, konkretisht projekte që për tematikë kanë betonin e vetëshërueshëm nga plasaritjet, betonet me fibra dhe ato vetëngjeshëse, si dhe metodat e përgatitjes dhe analizimi i tyre në laboratorët përkatës.

Përveç UBT-së, pjesë e këtij takimi ishin universitete nga Spanja, Italia, Letonia, Anglia, Sllovenia, Greqia, Norvegjia, Turqia, Qipro, Malta, Serbia, Bosnja e Hercegovina, Hungaria, etj.

Pas këtij takimi, organizata "COST Action" ka ftuar përfaqësuesit e UBT-së që të marrë pjesë në konferencën e materialeve, e cila do të mbahet më 26 dhe 27 shtator.

UBT, institucioni i parë dhe i vetëm në rajon i akreditуar ndërkombëtarisht për siguri kibernetike

Siguria kibernetike është një ndër sfidat më të mëdha globale, diskutimi për të cilën ka filluar shumë vite më parë, për të vijuar edhe sot.

UBT e ka identifikuar me kohë këtë sfidë, andaj edhe u bë pionier në edukimin e njerëzve mbi rëndësinë e sigurisë kibernetike dhe rreziqeve nga hakimet e hakerët.

Sot, jo vetëm që njihet si shkollë për përgatitjen e hakerëve të bardhë, por edhe si institucioni që e bëri Kosovën pjesë të rrjeteve dhe organizatave më të njohura dhe më të mëdha botërore për siguri kibernetike.

UBT-CERT është divizioni i parë i sigurisë kibernetike i themeluar ndonjëherë në Kosovë me licencë ndërkombëtare, dhe jo vetëm kaq, ofroi ndihmë edhe për themelimin e CERT-ve të tjerë në Kosovë dhe rajon, përfshirë edhe CERT-in qeveritar.

UBT-CERT është divizioni i parë dhe i vetëm nga Republika e Kosovës dhe Ballkani, që u anëtarësua dhe akreditua nga mekanizmi më i madh ndërkombëtar për siguri kibernetike, "FIRST", duke e futur kështu vendin tonë në listën më të madhe të CERT-eve ndërkombëtarë.

Po ashtu, UBT-CERT është ekipi i parë nga Kosova që u akreditua në organizatën ndërkombëtare, "Trusted Introducer", teksa e listoi vendin edhe në Agjencinë Evropiane për Rrjet dhe Siguri të Informacioneve (ENISA).

UBT hodhi hapat e parë në Kosovë edhe me hapjen e laboratorit të parë për siguri kibernetike në rajon, që shërben edhe sot si qendër e koordinimit dhe organizimit për CERT-ekipet në Kosovë dhe më gjerë, por edhe si pikë reference në fushën e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale.

Jo rastësisht UBT ishte dhe mbetet organizator, bashkorganizator dhe nikoqir i konferencave më të mëdha në Kosovë e rajon për siguri kibernetike, organizator e bashkorganizator i garave që mbledhin çdo vit qindra njohës të sigurisë kibernetike, por mbi të gjitha, mbetet edhe shkollë për qindra të pasionuar pas sigurisë kibernetike, e që talentin dhe njohuritë i tyre i kanë shfaqur nëpër gara ndërkombëtare, duke triumfuar e duke u dalluar në secilën prej tyre.

Në UBT u promovua libri "Nga Planifikimi Urban Modern, Drejt Planifikimit Hapësinor të Integruar"

Ka filluar të jetësohet marrëveshja e bashkëpunimit që është nënshkruar ditë më parë nga UBT, Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe UN-Habitat, në kuadër të së cilës ishte paraparë edhe mbajtja e punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban.

Punëtoria tashmë ka filluar punimet dhe është duke u mbajtur në Mitrovicë, ku ka mbledhur grupin punues prej rreth 30 studentëve që kanë përgatitje akademike përfshirë në fushat: arkitekturë, planifikim urban, mjedis, sociologji dhe ekonomi.

Grupi punues së bashku me përfaqësuesit e lagjeve u mblodhën për të ndarë përvojat, idetë, si dhe për të dhënë ekspertiza profesionale në këtë drejtim.

Në hapjen e punëtorisë, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se institucioni që ai drejton do t'u ofrojë bashkëpunim palëve të interesit në fushën e urbanizmit, si dhe do të ndihmojë komunat dhe komunitetin në implementimin e projekteve të tilla. Hajrizi tha se projekti u mundëson studentëve pjesëmarrës marrjen e përvojave profesionale në profesionin që ata kanë zgjedhur.

Ndërkaq, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore, Faruk Muja falënderoi UBT-në dhe UN-Habitat për mbështetjen e dhënë në aspektin akademik, si dhe mbështetjen e dhënë me kapacitete humane e logjistike.

Tutje, profesorët në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Binak Beqaj dhe Elvida Pallaska mbajtën ligjërata tematike për studentët dhe të pranishmit të tjerë. Më pas, grupet punuese vazhduan punimet e parapara të projektit, ku përgjatë një jave do të hartojnë koncepte që do të përfshihen në strategjitë zhvillimore të komunës, si dhe do të implementohen në praktikë.

Punëtoria do të përmbyllë punimet të premten, më 1 nëntor, ndërkaq rezultatet e punëtorisë do prezantohen në Ditën Botërore të Planifikimit, konkretisht më 8 nëntor.

Në Mitrovicë fillon punëtoria për Dizajn dhe Zhvillim Urban

Ka filluar të jetësohet marrëveshja e bashkëpunimit që është nënshkruar ditë më parë nga UBT, Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe UN-Habitat, në kuadër të së cilës ishte paraparë edhe mbajtja e punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban.

Punëtoria tashmë ka filluar punimet dhe është duke u mbajtur në Mitrovicë, ku ka mbledhur grupin punues prej rreth 30 studentëve që kanë përgatitje akademike përfshirë në fushat: arkitekturë, planifikim urban, mjedis, sociologji dhe ekonomi.

Grupi punues së bashku me përfaqësuesit e lagjeve u mblodhën për të ndarë përvojat, idetë, si dhe për të dhënë ekspertiza profesionale në këtë drejtim.

Në hapjen e punëtorisë, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se institucioni që ai drejton do t'u ofrojë bashkëpunim palëve të interesit në fushën e urbanizmit, si dhe do të ndihmojë komunat dhe komunitetin në implementimin e projekteve të tilla. Hajrizi tha se projekti u mundëson studentëve pjesëmarrës marrjen e përvojave profesionale në profesionin që ata kanë zgjedhur.

Ndërkaq, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore, Faruk Muja falënderoi UBT-në dhe UN-Habitat për mbështetjen e dhënë në aspektin akademik, si dhe mbështetjen e dhënë me kapacitete humane e logjistike.

Tutje, profesorët në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Binak Beqaj dhe Elvida Pallaska mbajtën ligjërata tematike për studentët dhe të pranishmit të tjerë. Më pas, grupet punuese vazhduan punimet e parapara të projektit, ku përgjatë një jave do të hartojnë koncepte që do të përfshihen në strategjitë zhvillimore të komunës, si dhe do të implementohen në praktikë.

Punëtoria do të përmbyllë punimet të premten, më 1 nëntor, ndërkaq rezultatet e punëtorisë do prezantohen në Ditën Botërore të Planifikimit, konkretisht më 8 nëntor.

Gazetarja Susanna Inkinen njofton studentët e UBT-së me gjendjen e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve medialë

Gazetarja dhe ekspertja e mediave, Susanna Inkinen mbajti ligjëratë tematike për studentët e shkencave sociale në UBT, me ç'rast theksin e vendosi tek tema "Siguria e gazetarëve dhe punonjësve medialë".

Ajo trajtoi gjendjen e gazetarëve dhe të industrisë mediale në mbarë botën, si dhe problemet me të cilat ata përballen, por duke u fokusuar në gjendjen në Afganistan, pasi aktualisht është duke vepruar atje, në kuadër të organizatës "International Media Support".

Ndër tjerash, Inkinen tha se gazetarët atje janë pre e sulmeve terroriste dhe pre e kërcënimeve digjitale, të cilat po bëhen me qëllimin e vetëm, atë të frikësimit të gazetarëve dhe cenimit të fjalës së lirë.

Ajo i këshilloi studentët që të zhvillohen, të përgatiten për sfidat e profesionit dhe të ndërrojnë për të mirë gjendjen aktuale të gazetarisë.

Në Mitrovicë ekspozohen projekt propozimet e studentëve për planifikimin urban të komunës

Ka përfunduar punimet punëtoria për "Dizajn dhe Zhvillim Urban", e cila është zhvilluar si rezultat i jetësimit të marrëveshjes së bashkëpunimit që është nënshkruar mes UBT-së, komunës së Mitrovicës së Jugut dhe UN-Habitat.

Në këtë punëtori, pesë grupe të studentëve zhvilluan skenarë ose projekt propozime dhe dhanë sugjerimet e tyre për zhvillimin hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës.

Skenarët për zhvillimin e zonës përfshijnë konceptin "Open City", që nënkupton qytet i hapur në aspektin fizik dhe diversitetit socio-kulturor, rivitalizimi i bregut të lumit Ibër, lidhja e hapësirave publike, rigjallërimi i tregut të gjelbër, etj.

Këto skenarë do të ekspozohen në Ditën Botërore të Planifikimit të Qyteteve, më 8 Nëntor, ngjarje e organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me partnerët e programit.

Në këto projekt propozime u dhanë ide inovative nga studentët e UBT-së për zhvillimin e zonës, konkretisht për projektin e komunës së Mitrovicës Jugore. Idetë e paraqitura në projekt propozime do të implementohen bashkë me planet zhvillimore të qytetit.

UBT, nikoqir i projektit "Zhvillimi dhe implementimi i programit të PhD në ICT për sistemin arsimor të Kosovës"

Projekti i financuar nga programi Erasmus+ "Zhvillimi dhe implementimi i programit të PhD në ICT për sistemin arsimor të Kosovës", që ka për synim themelimin dhe zhvillimin e shkollës së IT-së në Kosovë, do të mbajë takimin e parë mes universiteteve partnere më 25-26 nëntor, në Kampusin e UBT-së, në Lipjan.

Projekti synon të zhvillojë një edukimi të ciklit të tretë në fushën e IT-së, me qëllim të dhënies së kontributit në zhvillimin e aftësive hulumtuese brenda shtetit, projekt ky që do të ketë buxhet afro 1 milion euro.

Konkretisht, pritjet nga ky projekt në fushën e zhvillimit të aftësive hulumtuese, në atë mënyrë që pastaj të ndihmojë po ashtu edhe në zhvillimin e arsimit të lartë, si dhe në sektorin e tregtisë, industrisë dhe sektorit publik në Kosovë.

Partnerë implemetues në këtë projekt do të jenë: NTNU University – Norvegji, SEERC – Greqi, UBT – Kosovë, Universiteti i Prishtinës – Kosovë, Universiteti i Prizrenit – Kosovë, Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, në krye me Linneaus University. Po ashtu, si partnerë të asociuar do të jenë të përfshirë edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, Kosbit Industry dhe BPB Bank.

Fakulteti i Shkencave të Ushqimit shënon Ditën e Ushqimit me ligjëratë tematike

Për të shënuar 16 Tetorin, Ditën Botërore të Ushqimit, Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Teknologjisë organizoi ligjëratë tematike me zyrtarin nga Agjensioni i Veterinarisë dhe Ushqimit, Lamir Thaqi.

Ai bisedoi me studentët në lidhje me punën që bëhet nga ky institucion, përfshirë kontrollin e ushqimeve në treg, doganën, masat e marra për skandalet e ndodhura gjatë viteve të fundit në Kosovë, situatën në vend mbi sigurinë e ushqimit dhe jo vetëm. Thaqi u tregua i hapur me studentët dhe u tregoi atyre në lidhje me praktikat dhe vizitat që mund t'i mbajnë në institucionin përkatës.

Studentët e UBT-së dëgjojnë ligjëratë nga artisti i njohur, Luka Saviq

Shumë studentë të Fakultetit të Dizajnit të Integruar dhe të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor dëgjuan ligjëratë nga artisti i njohur kontemporan, Luka Saviq nga Angewandte – University of Applied Arts, Vienna. Përmes temës "Black Mountain College after Bauhaus", Savic tregoi mbi rëndësinë e universitetit interdiciplinar, ku shumë mediume shkrihen në një të vetëm, sikurse arti, skulptura dhe teatri. Në këto raste, studentët kanë laboratorë të përbashkët, dhe edukimi zhvillohet në mënyrë eksperimentale.

Kjo formë e të studiuarit në këtë kolegj u bë më vonë shembull i botës dhe shërbeu si referencë për shkolla të moderuara të dizajnit.

UBT përkrah dhe motivon studentët me bursa studimi

Studentët e UBT-së janë ndër më të suksesshmit në tregun e punës, jo vetëm për cilësinë dhe kriterin e lartë të studimeve, por edhe për shkak të motivimit dhe përkrahjes që institucioni e ka dhënë për studentët përgjatë gjithë viteve të studimeve.

Kësisoj, UBT e ndihmon zhvillimin e kuadrove të reja duke ndarë bursa në vlerë prej 1 milion e 400 mijë eurosh për studentët e vet. Kurse, studentët tanë na shpërblejnë më së miri, duke u përgatitur profesionalisht dhe duke gjetur punë gjatë ose menjëherë pas përfundimit të studimeve.

Të gjithë studentët, të cilët gjatë një viti akademik kanë arritur minimumi notën mesatare 9.0, por edhe ata që i takojnë kategorive të parapara me rregulloren e institucionit, kanë qenë dhe do të jenë përfitues të bursave institucionale.

Kështu, UBT ka ndihmuar dhe lehtësuar edhe barrën që rëndon familjet kosovare për shkollim të fëmijëve, me ç'rast falë këtyre bursave familjet kosovare kanë kursyer afro 1 milion e gjysmë euro, duke bërë kështu më të lehtë dhe më motivues studimin për studentët e vet.

Përveç bursave, UBT i ka ndihmuar qindra studentë që të pranohen dhe të vijojnë studimet nëpër universitet më prestigjioze ndërkombëtare, prej ku po kthehen me kompetenca të larta dhe me dëshirë të madhe për të dhënë kontribut për Kosovën.

UBT, institucioni i vetëm arsimor në vend që organizon udhëtimin vjetor "Eurotrip"

UBT edhe sivjet ka organizuar udhëtimin vjetor në shtetet e Evropës, ku sikurse edhe herëve tjera, shumë studentë do të vizitojnë qytetet e ëndrrave të tyre.

Rreth 100 studentë këtë vit do të nisin turnin rinor, për të përjetuar kujtime të paharrueshme nga udhëtimet argëtuese, njëherësh do të kenë mundësinë të marrin edhe përvoja dhe të përfitojnë njohuri në fusha të ndryshe studimi.

Studentët do të udhëtojnë në Eurotrip në rreth 15 qytete, me qëllim të krijimit të lidhjes midis tyre dhe kulturave të ndryshme. Amsterdam, Roterdam, Venecia, Paris, Praga, Vjena, Berlin, Leipzing janë vetëm disa nga vendet që pritet që studentët ti vizitojnë, me ç'rast do të shohin nga afër monumente kulturore, sheshe, objekte me vlera arkitektonike, muze dhe institucione arsimore dhe qeveritare.

Nisja në këtë udhëtim do të bëhet më 22 nëntor, ku do qëndrojnë 15 ditë, ndërkaq kthimi do të bëhet më 6 dhjetor 2019.

UBT është institucioni i vetëm arsimor që organizon vizita të tilla dy herë në vit, teksa deri tash mijëra studentë patën mundësinë që përmes Eurotripi-it të vizitojnë vende të ndryshme.

Studentët e UBT-së vizitojnë qytetin e Venecias

Mbi 100 studentë të UBT-së, kanë udhëtuar për në Itali, të cilët po qëndrojnë për vizitë studimore në pjesën verilindore të këtij shteti, konkretisht në qytetin e bukur të Venecias.

Ata po shohin nga afër qendra të rëndësishme kulturore, historike, shkencore dhe arkitekturore. Tutje, ata vizituan "Grand Canal", që është një kanal i cili formon një nga korridoret kryesore të trafikut ujor në qytet, si dhe u vizituan sheshet kryesore dhe zona qendrore e Venedikut, "Rialto", që shërbeu për shumë shekuj si zemra financiare dhe tregtare e qytetit.

Ditëve në vijim, studentët do të udhëtojnë në shumë qytete të Evropës, vizitë e cila ju mundëson marrjen e përvojave të reja profesionale, njëherësh të njihen nga afër me kulturën evropiane.

Studentët e UBT-së realizojnë vizitë studimore në Turqi

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar, së bashku me Drejtorin për Çështje Akademike në UBT, dr. Muhamet Ahmeti, si dhe profesorë të fakulteteve përkatëse, për disa ditë me radhë po qëndrojnë në vizitë studimore në Turqi.

Ata po vizitojnë objekte të ndryshme historike në qytetin e Stambollit dhe qytete tjera. Fillimisht vizituan Universitetin "Kadir Has", më pas edhe Universitetin "Mimar Sinan", "Zollu Center", etj.

Studentët, nën shoqërimin e profesorëve, vizituan edhe Panairin e Produkteve, që mbahet çdo vit në këtë shtet, ku panë nga afër produktet, teknologjitë dhe novacionet e fundit në industrinë e ndërtimit.

Kjo vizitë studimore u realizua me qëllim që studentët të shohin nga afër objekte historike dhe për t'u njohur me infrastrukturën që objektet e posedojnë.

Studentët e MBE-së vizitojnë kompaninë "Loni Dektor" në Mitrovicë

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi në UBT, kanë zhvilluar vizitë studimore në kompaninë "Loni Dekor", me ç'rast janë informuar lidhur me aktivitetet biznesore, menaxhimin dhe projektet që zhvillohen në kuadër të kompanisë.

Vizita është realizuar në shoqërimin e profesoreshës Dr.Sc. Besa Veseli, teksa studentët janë njoftuar me sistemin se si funksionon kjo kompani, standardet me të cilat punon dhe rezultatet që ka arritur kompania që nga themelimi e deri tek eksporti në shtetet evropiane, si Zvicër, Gjermani, Austri, etj.

Gjithashtu, studentët e MBE-së patën rastin që të vizitojnë edhe ambientet e përpunimit të drurit nga faza fillestare deri tek produkti final.

Studentët e UBT-së fitojnë eksperienca të ndryshme në Milano

Turi i vizitës nëpër Evropë, i organizuar nga UBT, ka vazhduar vizitën në shtetin e Italisë, konkretisht në qytetin e modës, artit dhe kulturës, në Milano.

San Carlo al Corso, Diomo di Milano, Fashion District, Milan, Milan Cathedra, janë vetëm disa qendra që studentët patën rastin ti vizitojnë, qendra të cila posedojnë vlera të mëdha kulturore, njëherësh edhe arkitekturore.

Nga këto vizita, studentëve u është mundësuar edhe përfitimi i njohurive të reja mbi fushën e arkitekturës, ndërtimtarisë, artit e kulturës që ndodhet në këtë qytet.

Vizita do të vazhdojë nëpër qytete tjera të Evropës, ku do të vizitohen shumë qendra, institucione të njohura në gjithë botën.

Studentët e Shkencave të Ushqimit vizitojnë kompaninë "Fluidi" në Gjilan

Me qëllim për të parë nga afër punën dhe funksionimin e një ndërmarrjeje prodhuese, studentët e vitit të tretë të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në kompaninë Fluidi, në Gjilan.

Ata kanë parë nga afër teknologjinë e prodhimit dhe ambalazhimin e pijeve joalkoolike "Jaffa Champion" dhe vajit vegjetal "Floil". Studentët u njohën me procesin e punës, teksa panë edhe ambalazhimin e pijeve dhe vajit.

Studentët u shprehën të kënaqur me realizimin e vizitës studimore, pasi sipas tyre, UBT po u mundëson ndërlidhjen e teorisë me praktikën.

Kjo vizitë është realizuar në kuadër të lëndëve: "Teknologjia e pijeve jo alkoolike dhe freskuese" dhe "Ambalanzhimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore".

Studentët e Shkencave Politike vizitojnë Kuvendin e Kosovës

Në shoqërimin e profesorit, Alfred Marleku, në kuadër të lëndës Qeverisja dhe Institucionet Politike, studentët e vitit të parë të Fakultetit Shkenca Politike në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Kuvendin e Kosovës.
Studentët me këtë rast u njoftuan me punën, funksionin dhe rolin e kuvendit, teksa panë nga afër edhe hapësirat të cilat zhvillohen mbledhjen parlamentare.
Qëllimi i vizitës ishte që studentët të njihen me rëndësinë e institucionit që luan rol të rëndësishëm në vend, siç është Kuvendi i Kosovës.

Studentët e UBT-së realizuan vizitë studimore në KEK

Studentët e vitit të dytë të Inxhinierisë së Energjisë, kanë realizuar vizitë studimore në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), nën udhëheqjen e profesorëve në UBT, Vehbi Sofiu, Afrim Osmani, Sami Gashi, Faton Maloku dhe Afete Shala.
Studentët u informuan dhe morën njohuri praktike inxhinierike për termocentralin e gjenerimit të energjisë elektrike, Kosova A, për kapacitetet e thëngjillit për gjenerim të energjisë elektrike, mënyrën e transportimit të thëngjillit, për skadën operuese dhe sistemin e punës SCAD-ave komanduese, për sistemin e funksionit të mbrojtjes dhe sistemin e punës informative, etj.
Po ashtu, studentët vizituan edhe mihjen sipërfaqësore në Sibovc, ku u pritën nga inxhinieri, Gezim Ternava, i cili i informoi se si behet furnizimi me energji elektrike të ekskavatorëve, transformimin e tensioneve në rrjetin lokal, transformimin e tensionit në nënstacionin 110kV/06kV.

Vizitë është realizuar edhe në laboratorin e Institutit INKOS, ku studentët i priti drejtori i institutit, prof. dr. Naim Baftiu, i cili i njoftoi studentët për së afërmi për punët hulumtuese dhe inxhinierike që kryhen në institut, si dhe pajisjet që përdoren për matjen e analizave të ndryshme të ndotjes së ajrit dhe mbrojtjes mjedisore.

Studentët e Shkencave të Ushqimit vizitojnë Industrinë e Ushqimit "ABI", në Prizren

Studentët e Fakultetit Shkencat e Ushqimit në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Industrinë e Ushqimit "ABI", në Prizren, me ç'rast kanë parë nga afër procesin e prodhimit të qumështit.
Studentët panë nga afër procesin si prodhohen produktet e qumështit dhe ushqime me prejardhje bimore, kryesisht perime të fermentuara, duke filluar nga pranimi, analizat kimike dhe mikrobiologjike në laboratorin e kompanisë, procesin e pasterizimit të produkteve të qumështit dhe paketimin e tyre.
Gjithashtu, ata patën mundësinë të shohin edhe aplikimin e ISO standardeve, sigurinë në punë, higjienën dhe mbrojtjen e mjedisit.
Kjo vizitë është realizuar nën shoqërimin e profesorëve, Medin Zeqiri, Endra Luzha, Vebi Sofiu dhe Shkëlzim Uka.

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë vizituan Termokosin

Studentët e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë, në UBT, vizituan ngrohtoren e qytetit "Termokos", nën shoqërimin e profesorëve të këtij institucioni, Vehbi Sofiu, Nexhmi Krasniqi, Afrim Osmani, Nexhat Balaj, Sami Gashi, Faton Maloku dhe Afete Shala.
Gjatë kësaj vizite, studentët u pritën nga inxhinieri udhëheqës i kompanisë së ngrohjes qendrore, Blerim Morina, i cili njoftoi studentët për projektin dhe investimin në kogjenerim të termocentralin "Kosova B", dhe projektin për implementimin e paneleve solare, projekt ky më i madhi në Kosovë për energji alternative.
Për të parë nga afër ambientet e punës, studentët në masa të larta të sigurisë vizituan të gjitha stabilimentet e gjenerimit dhe pompimit në repartin e distribuimit të ngrohjes së qytetit.
Në fund të kësaj vizite, studentët patën mundësinë për të shkëmbyer nga afër njohuritë teorike dhe ato praktike në lidhje me ngrohtoren, si dhe të parashtrojnë pyetjet e tyre rreth çështjes se si funksionon Termokosi në të gjitha aspektet.

Studentët e UBT-së vizitojnë Laboratorin modern të Forenzikës

Studentët e Fakultetit Juridik, si dhe ata të Fakultetit të Mekatronikës, kanë vizituar Laboratorin modern të Forenzikës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.
Studentët e dy fakulteteve janë njohur nga afër me analizat që bëhen për ADN, Traseologji, pjesën e Balistikës, etj.
Gjithashtu, studentët panë se si funksionon puna në një laborator të tillë, sidomos në rastet kriminale, rezultate të cila përdoren si prova nga ekspertët e forenzikës në gjykatë.
Tutje, studentët patën mundësinë të diskutojnë për raste specifike me ekspertët e forenzikës, teksa u pajtuan që ditëve në vijim të organizohet një ligjëratë tematike në UBT.

Studentët e Inxhinierisë së Energjisë vizitojnë kompaninë "Muqa Solar"

Studentët e Fakultetit Inxhinieri e Energjisë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në kompaninë "Muqa Solar".
Ata panë nga afër proceset themelore të energjisë solare, panelet, lidhjet inverterve të tipit gjerman dhe prodhuesve evropian.
Studentët u njoftuan me pajisjen smart metër, e cila matë rrjedhën e energjisë deri tek shpenzuesi. Më pas, ata vizituan edhe impiantin HT të implementuar nga kompania në fjalë.
Përfaqësuesi i kësaj kompanie, Xhevat Muqa, së bashku me studentët e UBT-së, në fund u dakorduan që të organizojnë një vizitë studimore në fabrikën e prodhuesit më të madh në Evropë për energji solare, në kompaninë "Sonenkraft", në Austri.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së

Mbi 50 kompani e institucione evropiane të interesuara për të bashkëpunuar me UBT-në

Një numër i madh i institucioneve arsimore prestigjioze dhe kompani të ndryshme nga mbarë bota, mbi 50 të tilla, kanë shprehur interesimin në Kongresin më të madh të blerësve evropianë që është duke u mbajtur në Berlin, për të lidhur bashkëpunim me UBT-në si institucioni më inovativ në Kosovë, kryesisht në fushën e ICT-së.

Universiteti "St. Gallen" me seli në Sangallë të Zvicrës, Universiteti "Tallinn" në Estoni, Amazon Bussines, Siemens AG, SAP Deutschland, Oracle Deutschland, The South African Department Of Trande & Industry, janë vetëm disa institucionet që synojnë të krijojnë ura bashkëpunimi me UBT-në në fushat e lartpërmendura dhe bashkërisht të

hartojnë projekte që kanë për qëllim edukimin e gjeneratave në këtë drejtim dhe sjelljen e inovacioneve në Kosovë.

Kosova është duke u përfaqësuar në këtë kongres nga delegacioni i përbërë prej profesorëve në UBT, Besnik Qehaja dhe Hasan Metin, të cilët po diskutojnë dhe takohen me ekspertë të vendeve të ndryshme nga mbarë globi.

Delegacioni kosovar, në mesin e të cilit janë edhe profesorët në UBT, i ka takuar ambasadori i Kosovës në Gjermani, Beqë Cufa, udhëheqësi kryesor i kësaj ngjarjeje ekonomike, Silvius Grabosch, drejtori për Zgjerimin e BE-së në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjetikës në Gjermani, Helge Tolksdorf.

Ata kanë uruar delegacionin kosovar për përfaqësim dinjitoz në Simpoziumin e BME-së, që këtë vit është sponsorizuar nga UBT dhe Devolli Corporation, M-Technologie.

Përfaqësimi i Kosovës në këtë kongres është organizuar falë bashkëpunimit strategjik të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), me Asociacionin për Menaxhimt të Zinxhirit të Furnizimit, Prokurimit dhe Logjistikës (BME).

Zv. ambasadori gjerman dhe përfaqësuesja e OEGJK-së vizituan UBT-në

Zv. ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jan Alex Voss dhe përfaqësuesja e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani, janë pritur në takim nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, për të biseduar mbi zhvillimet e fundit në Kosovë, duke e orientuar fokusin tek niveli i arsimit, zhvillimi ekonomik dhe projektet konkrete që po realizohen, sikurse që është parku i biznesit dhe inovacionit në Prizren.

Gjatë kësaj bisede, Hajrizi e njoftoi zv. ambasadorin Voss dhe përfaqësuesen e OEGJK-së për pikëpamjet dhe synimet që UBT synon t'i arrijë në rrugën e dhënies së kontributit për zhvillimin e Kosovës.

Studentët e Infermierisë së shpejti do të kenë mundësi të bëjnë punë praktike e të punësohen në klinikat gjermane, "RoMed"

Puna e nisur një vit më parë për dërgimin e studentëve për punë praktike e punësim në Gjermani përmes bashkëpunimit të UBT-së dhe klinikave "RoMed Kliniken Rosenheim", është konkretizuar edhe më shumë, pas vizitës së udhëheqësve të këtyre klinikave, Simon Brunnlechner dhe Haqif Gashi.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte mbajtja e një sesioni informues për studentët e Infermierisë, të cilët falë kësaj marrëveshjeje kanë mundësi të shkojnë për punë praktike, madje edhe punësim në Gjermani.

Ata treguan se kushti bazë është që studentët e UBT-së të jenë të diplomuar ose në prag të diplomimit, si dhe të kenë njohuri të mira të gjuhës gjermane, të



nivelit B1 ose B2.

Udhëheqësit e klinikave u pritën në takim edhe nga rektori i UBT-së, prof..dr. Edmond Hajrizi, me të cilën vizituan Poliklinikën e UBT-së dhe punën që po bëhet aty nga studentët, si dhe u takuan edhe me dekanin e Infermierisë, prof. dr. Fitim Alidema, i cili i njoftoi me punën dhe arritjet e studentëve të Infermierisë

Grupi i parë i studentëve i cili ka njohje të mirë të gjuhës gjermane së shpejti do të bëhen pjesë e poliklinikave "RoMed", në Rosenheim të Gjermanisë.

Partneriteti i UBT-së me institucione të shquara akademike botërore, mundësi për zhvillim akademik e profesional për studentët

UBT është institucioni që Kosovës i ka dhënë gjenerata të tëra të përgatitura përmes praktikave më të mira ndërkombëtare, por edhe ua ka ofruar studentëve mundësinë e vijimit të studimeve në dhjetëra universitete partnere.

I gjithë ky investim intelektual është bërë me qëllim që studentët të marrin të gjitha njohuritë e nevojshme, t'i përshtatin ato për nevojat e vendit tonë dhe të kthehen për të dhënë kontributin e tyre në Kosovë.

UBT ka bashkëpunim me 450 universitete prestigjioze nga e mbarë bota dhe bashkëpunimi është përqendruar në shkëmbimin e studentëve dhe stafit, për ofrim të kontributit në hulumtim, shkencë, inovacion, si dhe për krijim të programeve të përbashkëta.

Të gjitha këto mundësi i kanë shndërruar studentët tanë në liderë e inovatorë, që e kanë dhënë gjithë potencialin e tyre për sjelljen e praktikave më të mira botërore në Kosovë.

Deri më sot, qindra studentë të UBT-së, të të gjitha fakulteteve, kanë përfituar mundësinë për të vazhduar studimet jashtë vendit, në shtete të ndryshme të botës, përfshirë vendet si SHBA, Anglia, Italia, Portugalia, Gjermania, Zvicra, Austria, Polonia, Kroacia, dhe shume shtete tjera.

James Madison University shpreh interesim për të nisur bashkëpunimin me UBT-në

Një delegacion nga James Madison University ka qëndruar në UBT, ku janë pritur nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili i njoftoi me proceset, të arriturat dhe planet e institucionit, në aspektin e përmirësimit të nivelit të arsimit kosovar dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Delegacioni nga ky universitet amerikan shprehu interesim për fillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, që pritet të përfshijë aktivitete në dobi të studentëve dhe stafit të të dy institucioneve.

Të shoqëruar nga rektori Hajrizi, ata vizituan Kampusin Inovativ të UBT-së,në Lipjan, me ç'rast edhe shprehën konsideratë të lartë mbi atë që është ndërtuar e arritur në UBT në këto 18 vite.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së

UBT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me International School for Social and Business Studies (ISSBS) të Sllovenisë

Rektori u UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi dhe prof.dr Dušan Lesjak, themelues i International School for Social and Business Studies (ISSBS) në Slloveni, kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi, me qëllim që studentët dhe stafi akademik të të dy institucioneve të kenë mundësi të përfitojnë nga programet e mobilitetit.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje institucionet do të bashkëpunojnë në fusha të ndryshme, si në organizmin e konferencave shkencore, aplikimin e programeve të mobilitetit si Erasmus+, shkëmbimi i stafit akademik dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

Bashkëpunimi ka filluar të jetësohet me mbajtjen e konferencës për Lidership dhe Menaxhment, ku u mbajt në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan. Konferenca mblodhi dhjetëra njerëz nga akademia, përfaqësues institucionesh dhe partnerë ndërkombëtarë, të cilët diskutuan mbi përshtatjen e shoqërisë me zhvillimet dhe ndikimin e teknologjisë dhe digjitalizimit në fushën e edukimit, si dhe përshtatjen e tyre me nevojat e shoqërisë moderne.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Eötvös Loránd University

Listës së gjerë të partnerëve ndërkombëtarë të UBT-së, i është shtuar edhe Eötvös Loránd University nga Hungaria, pas nënshkrimit të marrëveshjes nga rektorët e të dy institucioneve, prof. dr. Edmond Hajrizi, përkatësisht prof. dr. Laszlo Borhy.

Palët janë pajtuar që të lidhin këtë marrëveshje për të ngritur bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të zhvilluar shkëmbime kulturore dhe akademike në fushën e arsimit.

Me këtë rast, bashkëpunimi do të shtrihet në fushën e andragogjisë, pedagogjisë, psikologjisë, mënyra e jetesës dhe fitnesit, psikologji dhe arsim ndërkulturor, komunikim organizativ, arsimim dhe trajnim i mësuesve brenda fushës së arsimit, trajnim, kërkim dhe shërbime administrative për komunitetin.

E ky bashkëpunim parasheh edhe shkëmbim ndërmjet studentëve, stafit, hulumtuesve, fakulteteve, shkëmbimi i materialeve shkollore dhe pedagogjike dhe programe të përbashkëta studimi.

UBT ka mbi 300 partnerë ndërkombëtarë nga pothuajse të gjitha vendet e botës, me të cilët, që nga themelimi e deri më sot, ka realizuar një varg aktivitetesh të përbashkëta, prej të cilave më së shumti kanë përfituar stafi dhe studentët e UBT-së dhe të institucioneve partnere.

UBT lidh marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës së Republikës së Shqipërisë (FSHZHD) dhe UBT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mënyrë që institucionet të zbatojnë programe dhe aktivitete në fusha të ndryshme.

Institucionet janë pajtuar që të lidhin këtë marrëveshje, ndërkaq UBT do ta asistojë FSHZHD-në në dhënien e ekspertizës profesionale, për ndërtim te kapaciteteve institucionale dhe zhvillimore, veçanërisht në ide, projekte, pilot – projekte, programet e caktuara, që janë pjesë të rëndësishme të angazhimit me këtë memorandum.

Ky bashkëpunim parasheh edhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe inovacion.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Isparta University of Applied Sciences” në Turqi

Listës së gjatë të partnerëve ndërkombëtarë të UBT-së, tashmë i është shtuar edhe Universiteti “Isparta University of Applied Sciences”, në Turqi.

Konkretisht, drejtori për Çështje Akademike në UBT, prof.dr Muhamet Ahmeti është takuar me rektorin e këtij universiteti, prof.dr Ibrahim Diler, me ç’rast në emër të dy institucioneve nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit.

Bashkëpunimi ndërmjet dyja institucioneve parasheh shkëmbimin e studentëve, stafit akademik, organizimin e konferencave me karakter shkencor, vizitave dhe praktikave profesionale, si dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

Gjithashtu, rektorët e universiteteve përkatëse u takuan edhe me përfaqësuesit e Erasmus+, me ç’rast kanë diskutuar për realizimin e këtyre projekteve të përbashkëta, bashkëpunime që po përkrahen edhe nga KB, BE dhe TIKA.

UBT ka mbi 400 partnerë ndërkombëtarë nga pothuajse të gjitha vendet e botës, me të cilët, që nga themelimi e deri më sot, ka realizuar një varg aktivitetesh të përbashkëta, prej të cilave më së shumti kanë përfituar stafi dhe studentët e UBT-së.

Universiteti zviceran, shpreh interesim të bashkëpunojë me UBT-në

Një delegacion i përbërë nga koordinatori për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin “Hepia”, me seli në Gjenevë të Zvicrës, prof.dr. François Lefort ka vizituar UBT-në, me qëllim të nisjes së bashkëpunimit mes dyja institucioneve.

Ai është pritur nga drejtori për Çështje Akademike në UBT, Muhamet Ahmeti, si dhe iniciuesit e këtij bashkëpunimi, Ekrem Kurexha dhe Medin Zeqiri.

Gjatë këtij takimi, profesori Lefort u njoftua me programet aktuale të institucionit dhe me formën e studimeve që zhvillohen në kuadër të fakulteteve. Ai shfaqi gatishmërinë për të nisur një bashkëpunim ndëruniversitar, që do të konkretizohet edhe me një memorandum mirëkuptimi.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, ndër tjerash, parasheh shkëmbimin e stafit dhe studentëve për 1 ose 2 semestra të vitit akademik, zhvillimin e projekteve të përbashkëta, vijimin e praktikave profesionale dhe vizitave studimore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së

Rektori Hajrizi në vizitë zyrtare në Finlandë, thellon bashkëpunimin me institucione e universitete

Me ftesë zyrtare të Ambasadës së Finlandës në Kosovë, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi po qëndron në vizitë zyrtare në shtetin finlandez, me ç'rast po zhvillon takime të shumta me zyrtarë të institucioneve qeveritare, universitare, si dhe me përfaqësues të odës ekonomike. Hajrizi ka zhvilluar takim të ndarë me krerë të Universitetin "Aalto", një nga institucionet më të mira universitare në Finlandë, me qëllim të vendosjes së partneritetit akademik.

Gjithashtu, rektori po merr pjesë edhe në takimin vjetor të Qeverisë së Finlandës, i ashtuquajtur "Team Finland 2019". Pjesë e kësaj mbledhjeje do të jenë përfaqësues të vendeve të ndryshme, përfshirë edhe Kosovën, të cilët gjerësisht do të prezantojnë mundësitë e vendeve përkatëse për bashkëpunim mes shteteve në sferën e arsimit, si dhe fusha të tjera.

UBT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Aschaffenburg University of Applied Scienes

Vizitat që rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi i bëri në Gjermani, u finalizuan me disa memorandume bashkëpunimi, mes të cilave edhe me Aschaffenburg University of Applied Scienes.

Në marrëveshjen që u nënshkrua nga rektori Hajrizi dhe nga rektorja e Aschaffenburg University of Applied Scienes, dr. Eva-Maria Beck-Meuth, parashihen vizita ndërinstitucionale me qëllim të inkurajimit të hulumtimeve shkencore, shkëmbimi i studentëve të kualifikuar për qëllime studimore dhe kërkimore, shkëmbimi i publikimeve akademike dhe i informacioneve universitare, si dhe promovimi i aktiviteteve tjera akademike, me qëllim të arritjes së të gjitha qëllimeve të përfshira në marrëveshje.

UBT ka mbi 400 partnerë ndërkombëtarë, me të cilët deri sot janë realizuar një varg aktivitetesh të përbashkëta, përfshirë konferenca e publikime të përbashkëta, si dhe shkëmbim të studentëve dhe stafit akademik.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Infermierëve të Kosovës

Dekani i Fakultetit të Infermierisë në UBT, Fitim Alidema, në emër të institucionit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Infermierive të Kosovës (OIK).

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën e shëndetësisë, konkretisht kjo marrëveshje përfshinë edhe akreditimin e Konferencës Ndërkombëtare të UBT-së për Infermieri.

Bashkëpunimi mes UBT-së dhe Odës së Infermierëve të Kosovës, veç tjerash do të mundësojë edhe marrjen e përvojave profesionale dhe sjelljen e profesionistëve të njohur shëndetësor në Kosovë.

UBT lidh bashkëpunim me Universitetin e Stambollit

Delegacioni i UBT-së, i përbërë nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe ligjëruesit, dr. Bertan Karahoda e Besnik Skenderi, kanë vizituar Universitetin e Stambollit, ku janë pritur nga rektori i këtij universiteti, prof. dr. Mahmut Ak.

Kjo vizitë u bë me qëllim të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Marrëveshja synon të sigurojë përfitime të ndërsjella për arsimin dhe aktivitetet kërkimore midis UBT-së dhe Universitetit të Stambollit, të zhvillojë dhe mbështesë fushat e interesit të përbashkët, parasheh shkëmbimin e studentëve, mobilitetin ndërmjet fakulteteve, kërkimet e përbashkëta shkencore dhe zhvillimin e bashkëpunimit akademik midis dy shteteve.

Pas vizitës së ndërtesës së rektoratit dhe takimit me rektorin dhe me pjesën tjetër të stafit të universitetit, delegacioni nga UBT vizitoi edhe Muzeun Arkeologjik të IU-së, "Ridvan Çelikel".

UBT ka mbi 400 partnerë ndërkombëtarë nga pothuajse të gjitha vendet e botës, me të cilët, që nga themelimi e deri më sot, ka realizuar një varg aktivitetesh të përbashkëta, prej të cilave më së shumti kanë përfituar stafi dhe studentët e UBT-së.

Universitetet dhe kompanitë gjermane shprehin interesim për bashkëpunim me UBT-në

Me ftesë të institucioneve akademike dhe zhvillimore gjermane, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi është duke qëndruar për një vizitë disaditore në Gjermani, ku është takuar udhëheqës e akademikë të universiteteve dhe me udhëheqës të kompanive nga industri të ndryshme.

Tema bosht të këtyre takimeve ishin jetësimi i projekteve të përbashkëta në fushën e mjekësisë, teknologjisë, inovacionit, dizajnit, multimedias, etj., me ç'rast edhe i njoftoi për përparimet që ka bërë Kosova përmes UBT-së në secilën prej këtyre fushave.

Universitetet dhe kompanitë gjermane janë disa nga partnerët më të ngushtë të UBT-së, e falë bashkëpunimit, shumë anëtarë të stafit dhe studentë të UBT-së kanë pasur fatin ta njohin sistemin gjerman të punës dhe studimit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UBT-së

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Mitrovicës dhe UN-Habitat

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi zyrtarisht është pritur në takim nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore, Faruk Mujka, si dhe përfaqësuesja e UN-Habitat, Gwendoline Mennetrier, me ç'rast kanë nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi trepalëshe.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është hartimi i projekteve për planifikim urban të lagjeve të qytetit të Mitrovicës, njëherësh implementimi i projektit apo punëtorisë për dizajn dhe zhvillim urban.

Përmes këtij projekti, punëtoria e dizajnit dhe zhvillimit urban për planifikim do të mbledhë 25 studentë, të cilët kanë përgatitje akademike përfshirë në fushat: arkitekturë, planifikim urban, mjedis, sociologji dhe ekonomi, ku në bashkëpunim me grupin punues bazë të projektit dhe komunitetet e lagjeve do të mblidhen për të ndarë përvojat, idetë, si dhe për të dhënë ekspertiza profesionale në këtë drejtim.

Bashkëpunimi mes UBT-së, Mitrovicës dhe UN-Habitatit, veç tjerash do t'ju mundësojë studentëve përfitimin e përvojave profesionale në zgjidhjen e problemeve të tilla të komunitetit.

UBT, Komuna e Mitrovicës dhe UN-Habitat, gjithashtu u pajtuan që bashkërisht të ndërtojnë kapacitete institucionale dhe zhvillimore, teksa muajt në vazhdim do të hartojnë projekte dhe programe të caktuara si pjesë e rëndësishme e marrëveshjes së bashkëpunimit.

UBT lidh memorandum bashkëpunimi me kompaninë "BEO"

Përfaqësuesit e UBT-së dhe ata të kompanisë "BEO", kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi, nga i cili më së shumti do të përfitojnë studentët e UBT-së, konkretisht ata të Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Bashkëpunimi ka për qëllim të aftësimit profesional të studentëve të fushës së teknologjisë, të cilët do të zhvillojnë punë praktike në këtë kompani, gjithnjë më mundësi të punësimin pas mbajtjes së praktikës në këtë kompani.

Studentët të cilët do të jenë pjesë e kësaj praktike në këtë kompani, ata kryesisht do të merren me zhvillimin e aplikacioneve të TIK-ut.

UBT ka nënshkruar marrëveshje të shumta të bashkëpunimit me kompani vendore dhe ndërkombëtare dhe me institucione tjera publike, falë të cilave, studentët kanë mundësinë t'i realizojnë qëllimet e tyre në karrierë dhe më të sistemohen në tregun e punës.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Sigmund Freud", në Vjenë

UBT vazhdon të zgjerojë listën e bashkëpunimeve me institucione arsimore prestigjioze në Evropë dhe botë, me ç'rast po nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të krijimit të mundësive për shkëmbim të stafit dhe studentëve.

Një marrëveshje të tillë, së fundmi UBT e ka nënshkruar me Universitetin "Sigmund Freud", me seli në Vjenë të Austrisë.

Marrëveshja e bashkëpunimit është nënshkruar mes rektorit të UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, dhe drejtuesit e universitetit në fjalë, ku përqendrohet në fushën e mjekësisë dhe psikologjisë.

Konkretisht, marrëveshja parasheh edhe hartimin e projekteve të përbashkëta në fushën e kërkimit dhe edukimit, trajnimit, zhvillimit të kurrikulave, transferimit të teknologjisë, digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale. Po ashtu, do të organizohen edhe vizita dhe ligjërata në dyja institucionet, dhe me theks të veçantë mobilitetin e studentëve.



UBT deri më sot ka krijuar partneritet me qindra universitete të njohura në botë, ku falë këtyre programeve të shkëmbimit, studentët kanë mundësinë për të studiuar, punuar dhe udhëtuar në arenën ndërkombëtare.

Marrëveshjet mundësojnë edhe pjesëmarrjen në shkollat verore të universiteteve përkatëse.

Delegacioni i UBT-së pritet në takim pune në Anhalt University of Applied Sciences

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, si dhe udhëheqësi i Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, prof.dr Fidan Feka, janë pritur në takim pune nga dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, Wolfram Schnackel, në Anhalt University of Applied Sciences, në Gjermani.

Palët konkretisht diskutuan për zgjerimin e bashkëpunimit dhe realizimin e projekteve në fushën përkatëse.

Gjithashtu, ata folën për shkëmbimin e stafit dhe studentëve përmes projektit Erasmus+, gjë që, sipas tyre, ndikon pozitivisht në aspektin akademik dhe marrjen e përvojave të reja.

Rektori Hajrizi gjatë këtij takimi tha se UBT u ofron kushte shumë të favorshme studentëve të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, ku në dhjetëra laboratorë inovativ me pajisje të sofistikuar, shndërrojnë në praktikë teoritë e fituara gjatë studimeve.

Ai theksoi se ky bashkëpunim do t'u mundësoj studentëve të UBT-së realizimin e hulumtimeve shkencore me studiues të rinj nga ky universitet në Gjermani.

Bashkëpunimet që institucioni po arrin me universitete evropiane, ndikojnë në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Kosovë, dhe ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve akademike.

AKADEMITË VERORE TË UBT-SË

Me ligjërata tematike e vizita në terren i zhvilloi punimet akademia e SHKI-së

Një numër i madh i studentëve morën pjesë në aktivitetin e Akademisë Ndërkombëtare Verore të Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT.

Akademia ka vazhduar punimet me ligjëratën e përfaqësuesve të kompanisë "Level", Shpat Kozgori, Kreshnik Vokshi dhe Bujar Hysenin ku prezantuan ligjëratën me temë: "Brand Creation From Scratch".

Ata treguan për sfidat që kishin hasur në treg si dizajner të rijnë në tregun e vendor dhe ndërkombëtarë, teksa rast konkret përmenden Muzeun e Iluzioneve "Illusion".

Për të parë praktikisht punën në këtë muze, ata bashkëpunuan me pjesëmarrësit e ANV-së vizituan Muzeun e Iluzioneve, me qëllim për të parë nga afër dizajnet e punuara, dhomat e muzeut, si dhe për të marrë informata për procesin e marketingut.

"Level" është kompani që merret me marketing dhe dizajn, kur pjesë e kampanjave kreative janë edhe dy studentet e UBT-së, Leonita Berkolli dhe Sheribane Shabani, të cilat janë duke vijuar punën praktike në këtë kompani.

Në ANV-në e SHKI-së është mbajtur ligjërata "Full Stack JavaScript Web App", ligjëruar nga përfaqësuesit e kompanisë "Kutia", Meriton Reqica dhe Gentrit Halili, njëherësh edhe studentë të UBT-së.

Ata kanë diskutuar për veglat dhe teknologjinë që përdorin, si dhe prezantuan detaje rreth aplikacionit që zhvilluan gjatë ligjëratës.

Më pas, pjesëmarrësit u ndanë edhe grupe punuese, ku secili grup zhvilloi aktivitetin me projekte të ndara.

Akademia e SHKI-së vazhdoi me ligjëratën e ligjëruese në UBT, Krenare Pireva-Nuçi. Ajo foli për konceptet themelore dhe për zgjidhjet që i ofron Artificial Intelligence, gjithnjë duke e demonstruar edhe me shembuj praktik.

Tutje, në kuadër të kësaj akademie ka ligjëruar edhe profesori në Universitetin Teknik të Vjenës, i cili gjerësisht ka ligjëruar temën: "Modelling and Simulation".

Në ANV-në e SHKI-së u mbajt edhe kursi në lëndën "Gaming", me ligjërues nga industria dhe profesorë të UBT-së.

Themeluesit e kompanisë Sigma XP, Agnesa Belegu dhe Lekë Sahatqija, si dhe asistentja në UBT, Vesa Morina, punuan në studentët në grupe, ku secili grup realizoi një projekt që u prezantua në fund të akademisë së SHKI-së.

Më pas, ligjëruesja në Universitetin Teknik të Sofjes, Galia Marinova. Ajo ka prezantuar ligjëratën më temë: "Modelling and Simulation".

Ndërkohë, kanë përfunduar ligjëratat për Front End and WordPress Theme Development, të mbajtura nga ligjëruesi Shyqeri Gashi. Në fund, studentët mbrojtën projektet e krijuara në sistemin WordPress, ku kanë krijuar Theme që nga fillimi (from scratch).

Në ANV-në e SHKI-së u organizua kursi "Artificial Intelligence", mbajtur nga ligjëruesja në UBT, Krenare Pireva-Nuçi. Në kuadër të këtij kursi, pjesëmarrësit e akademisë testuan njohuritë e tyre dhe mbrojtën projektet që zhvilluar përgjatë punës praktike.

Tutje, në këtë shkollë verore ka ligjëruar edhe themeluesi i kompanisë 3P, Kastriot Gjergji, i cili bashkëpunoi me pjesëmarrësit ka krijuar një aplikacion që e quajtën Pret Për Pare (3P), aplikacion i cili u ofron mundësinë klientëve të telekomit për aplikimin e kredive.

Në ANV-në e SHKI-së ka ligjëruar edhe profesori në UBT, Zhilbert Tafa, i cili shpjegoi konceptet e IoT dhe zgjidhjet që i ofron përdorimi i këtyre pajisjeve ku lehtëson punët dhe aktivitet e përditshme.

Në fund të kësaj ligjërate, studenti i nivelit master në UBT, Bleron Zherka, së bashku me profesorin Tafa, kanë prezantuar edhe një mësim praktik, konkretisht aplikuan sistemin për monitorim të ambientit.

Po kështu, në kuadër të ANV-së së SHKI-së u mbajtën ligjëratat për zhvillimin e aplikacioneve mobile, me ligjëruesen Adelina Basholli, kandidate për doktoraturë në Universitetin e Sheffield-it, njëherësh edhe përfaqësuese e kompanisë "UCX".

Ajo fillimisht ka diskutuar me studentët për qëllimet e kursit, teksa trajtoi rëndësinë e zhvillimit të aplikacioneve mobile, duke marrë parasysh faktin që përdorimi i pajisjeve mobile për qasje në internet ka kaluar numrin e PC-së që nga viti 2014. Pastaj, ka vazhduar punën së bashku me studentët, duke krijuar projektin e parë në Android.

Ndërkaq, ligjërata e parë në Data Science nisi me ligjëruesin Taulant Hoti, i cili është student i UBT-së, i angazhuar në Raiffeissen Bank, në sektorin e Business Intelligence.

Ai ka trajtuar konceptet bazë të Data Science dhe rëndësinë e informatës që nxirret pas analizimit të të dhënave dhe vizualizimit të tyre.

Studentët janë ndarë në grupe punuese, ku në fund të kursit, secili grup do të analizojë një dataset me të dhëna publike.

Në kuadër të Akademisë Verore të SHKI-së janë prezantuar projekte në kursin "Mobile Application Development", "Data Science", "Full Stack JavaScript Web App".

Studentët, të ndarë në 17 grupe, kanë prezantuar ide të ndryshme të cilat i kanë implementuar në Android.

Projektet e implementuara kanë të bëjnë me aplikacione mobile që shërbejnë për menaxhimin e pirjes së ujit në baza ditore, si dhe rikujtimet apo njoftimet në lidhje me të, kalkulimin e masës trupore, aplikacion për menaxhimin e muzikës në pajisjen mobile, aplikacione që shfaqin motin në kohe reale dhe tregojnë lokacionin e qytetit të zgjedhur, aplikacione për marrjen e shënimeve të shpejta dhe shumë të tjera.

Në po të njëjtën akademi ka përfunduar kursi në "Data Science", ku studentët e ndarë në grupe punuese kane finalizuar projektin e tyre nën monitorimin e ligjëruesve, Nora Gjergji dhe Taulant Hoti.

Ata kane analizuar datasetet publike për të nxjerr informata të cilat ndihmojnë pastaj në marrjen e vendimeve për çështje të caktuara, teksa të dhënat janë vizualizuar duke shfrytëzuar softuerin Tableau.

Gjatë kursit "Full Stack JavaScript Web App", studentët kanë punuar së bashku me ligjëruesit Meriton Reqica dhe Gentrit Halili në implementimin e një Web Aplikacioni, duke perdorur librarinë React të JavaScritp-it.

Pastaj, grupet punuese kanë vazhduar në avancimin e aplikacionit, duke shtuar disa funksionalitete, siç janë ruajtja e IP-së së autorit, filtration by sort dhe pagination, kurse në fund, finalizimi i punës së studentëve është bërë duke mbrojtur projektet me sukses.

Në ANV-në e Sistemeve të Informacionit ligjëroi profesoresha nga Polonia, Anna Soltysik Piorunkiewicz

Ka vazhduar punimet ANV-ja e Fakultetit Sistemet e Informacionit, ku ka ligjëruar profesoresha e Universitetit "Katowice", në Poloni, Anna Soltysik Piorunkiewicz.

Ajo ka prezantuar temën: "Menaxhimi i sistemeve të informacionit", ku pjesëmarrësve u shpjegoi për aplikimin e sistemeve në industri, madje edhe për përdorimin e veglave softwerike në zhvillim të sistemeve dhe analizës së tyre.

Në pjesën e dytë të ligjëratës, ajo foli rreth trendëve të sigurisë kibernetike, sulmeve më të përdorura si dhe këshillat se si duhet të mbrohen organizatat.

Profesori në UBT, Blerton Abazi, ka ligjëruar për pjesëmarrësit e Akademisë Verore Ndërkombëtare të Fakultetit Sistemet e Informacionit.

Ai ka trajtuar temën: "Sistemet e menaxhimit të sigurisë së të dhënave dhe implementimi i tyre", konkretisht foli për kërkesat e sistemit të menaxhimit të ISO/IEC 27001.

Në kuadër të kësaj ligjërate, profesori Abazi shpjegoi organizimin, politikën dhe objektivat e sigurisë së informacionit, si dhe vlerësimin e trajtimin e rrezikut dhe elemente tjera që lidhen me menaxhimin e informacionit.

Akademia ka vazhduar punimet me ligjëratën e profesorit, Edon Maliqi. Ai shtjelloi temën: "Geospatial Modelling and Analysis", ku analizoi fenomenet dhe dukuritë që për referencë kanë hapësirën.

Gjatë kësaj ligjërate, studentët patën rastin që edhe praktikisht të aplikojnë softuerë të bazuar në GIS logjikën në funksion të modelimit dhe analizave gjeo-hapësinore.

Në ANV-në e Ndërtimtarisë zhvillohen vizita studimore

Nën shoqërimin e profesorit të UBT-së, Driton Kryeziu, dhe asistenteve Blertë Retkoceri e Arbresha Kastrati, pjesëmarrësit e ANV-së së Inxhinierisë së Ndërtimit kanë vizituar kompaninë "Vëllezërit e Bashkuar" në Prizren, kompani e cila është e licencuar për prodhuar gjitha llojet e fraksioneve të agregateve nga shkëmbi i fortë.

Ata janë pritur nga drejtori i kompanisë, Sefer Susuri, ku bashkëpunuesit panë nga afër procesin e thyerjes së gurit si material bazë, funksionimin dhe kapacitetet që ofron gurthyesi.

Në fund, studentët panë edhe pajisjet moderne që përdoren në gjitha proceset teknologjike të prodhimit dhe panë se si zhvillohen punimet në aspektin praktik.

Në ANV-në e Mekatronikës ligjërohet për industrinë 4.0

"Industry 4.0", është tema që u trajtua në Akademinë Ndërkombëtare Verore të Mekatronikës në UBT, ku morën pjesë dhjetëra pjesëmarrës nga vendi dhe më gjerë.

Ligjërata u mbajt nga profesori në UBT, Ylber Limani, i cili u tregoi pjesëmarrësve trendin e automatizimit dhe shërbimit të të dhënave në teknologjinë prodhuese.

Në ANV-në e Mekatronikës, pjesëmarrësit patën mundësinë të dëgjojnë tema aktuale dhe mjaft interesante në fushën e mekatronikës. Në këtë shkollë verore u diskutua për printerët 3D, PLC, Linjat Prodhuese, IoT, etj.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Fakultetit të Mekatronikës ka vazhduar aktivitetin e vet me ligjëratën e ish-studentit të

UBT-së, Florian Piraj, njëherësh njëri ndër themeluesit e kompanisë "Formon", që merret me prodhimin dhe shitjen e printerëve 3D për përdorim personal.

"Subtractive manufacturing wastage and additive manufacturing", ishte tema që ish-studenti Piraj shtjelloi para shumë pjesëmarrësve, i cili tregoi për prodhimin subtraktiv. Ai foli gjerësisht për procesin dhe prerjen e materialeve metal, plastikë ose dru, teksa tregoi për efikasitetin e materialeve, efiçiencën e resurseve, dizajnimin dhe flexibilitetin e prodhimit.

Në fund, Piraj bëri të ditur se Additive Manufacturing (AM) është një ndër teknologjitë më të përdorshme në botë, ku sipas tij, përdoret gjerësisht në hapësirën ajrore, biomjekësore dhe automobilistike.

Në ANV-në e Mekatronikës është mbajtur ligjërata me temë: "Programmable Logic Controllers (PLC), ligjëruar nga profesori në UBT, Bertan Karahoda.

Ai ka shpjeguar PLC-në, program që kontrollon shumë procese në industri. Profesori Karahoda konkretisht ka folur për pjesën hardwerike dhe softwerike, llojet, elementet dhe implementimin e PLC-së me 4.0.

ANV-ja e Ndërmarrësisë mbledh ekspertë të mirënjohur nga Kosova

I ka zhvilluar punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit në UBT, shkollë verore në të cilën u prezantuan tema të ndryshme duke filluar nga Inovacioni, Krijimi i sipërmarrjes së re, Ndërmarrësia, Menaxhimi strategjik, si dhe tema tjera biznesore.

Në edicionin e sivjetmë të kësaj akademie ligjëroi edhe profesori Engelbert Selenko, si dhe të ftuar nga institucionet qeveritare dhe nga industria.

Hapja e akademisë është bërë me prezantimet e biznes-planeve të studentëve për inovacionet sociale, ku disa nga prezantimet kanë qenë plane ekzistuese të dala nga UPSHIFT.

Më pas, ka folur udhëheqësi i Inkubatorit Virtual të Kosovës, Bejtush Ademi, njëherësh edhe ligjërues në UBT, i cili u tregoi pjesëmarrësve mundësitë dhe aspektet e të bërit biznes. Po ashtu, ai gjerësisht foli edhe për ndikimin e teknologjisë në biznese.

Në pjesën e dytë të punimeve ka ligjëruar kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri.

Kryetari Tahiri u foli pjesëmarrësve për mbështetjen e qeverisë lokale dhënë sipërmarrjeve dhe inovacionit në komunën që ai drejton.

ANV-ja e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit në UBT, u ofron pjesëmarrësve njohuri profesionale për krijimin e një biznesi të suksesshëm dhe të konkurrueshëm në tregun vendor dhe më gjerë.

Në këtë akademi ka ligjëruar drejtori i Agjencisë së Pronësisë Industriale, Nezir Gashi.

Ai gjerësisht ka folur për Patentat dhe Inovacionin, ku tha se kreativiteti dhe inovacioni mund të mbrohen vetëm me të drejtën e autorit përmes patentimit të ideve.

Më pas, ka ligjëruar edhe drejtori i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinator i politikave, Irfan Lipovica, ku diskutoi mundësitë e sipërmarrjes në Kosovë si dhe për shfrytëzimin e këtyre mundësive.

Akademia e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit po zhvillon aktivitetin e vet me pjesëmarrës të shumtë, në të cilën po ligjërohen tema tejet interesante.

Drejtori ekzekutiv i kompanisë së njohur, "Gjirafa", Mërgim Cahani, e pasuroi ANV-në e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, duke ndarë me pjesëmarrësit përvojën e njërës ndër kompanitë më të rëndësishme në fushën e teknologjisë në Kosovë dhe rajon.

Ai foli ne lidhje me ndërmarrësinë dhe inovacionin, duke u ndërlidhur me rastin e tij personal dhe të Gjirafa-s.

Ndërkaq, në pjesën e dytë, për pjesëmarrësit foli Valon Hyseni, në lidhje me marketingun ndërmarrës, për rëndësinë e marketingut në ndërmarrësi, dhe strategjitë në trend.

Akademia Verore në Ndërmarrësi dhe Inovacion u mbyll me vizitën në kompaninë "SCAMPA", me lokacion në Parkun e Biznesit, në Drenas.

Kompania "SCAMPA" është kompani vendore, lidere në prodhimin e qeseve dhe thasëve të plastikës, që tashmë është duke i rritur kapacitetet prodhuese dhe do ta rris eksportin.

Menaxhmenti i kompanisë i njoftoi studentët për sfidat, sukseset, si dhe çështjet tjera që lidhen me operimin e kompanisë në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Edukimit

I ka zhvilluar punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Edukimit, në të cilën morën pjesë ekspertë dhe qindra pjesëmarrës, të interesuar për sfidat, metodat dhe arsimin e së ardhmes.

Në hapje të kësaj akademie, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se edukimi dhe arsimimi janë çelësi i suksesit për një shtet të tërë, prandaj, sipas tij, UBT po sjell në Kosovë metodat më të reja të mësimdhënies.

"Realiteti Virtual do të jetë një metodë tërësisht e re e mësimdhënies, që do të na dërgojë shumë hapa para në formën e të mësuarit dhe shkëmbimit të informacioneve, kjo sepse ne jemi shumë të interesuar që të vendosim fokusin aty ku do të vërehet ndikimi më i madh, e ndikimi më i madh është në edukimin e gjeneratave të reja", theksoi ai.

Kryetarja e KETNET, prof. dr. Blerta Mustafa mbajti ligjëratë tematike më titull "Trendet e reja në të mësuarit e mendimit kritik", teksa shpjegoi qasjet më të njohura për të menduarit kritik, procesin dhe zgjidhjet më të mira në këtë proces, si dhe të mësuarit e shkathtësive të të menduarit kritik. Prof. dr. Megan Fisk, vullnetare në Trupat Paqeruajtëse, njëherësh edhe udhëheqëse e Departamentit të Gjuhës Angleze Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë, fokusin e ligjëratës e vendosi tek tema "E të mësuarit duke u bazuar në zgjidhjen e problemeve", me ç'rast sqaroi definimin e kësaj forme të re të të mësuarit, rëndësinë e përdorimit, duke e ilustruar edhe me shembuj konkretë rëndësinë dhe rezultatet e kësaj forme të të mësuarit.

